

BASHKITË NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Raporti i Vlerësimit për Vitin 2022

Maj 2023





BASHKITË PËR NË EVROPË
Një projekt i financuar nga BE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE
TË BRENDSHME

BASHKITË NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Raporti i Vlerësimit për Vitin 2022

Maj 2023



Ky raport prezanton ecurinë e institucioneve të vetëqeverisjes vendore në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian për sa i përket realizimit të detyrimeve që rrjedhin në kuadër të kriterëve dhe angazhimeve të procesit të integrimit evropian, gjatë vitit 2022.

Njësitë e Integrimit Evropian në secilën bashki kanë koordinuar organizimin e brendshëm të grumbullimit të të dhënave ndërsa orientimi dhe monitorimi i procesit të raportimit është realizuar nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV). Analiza e të dhënave dhe përgatitja e raportit u asistuan edhe nga ekspertët e projektit “Bashkitë për në Evropë”, znj. Mirsa Titka dhe znj. Valbona Kuko.

SHËNIM

Ky botim u realizua me mbështetjen financiare të projektit “Bashkitë për në Evropë” financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Tabela e Lëndës

I. Përmbledhje Ekzekutive	08
II. KRITERI POLITIK	25
1.1. DEMOKRACIA	26
1.1.1. Qeverisja	26
1.1.2. Rritja e Transparencës së Financave Vendore	32
1.1.3. Administrata Publike	35
1.1.4. Avokati i Popullit	45
1.1.5. Shoqëria civile	46
1.2. SHTETI I SË DREJTËS	50
1.2.1. Lufta kundër korrupsionit	50
1.2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave	53
III. KRITERI EKONOMIK	55
2. Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale	56
IV. AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT	59
3.1 Kapitulli 11: Bujqësia dhe Zhvillimi dhe Rural	60
3.2 Kapitulli 12: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare	66
3.3 Kapitulli 14: Politikat e transportit	69
3.4 Kapitulli 15: Energjia	74
3.5 Kapitulli 16: Taksat	78
3.6 Kapitulli 19: Politikat sociale dhe punësimi	84
3.7 Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumentave strukturorë	88
3.8 Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore	91
3.9 Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria	102
3.10 Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura	104
3.11 Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimi i klimës	108
3.12 Kapitulli 32: Kontrolli financiar	119

Shtojca 1: Vlerësimi i progresit të arritur sipas treguesve të vlerësimit 127

Shkurtime

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara në Shqipëri
AKVMB	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
ALPEX	Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BB	Banka Botërore
SNKK	Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
FSHU	Ofrues i Shërbimit Universal
ITS	Sisteme Inteligjente të Transportit
KK	Këshilli Konsultativ për vetë-Qeverisjen Vendore
KE	Komisioni Evropian
KM	Këshilli i Ministrave
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
SNRAP	Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020
DPPS	Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale
ILKPKDI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
PAK	Person me Aftësi të Kufizuara
PV	Plan Veprimi
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PKVPAK	Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçencën e Energjisë
PVEE	Plani Vendor për Efiçencën e Energjisë
PVMIM	Plani Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor

Shkurtime

NJVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
PKVIRE	Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane 2016-2020
PVIRE	Plani Vendor për Integrimin e Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane
QQ	Qeveria Qëndrore
QV	Qeveria Vendore
MB	Ministria e Brendshme
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTE	Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit
NJA	Njësi Administrative
RAP	Reforma e Administratës Publike
SNDQV	Strategjia Ndërsektoriale e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore
SKEE	Strategjia Kombëtare për Eficiencën Energjisë
ZIN	Qendra e Integruar me një Ndalesë
SSC	Sistemi i Sigurimit të Cilësisë
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
MSA	Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asocimit
MIM	Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve
RAT	Reforma Administrative Territoriale
RV	Raport Vjetor
GP	Grup Pune
SHBSH	Shoqata e Bashkive të Shqipërisë
SHAV	Shoqata për Autonominë Vendore
ZNJN	Zyra me Një Ndalesë
TI	Teknologjia e Informacionit
HRMIS	Sistemi Informatik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
NVM (SME)	Ndërmarrje të Vogla e të Mesme



Përmbledhje Ekzekutive

Ky është raporti i gjashtë kombëtar i vlerësimit të arritjeve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) në funksion të procesit të integrimit evropian në nivel vendor dhe në fushat kryesore të cilat lidhen me kriterin politik, kriterin ekonomik dhe aftësinë për të realizuar detyrimet e anëtarësimit të Shqipërisë.

KRITERI POLITIK

1.1 Demokracia

1.1.1. Qeverisja

Qeveria shqiptare ka ruajtur fokusin në reformat në rrugën e vendit drejt BE-së pavarësisht sfidave për të adresuar pasojat e trefishta të tërmetit të 2019, pandemisë COVID-19 dhe së fundi agresionit Rus kundër Ukrainës¹. Nën drejtimin e Ministrisë së Brendshme, gjatë vitit 2022, është punuar për hartimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore dhe planin e veprimit, 2023-2030.

Këshilli Konsultativ vijon të funksionojë si forumi kryesor për dialogun institucional dhe koordinimin ndërmjet qeverisë qendrore dhe qeverive vendore duke mundësuar konsultimin e një numri më të lartë të projekt-akteve të përgatitura nga ministritë e linjës në 7 takimet e KK të organizuara në vitin 2022 (gjithsej 47 projekt-akte të konsultuara nga 55 projekt-akte të prezantuara). Ndonëse niveli i pjesëmarrjes së ministrive të linjës është rritur gjatë vitit të raportimit, vijon problemi i mospërfaqësimit të ministrive të tyre me nivelin e duhur politik. Ndërkohë, vihet re një rritje e lehtë e nivelit të përfaqësimit të vetëqeverisjes vendore në krahasim me vitin 2021. Konsultimi me pushtetin vendor në procesin e miratimit të direktivave të BE-së në legjisllacionin kombëtar është një proces shumë i rëndësishëm. Për vitin 2022, 18 nga 47 akte ligjore, ose gjithsej 39% e akteve të miratuara adoptojnë një ose më shumë direktiva, duke u dhënë kështu një mundësi NJQV-ve për t'u informuar jo vetëm për ndryshimet ligjore, por edhe për efektet adoptimit të direktivave të BE-së sjellë në proceset e NJQV-ve.

Rrjeti i Njësive të Integrimit Evropian ka forcuar përfshirjen e NJQV-ve në procesin e anëtarësimit në BE, megjithatë, ndërrimi i shpeshtë i stafit të njësive rrezikon aftësinë e tyre për të performuar. Problemet me procedurat për hapjen e llogarive bankare të dedikuara si dhe rimbursimin e TVSH-së përbëjnë pengesa për bashkitë shqiptare për të marrë pjesë në projektet me financim nga Instrumenti i Para-Aderimit (IPA)².

1.1.2 Shërbimet dhe transformimi digjital

Në fushën e **shërbimeve dhe transformimit dixhital**, janë vendosur kornizat institucionale dhe ligjore për ofrimin e shërbimeve publike e për të siguruar një administratë publike të orientuar nga përdoruesi. Shqipëria u rendit e teta në Europë pas Sllovenisë për transformimin, kulturën e inovacionit dhe kodifikimin në legjisllacion dhe e nëntëmbëdhjeta në rang botëror, sipas një treguesi të ri të publikut nga Kombet e Bashkuara, për shërbimet publike dixhitale, sipas raportit "Busulla e Zhvillimit Dixhital"³.

Më shumë qytetarë kanë aplikuar pranë Zyrave me Një Ndalesë në vitin 2022, por sfida mbetet funksionimi i sistemit në të gjithë sektorët e bashkisë dhe azhurnimi i shërbimeve administrative në përputhje me ndryshimet ligjore dhe funksionet e vetëqeverisjes vendore. Prioritete për ofrimin e shërbimeve dixhitale janë rritja e sigurisë kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave personale, sigurimi i aksesit të platformës e-Albania nga personat me aftësi të kufizuar, krahas miratimit të standarteve të shërbimeve publike.

¹ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Tetor 2022)

² Raport i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Tetor 2022)

³ <https://e-albania.al/Pages/NewsDetail.aspx?id=750>; <https://akshi.gov.al/sherbimet-digjitale-okb-shqiperia-e-8-ta-ne-europe-e-19-ta-ne-bote/>

1.1.3. Administrata publike

Përmirësime janë bërë lidhur me forcimin e kapaciteteve **për konsultimin publik dhe vlerësimin e ndikimit rregullator**. Kanë filluar përgatitjet për reformën e pagave dhe është zgjeruar sistemi i automatizuar i listës së pagave. Vendi ka krijuar një platformë gjithëpërfshirëse për shërbimet dixhitale⁴.

Progres është arritur në monitorimin e orientuar drejt rezultateve, duke përfshirë analizën e performancës në institucionet e administratës publike dhe në NJVV. Në 2022, nën drejtimin e Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar një proces për analizën dhe sjelljen në standarde ligjore të strukturës organizative të bashkive, në bashkëpunim me DAP, Ministrinë e Brendshme/AMVV dhe Prefektin e Qarkut. Mesatarisht 15.5% e pozicioneve të punës në shërbimin civil nuk janë plotësuar dhe numrin më të lartë të pozicioneve të paplotësuara (rreth 20%) e kanë patur bashkitë dhe prefekurat⁵.

Sistemi HRMIS ka vijuar të plotësohet me të dhëna, ndonëse me një ritëm të ngadalshëm. HRMIS nuk përfshin të dhëna plotësisht të përditësuara për nëpunësit civilë. Më pak bashki e kanë patur sistemin HRMIS funksional në vitin 2022. Qeveria ka arritur të vendosë masa për të krijuar një mekanizëm koordinues ndërmjet nivelit qendror dhe vendor për monitorimin dhe vlerësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Është rritur numri i nëpunësve civilë në NJVV në vitin 2022 krahasuar me vitin 2020 dhe 2021, si dhe numri i femrave në shërbimin civil në nivel vendor (rreth 40,6% është norma mesatare e nëpunësve civilë femra ose 3.8 p.p më e lartë krahasuar me vitin 2021). **Gjithashtu, është rritur punësimi i femrave në pozicione drejtuese** gjatë vitit 2022 në krahasim me vitin 2021. Konstatohet që largimet nga administrata vendore gjatë vitit 2022 janë ulur në krahasim me vitet 2020-2021.

Kuadri i ri strategjik për Reformën në Administratën Publike parashikohet të miratohet gjatë vitit 2023. Zbatimi i Ligjit të Nëpunësit Civil mbetet për t'u përmirësuar në NJVV në të gjitha nivelet dhe për këtë nevojitet një nivel më i lartë bashkëpunimi midis institucioneve që janë pjesë e shërbimit civil. Gjithashtu, nevojitet të përfundojë procesi i harmonizimit ligjor me Kodin e Procedurave Administrative dhe aftësitë administrative dhe profesionale të nëpunësve civilë të nivelit vendor duhet të fuqizohen më tej.

Bashkitë kanë inkurajuar **pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen e tyre**, duke organizuar takime online të Këshillit Bashkiak dhe takime të hapura për publikun. **Transparenca buxhetore mbetet e kënaqshme me publikimin e dokumenteve kyçe buxhetore**, gjë që mundëson debat të mjaftueshëm publik, megjithatë, kuadri institucional për pjesëmarrje efektive dhe gjithëpërfshirëse ka nevojë për fuqizim të mëtejshëm⁶. Përmirësim është evidentuar në përgatitjen e buxhetit në një format të kuptueshëm për qytetarët – më shumë bashki kanë përgatitur buxhetin në një format të kuptueshëm për qytetarët. Gjithashtu, më shumë bashki kanë publikuar buxhetin vendor në faqen zyrtare të bashkisë në krahasim me vitin 2020 dhe 2021, si dhe më shumë dëgjesa publike janë organizuar me qytetarët dhe grupet vulnerabël në procesin e përgatitjes së buxhetit të ri vendor. Ka pësuar ulje norma mesatare e rekomandimeve të ofruara nga aktorë të shoqërisë civile dhe grupet e të tjera të interesit, të cilat janë marrë në konsideratë nga bashkia në dokumentin përfundimtar të PBA dhe buxhetin vjetor në vitin e raportimit 2022, në krahasim me vitin e mëparshëm.

Në përgatitjen e buxhetit afatmesëm dhe buxhetit vjetor, duhet të konsiderohet pasqyrimi i parashkimeve të treguesve ekonomikë dhe financiarë të buxhetit duke u bazuar në prioritetet e NJVV-ve⁷, si dhe duke mbajtur parasysh nivelin e dëshiruar të shërbimeve që u ofrohen qytetarëve.

⁴ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, Administrata Publike (Tetor 2022)

⁵ Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil në Kuvend (Maj 2022);

<http://www.kmshc.al/wp-content/uploads/2022/05/Fjala-e-Komisioneres-ne-Kuvend-date-30.05.2022-final.pdf>

⁶ Raport i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Tetor 2022)

Nevojitet një publikim në kohë i raporteve të ekzekutimit të buxhetit dhe i raportit të auditimit, në veçanti raportimi i detyrimeve të prapambetura nga NJVV⁸.

Përmirësim ka patur llogaridhënia e pushtetit vendor lidhur me normën e kthim-përgjigjeve të administratës vendore ndaj kërkesave të qytetarëve. Treguesi ka rritje të lehtë gjatë vitit 2022, në krahasim me vitin 2021 duke ruajtur një trend rritës për periudhën 2019-2022. Gjithashtu, ka patur rritje norma e publikimit të akteve të vendimmarrjes vendore (trend pozitive rritës për periudhën 2017-2022), pra konstatohet një rritje e lehtë e transparencës proaktive nga autoritetet publike qendrore dhe të varësisë si dhe në NJVV.

Shqipëria ka nënshkruar në vitin 2022 protokollet e Konventave CETS Nr.223 (108+)⁹ dhe CETS Nr. 205 të Këshillit të Evropës (KiE) - dy dokumenta të rëndësishme për forcimin e shtetit ligjor, demokracisë dhe respektimit të të drejtave themelore të njeriut. Dy projektligje u konsultuan gjatë vitit 2022, në Këshillin Konsultativ qeverisja qendrore - qeverisja vendore - projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin. Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe projektligji “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (Nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar). Ndryshimet ligjore synojnë të krijojnë një tërësi rregullash të njëtrajtshme në gjithë Bashkimin Evropian dhe në Shqipëri, të përshtatura për epokën dixhitale, me qëllim përmirësimin e sigurisë juridike dhe përforcimin e besimit të qytetarëve dhe ndërmarrjeve tek tregu unik dixhital¹⁰.

Sfida mbeten forcimi i bashkëpunimit ndërmjet agjensive shtetërore në nivel rajoni dhe institucioneve vendore për adresimin e çështjeve të rekomanduara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga diskriminimi, rritja e shkallës së njohjes së legjislacionit lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi. Kërkohet vëmendje e shtuar për rritjen profesionale, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale dhe përditësimi periodik i programit të transparencës, si dhe Regjistrin të kërkesave, duke qenë se përbëjnë burimet kryesore për marrjen e dokumentacionit publik.

1.1.4 Avokati i popullit

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore kanë marrë më pak rekomandime nga Avokati i Popullit, në vitin 2022, në krahasim me vitin 2021, ndërsa norma e pranimit dhe marrjes të masave respektive nga NJVV për adresimin e problematikës të ngritur nga Avokati i Popullit ka qenë më e lartë krahasuar me vitin 2021.

Rekomandohet rritja e transparencës ndaj publikut lidhur me zbatimin e rekomandimeve nëpërmjet publikimit nga NJVV të rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit në faqen zyrtare të bashkisë.

1.1.5. Shoqëria Civile

Numri gjithsej i **rekomandimeve të ofruara nga organizatat e shoqërisë civile për vendimmarrësit vendorë** gjatë vitit 2022 ka qenë më i lartë krahasuar me vitin 2021 por norma e pranimit/reflektimit nga organet vendimmarrëse të NJVV ka qenë pak më e ulët kundrejt 2021. Më shumë grante janë dhënë në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021.

⁷ Raporti i Përputhshmërisë së Monitorimit të Performancës në nivel Bashkie (Tetor 2022)

⁸ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, Qeverisja (tetor 2022)

⁹ Protokollin (CETS No. 223) për modernizimin e Konventës të Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e Individëve nga procedimi automatik i të dhënave personale dhe Konvetën për Aksesin në Dokumentet Zyrtare (CETS Nr. 205)

¹⁰ Agjencia për Vetëqeverisjen Vendore / Sekretariati i Këshillit Konsultativ

Më shumë transparencë dhe qasje proaktive nevojitet në ndarjen e informacionit nga institucionet publike, që do të kontribuonin në mekanizma bashkëpunimi efektive me OSHC në politikëbërje dhe vendimarrje si dhe në procesin e negociatave për anëtarësimin në BE¹¹.

1.2 Shteti i së Drejtës

1.2.1. Lufta kundër korrupsionit

Progres është shënuar në procesin e ngritjes së regjistrimit elektronik të kërkesave dhe ankesave në vitin 2022 duke arritur në 88% të Bashkive që kanë një regjistër elektronik funksional. Ky zhvillim pozitiv ka ndikuar edhe në rritjen e transparencës së Bashkive ndaj komunitetit si dhe organeve të tjera ligjzbatuese. I njëjti trend pozitiv është arritur në shkallën e zgjidhjes së kërkesave dhe ankesave të qytetarëve sipas afateve të përcaktuara në legjislacion **ku në vitin 2022 është raportuar në nivel mesatar prej 83%.**

Treguesit që mbeten ende në nivele jo të kënaqshme lidhen me numrin e konsiderueshëm të bashkive që nuk kanë ndjekur trajnime për çështje të luftës ndaj korrupsionit në 57 % si dhe mungesa e planeve të integritetit në 50% të bashkive.

Përpjekje të mëtejshme duhen bërë për përmirësimin e situatës në fushat më të prekura ndaj korrupsionit. Sektorët më të cënueshëm ndaj korrupsionit kërkojnë vlerësime të synuara të rrezikut dhe ndërmarrjen e veprimeve të dedikuara. Gjithashtu duhen adresuar në mënyrë efektive rekomandimet e Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsioni (GRECO) dhe zbatimi në kohë i planit të veprimit përkatës; adoptimi i Planeve të Integritetit dhe parandalimit të korrupsionit brenda të gjitha ministrive të linjës dhe autoriteteve shtetërore¹².

1.2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave

Numri i rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut të referuara dhe të trajtuara në Bashki ka ardhur gjithashtu në rritje. Bashkëpunimi ndër-institucional dhe me OJF-të që veprojnë në këtë fushë ka qënë në ritme të kënaqshme.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut në Bashki vazhdon të jetë prioritet dhe vëmendje i është kushtuar rritjes së kapaciteteve të nëpunësve vendor mbi çështjet e të drejtave të njeriut. Numri i trajnimeve dhe nëpunësve të trajnuar ka ardhur në rritje, megjithatë në 2022 janë ende 38% e Bashkive që nuk kanë përfituar asnjë program trajnimi.

Vëmendje më e madhe duhet ti kushtohet trajtimit dhe mbrojtjes së të drejtave të pakicave dhe grupeve të marginalizuara. Burimet financiare për trajtimin e çështjeve të referuara në bashki mbeten ende të kufizuara. Duhet të forcohet më tej bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë për të mundësuar zgjerimin e veprimtarisë së tyre në nivel lokal.

¹¹ Partnerët Shqipëri Për Ndryshim dhe Zhvillim, Matrica e Monitorimit Mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (28.07.2022). <http://partnersalbania.org/publication/matrica-e-monitorimit-mbi-mjedisin-mundesues-per-zhvillimin-e-shoqerise-civile-raporti-per-shqiperine-2021/>

¹² Progres Raporti i KE për Shqipërinë (2022)

KRITERI EKONOMIK

2

Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

Integrimi ekonomik me tregjet rajonale dhe europiane paraqet sfida të rëndësishme për operatorët ekonomikë vendas dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për të përballuar konkurrencën në rritje. Megjithë shtimin e numrit të iniciativave stimulese dhe shërbimeve të ndërmarra nga bashkitë për të mbështetur aktivitetin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme sërish financimi është në nivele të ulta.

Planet e Zhvillimit Vendor nuk janë miratuar ende në disa Bashki duke krijuar premisa për një zhvillim jo të qëndrueshëm të rajoneve, mos-shfrytëzim të potencialeve ekonomike dhe të integruar me prioritetet afatgjata. Kapacitet njerëzore dhe financiare të Bashkive për të mbështetur me aktivitete dhe financime direkte për krijimin e biznesve të reja mbeten shumë të ulta dhe e përqëndruar tek bashkitë e mëdha. **Hapja e bizneve të reja si edhe mbyllja e tyre ka vazhduar edhe gjatë vitit 2022 më po të njëjtin ritëm si në 2021.** Ky tregues dëshmon për dinamikat e tregut të lirë dhe ndikimin nga faktorë të jashtëm dhe efektet e pashmangshme të konkurrencës.

3.1

AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT

3.1 Kapitulli 11: Bujqësia dhe Zhvillimi dhe Rural

Kuadri ligjor është fuqizuar me hartimin dhe miratimin e ligjit¹³ “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Grupeve Vendore të Veprimit (GVV/LAG), projektligjin mbi bletarinë, projektligjin “Për vreshtarinë dhe verën” të cilat janë konsultuar edhe në Këshillin Konsultativ pushtet qendror – pushtet vendor. Financimi nga buxheti i shtetit është rritur me rreth 14% për përballimin e ndryshimeve klimatike, përsa i takon infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet¹⁴. Eksportet bujqësore shënuan një rritje me 15.6% për 10 mujorin 2022. Programi IPARD III (2022-2027) prej 146 milionë euro do të mbështesë për investime zhvillimin rural, duke përfshirë disa sektorë që më parë nuk përfshiheshin, si ulliri dhe vaji i ullirit, përpunimi i peshkut dhe bimët medicinale dhe do të kontribuojë në në çertifikimin e produkteve bujqësore¹⁵. Buxheti për bujqësinë për vitin 2023 (142 miliardë lekë) është 12% më i lartë në krahasim me vitin 2022.

Nuk është bërë progres lidhur me ngritjen dhe funksionimin e Zyrës të Informacionit dhe të Këshillimit Bujqësor (ZIKB). Fondi i alokuar për bujqësinë nga NJVV ka pësuar një rritje të lehtë në vitin 2022 krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit. Gjithashtu, përmirësim është bërë për administrimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujitjes dhe rrjetit të kullimit nga NJVV gjatë vitit 2022, që ka sjellë rritje të sipërfaqes së tokës bujqësore të ujitur krahasuar me vitin 2021, por duke arritur nivelin e vitit 2020.

Nevojitet realizimi në praktikë i një sërë nismash që kanë të bëjnë me zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme përballë sfidave të ndryshimeve klimatike, rritja e financimit nga qeveria dhe buxheti vendor për bujqësinë dhe zhvillimin rural krahas financimit nga programi IPARD¹⁶, përmirësimi i mëtejshëm i administrimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nga NJVV, hartimi i skemave ujitëse bazuar në buxhete specifike dhe në performancë shërbimi, ngritja e ZIKB pranë bashkive të tjera dhe ngritja/funksionimi i grupeve vendore të veprimit.

¹³ Ligj Nr. 36, datë 14.04.2022

¹⁴ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; <https://bujqesia.gov.al/ministrja-krifca-ne-konferencen-financimi-i-gjelber-14-rritje-te-buxhetit-per-perballimin-e-ndryshimeve-klimatike/>

¹⁵ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; <https://www.bujqesia.gov.al/>

¹⁶ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Tetor 2022)



Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare

Në vitin 2022, është ulur norma mesatare e tregjeve të shitjes me pakicë konform standarteve të kërkuara; Ky trend zbritës konstatohet gjithashtu në normën mesatare të tregjeve të kafshëve të gjalla të liçensura në krahasim me vitin e mëparshëm të raportimit, ndërsa vihet re rritje e numrit të qendrave për mbrojtjen e kafshëve nga NjVV. Lidhur me objektivin e funksionimit eficient të sistemit të mbrojtjes së konsumatorëve, konstatohet **një numër mjaft më i lartë i ankesave të qytetarëve mbi sigurinë ushqimore** të paraqitura pranë zyrës së konsumatorit në bashki, në vitin 2022, në krahasim me vitin e mëparshëm të raportimit, por nuk evidentohet progres në hapjen e zyrave të reja të konsumatorit në NjVV të tjera.

Gjithashtu, nevojitet ngritja e zyrës për mbrojtjen e konsumatorëve në NjVV e tjera dhe trajnimi i punonjësve të rinj, rritja e financimit nga ana e NJVV për të përmirësuar standardet e tregjeve publike dhe liçensimi i tyre plotë.



Politika e transportit

Progres është bërë në përafrimin e legjislacionit kombëtar për transportin rrugor duke miratuar një pjesë të legjislacionit zbatues për inspektimin teknik të mjeteve motorike. Kanë vijuar zbatimi i projekteve nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), që përfshin edhe infrastrukturën rrugore nga disa programe të financuara nga Banka Botërore (BB), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Qeveria Shqiptare në disa bashki të vendit, si Bashkia Shkodër, Sarandë, Gjirokastër, Fier, Korçë, Pogradec dhe investime nën programin 100 Fshatrat.

Progres është arritur në përmirësimin e rrjetit rrugor rural sipas standardeve dhe sinjalistikës rrugore krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit, ndërsa infrastruktura urbane paraqitet në të njëjtin nivel. Gjithashtu, evidentohet një rritje e normës së fshatrave të NJA të lidhura midis tyre nëpërmjet rrjetit rrugor. Financimi nga buxheti vendor për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve ka pësuar ulje në vitin 2022 krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit.

Ndonëse progres është arritur me publikimin e hartës së linjave të transportit publik, 36 NjVV (ose 56%) ende nuk e kanë përmbytur këtë masë. Lidhur me objektivin e nxitjes së ecjes në këmbë dhe përdorimit të biçikletës, evidentohet një rritje e rrjetit të lëvizjes më biçikleta (në veçanti për bashkinë Tiranë), si edhe e fushatave të promovimit të lëvizjes në këmbë dhe me biçikleta të ndërmarra nga bashkitë e vendit.

Nevojiten forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të menaxhimit dhe të financimit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor urban dhe rural të administruar nga NjVV në përputhje me standartet, përmirësimi i sinjalistikës rrugore, shtimi i linjave të transportit ndërrurban, përgatitja dhe publikimi i hartës të lëvizjes së mjeteve të transportit publik.

Gjithashtu, nevojiten përpjekje për të zbatuar plotësisht direktivën e sistemeve inteligjente të transportit (ITS) dhe për të nxitur multimodalitetin në përputhje me Planet e Veprimit të Komunitetit të Transportit, harmonizimi i legjisllacionit me acquis të BE-së për të drejtat e pasagjerëve në të gjitha llojet e transportit, si dhe ngritja e sistemeve për shkëmbimin elektronik të informacionit të transportit të mallrave¹⁷.

Energjia

Progres është bërë me zbatimin e Direktivës të Performancës Energjitike në Ndërtesa, përfshirë trajnimin dhe çertifikimin e audituesve të energjisë dhe të performancës energjitike¹⁸. Nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë janë trajnuar 93 Auditues të energjisë në ndërtesa, 11 Auditues të energjisë në instalime industriale, 153 Menaxherë të energjisë të çertifikuar¹⁹. Qeveria ka dhënë mbështetje nëpërmjet një skeme financiare për instalimin e ngrohësve të ujit (panelet diellore) - gjithsej 4000 familje përfituese.

Në kuadër të projektit të bashkive inteligjente të zbatuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, në bashkëpunim me SECO (në 4 bashki të vendit Korçë, Berat, Shkodër dhe Përmet) do të hartohen edhe planet vendore për EE (PVEE) për këto bashki, të cilat do të shërbejnë si modele për të gjitha bashkitë e vendit.

Progres është bërë në caktimin e menaxherit për efiçencën e energjisë, por më shumë se 50% e NjVV nuk e kanë caktuar dhe çertifikuar ende menaxherin për efiçencën e energjisë. Numri i projekteve të zbatuara sipas kërkesave të efiçencës së energjisë është rritur në krahasim me vitin e mëparshëm të raportimit. Gjithashtu, numri i kontrolleve të ndërrmarra gjatë vitit 2022 nga shërbimet bashkiake mbi zbatimin e kërkesave të efiçencës së energjisë në ndërtesa për shërbime publike dhe private është pothuajse dyfishuar krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit.

Sfida për NjVV mbeten caktimi dhe çertifikimi i menaxherit për efiçencën e energjisë në bashkëpunim me AEE dhe hartimi/miratimi dhe zbatimi i PVEE.

¹⁷ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2021)

¹⁸ Raporti për 2022 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë

<https://www.google.com/search?q=Progress+raport+on+Energy+Komunitetit>

¹⁹ Agjencia Kombëtare për Efiçencën e Energjisë (AEE); <http://eficenca.gov.al/>



Taksat

Në fushën e taksave, përparim është bërë në respektimin e planeve të pagesave të dakorduara për rimbursimet e TVSH-së dhe reduktimin e stokut të detyrimeve të prapambetura në rimbursimet e TVSH-së²⁰.

Ndryshime ligjore u miratuan me qëllim zëvendësimin e shpenzimeve vjetore të miratuara me shpenzimet vjetore faktike, në formulën e përlllogaritjes së përqindjes që zë vlera e stokut të detyrimeve të konstatuara dhe të papaguara, që kanë njësitë e vetëqeverisjes vendore ndaj palëve të treta. Bashkitë kanë patur performancë pozitive në të gjithë zërat e treguesve fiskalë në 2022. Të ardhurat vendore kanë konsoliduar, burime të qëndrueshme si të ardhurat nga taksat e pasurisë apo tarifave të pastrimit. Ecuria e reformës së decentralizimit ka nxjerrë si domosdoshmëri rritjen e përqindjes së transfertës së pakushtëzuar nga 1% të PBB në 1.2 deri 1.4%, me qëllim që vetëqeverisja vendore të ketë më shumë buxhet për të realizuar reformën e decentralizimit në disa sektorë, në të cilat shërbimet janë nën standardet minimale²¹.

Disa tregues të përformancës kanë patur trend rritës krahasuar me vitin e kaluar të raportimit si, më shumë programe të politikave tatimore janë zbatuar gjatë vitit të raportimit, është rritur ndjeshëm numri i inspektimeve në terren, të ndërmarrë nga administrata tatimore vendore me qëllim parandalimin e ekonomisë joformale, baza e debitorëve të bashkisë është e ngritur dhe bërë funksionale. Ulje ka patur numri i *dëgjësive publike* që shërbimet bashkiake kanë ndërmarrë me grupet e interesit, me qëllim informimin dhe përfshirjen e tyre në diskutimin e politikave tatimore të bashkisë.

Sfida mbeten përmirësimi i sistemit të administrimit të taksave vendore (digjitalizimi dhe unifikimi i sistemit për të gjitha bashkitë), informimi dhe ndërgjegjësimi për formalizimin e bizneseve, rritja e numrit të tatimpaguesve të kategorisë së qytetarëve që janë shpërngulur nga zona të tjera të vendit në disa bashki, kapacitete të kufizuara të inspektimit në terren në disa NjVV.

Rekomandohet zbatimi i masave për reduktimin e shpenzimeve tatimore, veçanërisht për shkak të përjashtimeve, thjeshtëzimi i sistemit të tatimeve duke inkurajuar rritjen e pajtueshmërisë së tatimeve²², forcimi i administrimit fiskal dhe zbatimi në shkallë të plotë i kadastrës fiskale në të gjitha NjVV.

²⁰ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

²¹ Ministria e Financave dhe Ekonomisë

²² Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)



Politikat sociale dhe punësimi

Zbatimi i politikave sociale dhe të punësimit ka patur një zhvillim të kufizuar gjatë vitit 2022. Kanë vijuar përpjekjet e bashkive për të ngritur Sektorin e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit i cili tashmë është bërë funksional në 43% të Bashkive. Ndërkohë që buxheti i bashkive i planifikuar për shpenzime të kujdesit social në 2022 ka patur një planifikim prej vetëm 5% të buxhetit total të bashkive. *Gjithashtu, procesi i hartimit të planeve vendore dhe ngritja e bazës statistike për përfshirjen sociale nuk ka shënuar progres në vitin 2022 duke mbetur në të njëjtat nivele në raport me numrin total.*

Më tepër vëmendje i është kushtuar mbështetjes financiare së të rinjve që përfundojnë arsimin universitar dhe aftësimin profesional, për fillimin e një biznesi privat në fushën e tyre profesionale numri i të cilëve ka ardhur në rritje. **Është bashkëpunuar ngushtë me institucionet e tjera dhe 85 % e Bashkive kanë firmosur Memorandume Bashkëpunimi me Zyrën e Punës** për punësimin e të rinjve si edhe për ri-integrimin socio-ekonomik të personave të trajtuar me Ndihmë Ekonomike.

Hap i rëndësishëm për nxitjen e politikave dhe mbështetjen e të rinjve ka qënë **miratimi me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 26.10.2022 i Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029.** Në lidhje me politikat e punësimit rinor Strategjia Kombëtare e Rinisë harmonizohet me Strategjinë për Punësim dhe Aftësim që ka si qëllim kryesor të identifikojë dhe hartojë politikat e duhura për punësimin dhe formimin profesional të fuqisë punëtore, në mënyrë që të krijojë vende pune dhe mundësi cilësore për punësim dhe aftësi përgjatë gjithë ciklit të jetës.



Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumentave strukturorë

Iniciativat ndërmjet Bashkive dhe bashkëpunimi në nivel Rajonal dhe European kanë ardhur në rritje. 55 % e Bashkive kanë patur bashkëpunime apo pjesëmarrje në projekte të përbashkëta rajonale. Megjithatë, kapacitetet e bashkive për përthithjen e financimeve nga fondet e BE-së dhe donatorëve të tjerë me përfitues disa bashki mbeten ende të kufizuara dhe të varura nga partnerët e vendeve të rajonit apo ato europianë.

Hap pozitiv shënoi miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 497 datë 27.07.2022 “Për krijimin, përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin”. Hapat e mëtejshme të nevojshme janë: të hartohet strategjia dhe plani kombëtar për zhvillimin dhe kohezionin rajonal (2021-2027) dhe të plotësohen planet e zhvillimit rajonal (2021-2024).

Këto plane synojnë të nxisin potencialin e zhvillimit përmes ndërhyrjeve të decentralizuara dhe të integruara lokale dhe rajonale. Një tjetër hap i rëndësishëm është sqarimi i përgjegjësive ndërmjet autoriteteve qendrore dhe vendore dhe forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative të organeve qendrore, rajonale dhe vendore, veçanërisht, duke siguruar personel adekuat dhe duke rishikuar strukturën e pagave të qeverisjes vendore si dhe duke mbajtur decentralizimin fiskal në krye të axhendës²³.



Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Edhe në vitin 2022 kanë vazhduar përpjekjet e bashkive për të zbatuar detyrimet ligjore dhe rritur kapacitetet e tyre në mbrotjen dhe promovimin e të drejtave themelore. Progres është shënuar në rritjen e numrit të punonjësve socialë për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) me dyfishim të tyre në vitin 2022. Është rritur bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe projektet e donatorëve në mbrotje të të drejtave të pakicave por sistemi i monitorimit për shkeljen e të drejtave funksionon në vetëm 33% të Bashkive.

Sfidë mbeten kapacitetet njërëzore të pamjaftueshme për të menaxhuar rastet e shkeljes së të drejtave si dhe burimet financiare shumë të limituara. Megjithëse treguesi ka pësuar rritje nga vitet e kaluara ai sërish mbetet në nivele të ulëta në krahasim me nevojat e bashkive për të trajtuar të gjitha rastet. *Ka ende mungesë të theksuar planifikimi të buxhetit me ndjeshmëri gjinore në një numër të konsiderueshëm të bashkive. Kështu, në vitin 2022 ai nuk është realizuar në 66% të bashkive.*

Raporti i Komisionit Evropian i vitit 2022 thekson se nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar një përgjigje adekuate dhe sistematike për të gjitha llojet e dhunës ndaj fëmijëve. Duhet të miratohet një kuadër ligjor më gjithëpërfshirës mbi statusin dhe përgjegjësitë e punonjësve socialë. **Nevojiten përpjekje më të fuqishme për të trajtuar diskriminimin dhe dhunën ndaj personave me aftësi të kufizuara,** për të përmirësuar aksesin e përgjithshëm, për të promovuar punësimin dhe për të mbledhur të dhëna statistikore për situatën e tyre.

Cilësia e arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht për fëmijët me dëmtim të dëgjimit, vazhdon të jetë shqetësim. Mbetet një numër i pamjaftueshëm i asistentëve për fëmijët me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor parauniversitar. Nevojiten përpjekje shtesë për të ofruar trajnime mbi qasjet e arsimit gjithëpërfshirës për të gjithë mësuesit dhe zbulimi i hershëm i aftësisë së kufizuar. Diskriminimi ndaj personave lezbikë, homoseksualë, biseksualë, transgjinorë, interseks dhe queer (LGBTIQ) është ende shumë i përhapur, veçanërisht në lidhje me aksesin në kujdesin shëndetësor, arsimimin, drejtësinë, punësimin dhe strehimin²⁴.

²³ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022)

²⁴ Raport i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022)



Drejtësia, liria dhe siguria

Në vitin 2022 kanë vijuar përpjekjet e Bashkive për zbatimin e masave të parashikuara në Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda gjatë periudhës 2021-2025 dhe Planin e Veprimit 2021-2022, miratuar në vitin 2021. Në përputhje me funksionet e qeverisjes vendore të lidhura me çështjet e drejtësisë dhe sigurisë **progres është bërë nga bashkitë në ngritjen e Këshillit të Sigurisë Vendore**, si një mekanizëm në luftën kundër krimit të organizuar tashmë funksional në 77% të Bashkive. Por nuk ka vijuar me të njëjtat ritme hartimi i Strategjisë për Sigurinë Publike në nivel vendor ku janë ende 40% e bashkive që nuk kanë një strategji të miratuar. Gjithashtu **ngritja e Zyrës së Policimit në komunitet**, në secilën njësi administrative nuk ka bërë progres domethënës.

Prioritet mbetet krijimi i besueshmërisë dhe rritja e sigurisë së komunitetit përmes policimit në komunitet. Policia e Shtetit në raportin e monitorimit të vitit 2022 të Ministrisë së Brendshme thekson se në punën e saj do të rrisë masat për identifikimin e zonave me risk të lartë dhe ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të policimit në komunitet dhe mekanizmave të referimit të problematikës. Bashkëpunimi me komunitetin, strukturat vendore dhe realizimi i fushatave ndërgjegjësuese të policisë në zonat me rrezik të lartë mbeten prioritare për të promovuar policimin në komunitet dhe rolet e tyre për komunitetin.



Arsimi dhe Kultura

Arsimi dhe Kultura janë dy funksione të rëndësishme të qeverisjes vendore në zbatim të Ligjit për Vetëqeverisjen Vendore. Megjithë progresin e bërë në nivel qendror me miratimin e Strategjive sektoriale dhe Legjislacionit përkatës sërisht bashkitë hasin vështirësi në zbatimin e politikave. **Edhe në vitin 2022 vihet re mungesa e buxheteve të bashkive për të investuar në infrastrukturën e kopshteve dhe shkollave.** Fondi i alokuar nga buxheti vendor për rindërtimin e kopshteve ekzistuese ose ndërtimin e kopshteve të reja është vetëm 2.53 % e buxhetit total vjetor. **Ka patur progres në parashikimin e infrastrukturës PAK në projektet për rindërtimin dhe ndërtimin e shkollave në 82% të bashkive.**

Sfidë mbetet ruajtja dhe mirëmbajtja e objekteve të trashëgimisë kulturore. Problematika e ndërtimeve të paligjshme në zonat e trashëgimisë kulturore është evedente dhe në vitin 2022 si dhe kufizimet e buxhetit vendor për aktivitete kulturore të harmonizuara me nevojat e komunitetit.

Rritja e ndërgjegjësimit të banorëve dhe bashkëpunimi i ngushtë me strukturat e policisë dhe institucionet e tjera qendrore për parandalimin dhe dënimin e rasteve të shkeljeve është i një rëndësie të veçantë. Hartimi i planeve për mbrojtjen dhe zhvillimin e objekteve të trashëgimisë kulturore si dhe alokimi i buxheteve për investime dhe mirëmbajtje është një problematikë që kërkon adresimin e duhur dhe të qëndrueshëm.

Sipas Raportit të BE-së në 2022, **nevojiten më shumë burime për të modernizuar sistemin arsimor** dhe për të siguruar cilësi, barazi dhe gjithëpërfshirje në arsimim për të gjithë nxënësit. Autonomia financiare e shkollës nuk ka përparuar, pasi aktet nënligjore dhe dispozitat për sigurimin e autonomisë aktuale financiare në shkollë nuk janë zhvilluar. Masat kundër korrupsionit vazhdojnë të kenë një ndikim të kufizuar në arsim, i cili mbetet një sektor veçanërisht i cënueshëm në këtë aspekt.



Mjedisi dhe ndryshimet klimatike

Mjedisi dhe ndryshimet klimatike janë sektorë me impakt të madh në zhvillimin e qëndrueshëm, të harmonizuar me acquis të BE-së dhe me standartet evropiane për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Progres i moderuar është bërë në hartimin e planeve vendore të veprimit në zbatim të politikave qendrore. Kështu, 78 % e bashkive nuk kanë një plan vendor veprimi për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Po ashtu hartimi i planit vendor për zbutjen e rreziqeve të ndryshimit të klimës është realizuar vetëm nga 20% e Bashkive. Ndërkohë që hartimi i Planit Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (MIM) është bërë nga 40% e Bashkive. **Progres i mirë është bërë në hartimin e planeve për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor (të kullotave) nga 62% e Bashkive.**

Ka vazhduar me ritme të kënaqshme trajnimi i nëpunësve vendorë mbi legjislacionin dhe zbatimin e masave të politikave qendrore në fushën e mjedisit. Gjithashtu, numri i specialistëve të punësuar dhe trajnuar në nivel vendor për ndryshimet klimatike, eficiencën e energjisë dhe energjitë e rinovueshme është 8 herë më i lartë nga viti 2021. Në lidhje me **emergjencat civile progresi është i madh** në ngritjen e shtabeve dhe strukturën e emergjencave civile në gjithë territorin e vendit.

Sektori i furnizimit me ujë dhe kanalzimeve ende përballet me problematikat e shtrirjes së shërbimit në gjithë territorin e vendit kryesisht në zonat rurale si dhe reduktimin e humbjeve nga ndërhyrjet e paligjshme në rrjet.

Raporti i BE i vitit 2022 thekson se performanca e sektorit të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve mbetet e ulët dhe Shqipëria duhet të përforcojë dhe përshpejtojë më tej masat e reformës së ujit²⁵. Në lidhje me hapat e mëtejshme në fushën e Mjedisit raporti i BE në vitin 2022 thekson se duhet të merren masa të menjëhershme për të rishikuar dhe përmirësuar ndikimin mjedisor dhe strategjik në vlerësimet për projektet, planet dhe programet ekzistuese dhe të planifikuara, veçanërisht në sektorët e hidroenergjisë, ndërtimit, turizmit, transportit dhe minierave²⁶.



Kontrolli Financiar

Të ardhurat e veta të pushtetit vendor janë realizuar në vlerën 24.4 miliard lekë (ato përbëjnë 6% të totalit të të ardhurave publike). **Krahasuar me vitin 2021 të ardhurat vendore janë rritur me 5.5%.** Është rritur lehtë norma mesatare e realizimit të të ardhurave vendore në vitin 2022 krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit. Shpenzimet e pushtetit vendor, në 9 mujin e 2022, kanë qenë 38.7 miliard lekë ose 64% të shpenzimeve të planifikuara prej 60.2 miliard lekë. Krahasuar me një vit më parë, buxheti vendor është realizuar rreth 6% më shumë (ose 2.1 miliard lekë)²⁷. Rreth 54% të totalit të shpenzimeve i ka mbuluar transferta e pakushtëzuar dhe 45% nga të ardhurat e veta²⁸.

Më shumë dëgjesa publike mbi ekzekutimin e buxhetit janë organizuar nga NjVV krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit. Për përmirësimin e gjendjes së subjekteve të audituara (NjVV) nga KLSH, për efekte negative në menaxhimin me efikasitet dhe efektivitet të shpenzimeve gjatë 2022, janë dhënë një numër masash organizative, masa për shpërblim dëmi, masa administrative dhe masa disiplinore.

Sfida për bashkitë mbetet rritja e zbatueshmërisë të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, përmirësimi i performancës në administrimin e të ardhurave, rritja e efektivitetit në realizimin e shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve me cilësi dhe standarte, si dhe ulja e borxheve.

Përparësi për qeverinë është sigurimi i qëndrueshmërisë dhe rritja e transfertës së pakushtëzuar mbi 1% të PPB me qëllim që qeverisja vendore të ketë më shumë buxhet për të realizuar reformën e decentralizimit në disa sektorë në të cilat shërbimet janë nën standardet minimale dhe kërkohet përmirësimi i formulës së transfertës së pakushtëzuar²⁹.

²⁵ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022)

²⁶ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022)

²⁷ Raporti i Treguesve Fiskalë Vendorë (2022), Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Projekti Financat Lokale

²⁸ Raporti i Treguesve Fiskalë Vendorë (2022), Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Projekti Financat Lokale

²⁹ Minutat e Këshillit Konsultativ (Vendim nr.6 datë 28/10/2022)


HYRJE

Ky është raporti i gjashtë kombëtar i vlerësimit të arritjeve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) në funksion të procesit të integrimit evropian në nivel vendor dhe në fushat kryesore të cilat lidhen me kriterin politik, kriterin ekonomik dhe aftësinë për të realizuar detyrimet e anëtarësimit të Shqipërisë.

Monitorimi i performancës mbi bazën e analizës së treguesve për sektorë dhe fusha të ndryshme, përfshijnë demokracinë vendore, qeverisjen, shtetin e së drejtës, administratën publike, zbatimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit, të drejtat e njeriut, ekzistencën e ekonomisë së tregut funksionale, si dhe aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit në fusha specifike, të tilla si bujqësia dhe zhvillimi rural, siguria ushqimore, politikat e transportit, energjia, taksat, gjyqësori dhe të drejtat themelore, arsimit dhe kultura, mjedisi dhe ndryshimi i klimës, financat vendore dhe kontrolli financiar. Ky raport analizon informacionin për treguesit për vitin e raportimit 2021, duke bërë një krahasim për disa tregues të performancës me vitet 2017 – 2021. Të dhënat e raporteve të vlerësimit, duke filluar nga viti 2018 publikohen në faqen e internetit të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, si dhe on-line në adresën <https://mapping-bpe.al/goDataAnalyze/online.aspx>.

Ecuria e përbushjes së detyrimeve që dalin përpara bashkive për zbatimin e axhendës së integrimit evropian edhe në këtë raport bazohet në treguesit e vlerësimit të dakordësuar më ministrinë e linjës në përputhje me kapitujt në të cilat bashkitë kanë një rol aktiv si dhe të konsultuar me 61 bashkitë. Bazuar në raportet e ofruara nga bashkitë ecuria në mënyrë të përmbledhur paraqitet në grafikun e mëposhtëm. Një vlerësim i detajuar i ecurisë së përbushjes së treguesve në mënyrë individuale paraqitet në shtojcën 1 në fund të raportit.

Grafiku 1: Niveli i përgjithshëm i ecurisë në arritjen e treguesve v.2022



Metodologjia dhe Sistemi i të dhënave

Burim parësor i të dhënave në analizën e raportit janë të dhënat e plotësuara nga NJQV për vitin 2022. Raporti i Vlerësimit të NJQV në procesin e integrimit evropian, për vitin 2022, mbulon të 61 bashkitë bazuar në të dhënat e raportuara nga Njësitë e Integrimit Evropian në bashki, nëpërmjet Sistemit On-Line të Raportimit për më shumë se 240 tregues, sipas fushave kryesore të tre kritereve të anëtarësimit. Duhet theksuar se shkalla e plotësimit të treguesve ndryshon ndërmjet bashkive. Saktësia e të dhënave të raportuara është përgjegjësi vetëm e bashkive.



Krahas të dhëna të analizuar nga informacioni i hedhur në Sistemin On-Line të Monitorimit të Performancës, raporti është pasuruar edhe me të dhëna dytësore, bazuar në rishikimin e ligjeve dhe akteve nën ligjore të miratuara gjatë vitit 2022, mbi bazën e të cilave NJQV kanë rol dhe detyra specifike, si dhe bazuar në rishikimin e dokumenteve strategjike dhe raporteve të monitorimit të ministrive të linjës për vitin 2022. (Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2022, të dhëna nga INSTAT ndonëse statistikave jepen në nivel qarku dhe jo në nivel bashkie).

Raporti bën një analizë krahasuese ndërmjet bashkive sipas fushave të ndryshme dhe identifikon praktikën e mira, problemet dhe sfidat në realizimin e politikave vendore në përgjigje të sfidave të zhvillimit kombëtar, politikave sektoriale dhe agjendës së integrimit evropian.

Raporti jep të dhëna të llogaritura për shumën, mesataren ose numërimin për tregues të ndryshëm të cilët kanë ofruar të dhëna të vlefshme. Treguesit janë të matshëm (numerikë, ose të shprehur në përqindje), afirmative për disa objektiva dhe prioritetet që lidhen me zbatimin e politikave të qeverisë qendrore në nivel vendor dhe në kuadër të procesit të anëtarësimit. Treguesit prezantojnë situatën në secilën bashki sipas kritereve të vlerësimit dhe përkundrejt standardeve (ku ka qenë e mundur). Bashkitë, që nuk kanë ofruar të dhëna për ndonjë tregues të veçantë, janë paraqitur në hartë (në ngjyrë gri) ose me shpjegime në fund-shënime. Të dhënat e kapitullit të financave vendore / dhe kontrollit financiar janë siguruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Duhet theksuar se nivelet e bashkive për mbajtjen e statistikave në mënyrë të unifikuar dhe sistematike mbetet problematike. Zyrat e Performancës që pritet të ngrihen në bashki duhet të sigurojnë edhe grumbullimin dhe mbajtjen sistematike të të dhënave të vlerësimit.

Gjithashtu bashkitë duhet të pajisen me sisteme on-line të mbajtjes së të dhënave për të siguruar cilësinë e tyre, saktësinë e të dhënave historike për treguesit që Bashkia grumbullon e raporton. Mbajtja e sistemeve on-line të të dhënave do të eliminonte gabimet raportimet e të dhënave krahasuese sipas viteve.



KRITERI POLITIK

*Qëndrueshmëria e institucioneve që garantojnë
demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e
njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e pakicave*



1.1 Demokracia

1.1.1. Qeverisja

“Në vitin 2022, Ministria e Brendshme drejtoi punën për hartimin e dokumentit të ri të politikës për decentralizimin dhe qeverisjen vendore, në zbatim të Udhërit të Kryeministrit nr. 76, datë 22.04.2022 “Për krijimin e grupit politik ndërinstytucional dhe grupeve teknike të punës për hartimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore dhe planin e veprimit të saj, 2023-2030. Shoqatat e pushtetit vendor u bënë pjesë e grupit të punës, duke lehtësuar identifikimin e mangësive, sfidave dhe zgjidhjeve në takimet e organizuara me përfaqësues të bashkive.

Ministria e Brendshme dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) kanë vazhduar përpjekjet në procesin e harmonizimit ligjor në koordinim me ministrinë e linjës, për hartimin e akteve nënligjore sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, për funksionet e deleguara të njësive të vetëqeverisjes vendore³⁰. Gjithsej 58 projektakte të përgatitura nga ministri të linjës dhe institucione të tjera u dorëzuan për konsultim në Këshillin Konsultativ qeveri qendrore-vetëqeverisja vendore gjatë vitit 2022.

NJVV kanë përfunduar më mirë në drejtim të administrimit të të ardhurave të veta. Burimi më i rëndësishëm i të ardhurave vazhdon të mbetet taksa e ndikimit në infrastrukturë me rreth 36% të të ardhurave të veta vendore. Menaxhimi financiar në nivel vendor është konsoliduar me rreth 2.2 miliard lekë më shumë shpenzime krahasuar me një vit më parë. Shpenzimet për investime përbëjnë 17.3% të totalit të buxhetit vendor, me një rënie prej 8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Njësive të qeverisjes vendore ende u mungojnë burimet e mjaftueshme financiare dhe kapacitetet administrative për të ushtruar me efektivitet kompetencat e tyre më të mëdha në politikëbërje dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët.

Rrjeti i Njësive të Integritit Evropian ka forcuar përfshirjen e NJQV-ve në procesin e anëtarësimit në BE. Megjithatë, ndërrimi i shpeshtë i stafit në njësitë bashkiake të BE-së rrezikon aftësinë e tyre për të performuar. Procedurat komplekse për hapjen e llogarive bankare të dedikuara si dhe për marrjen e rimbursimit të TVSH-së përbëjnë gjithashtu pengesa serioze për bashkitë shqiptare për të marrë pjesë në projektet me financim nga Instrumenti i Para-Aderimit (IPA)³¹.

Objektivi specifik: Përmirësimi i koordinimit të qeverisë qendrore dhe vendore nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit efektiv të Këshillit Konsultativ

Këshilli Konsultativ³² KK) vazhdon të funksionojë si forumi kryesor për dialogun institucional dhe koordinimin ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor. Në vitin 2022, KK ka ushtruar aktivitetin me efektivitet duke mundësuar konsultimin e një numri më të lartë të projektakteve të përgatitura nga ministrinë e linjës.

³⁰ Në zbatim të Udhërit të Kryeministrit nr.101, datë 03.07.2019 “Për hartimin e akteve nënligjore nga ministrinë e linjës sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, për funksionet e deleguara njësive të vetëqeverisjes vendore


³¹ Raport i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Tetor 2022)

³² Organ Kolegjial i krijuar me VKM nr.910, datë 21.12.2016 “Për çështjet objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e te funksionimit të këshillit konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”, ndryshuar me vkm nr.751, datë 19.12.2018, nr. 456, datë 10.6.2020



Objekt i konsultimit kanë qenë projektaktet ligjore të institucioneve qendrore, projektakte të lidhura me funksionet e deleguara të NJVV në zbatim të Udhërit të Kryeministrit Nr. 101, datë 03.07.2019 “Për hartimin e akteve nënligjore nga ministrinë e linjës sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, për funksionet e deleguara njësisive të vetëqeverisjes vendore”, udhëzues për NJVV, dokumente të politikave të reja sektoriale dhe raporte studimore. Konkretisht, janë konsultuar 47 projekt-akte nga 55 të dërguara nga institucionet e qeverisjes qendrore (ose 82.5% të projektakteve të dërguara për konsultim), 10 projektligje, midis të cilave projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes vendore”, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin. Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, projektligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, projektligji “Për Bletarinë”, 31 projektvendime, projekt-udhëzimi për NJVV “Buxhetime i Përgjigjshëm për Integrimin e pakicave Rome dhe Egjiptiane” dhe 4 draft strategji: Strategjia Kombëtare për Shendetësinë 2023-2030, Strategjia Kombëtare për Sektorin e Ujësjellës dhe Kanalizimeve 2023-2030, Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (2023-2030). Gjithsej janë miratuar në parim 47 projektakte nga dy bashkëkryetarët e KK, ndërsa 8 projektakte të tjera, të sjella për konsultim në kohë të shkurtër, janë miratuar në parim.

Gjithsej janë realizuar 7 takime të KK në vitin 2022, krahasuar me 6 takime në vitin 2021. Aktiviteti i shtuar në procesin e konsultimit mes institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore është karakterizuar me rritje të pjesëmarrjes në takime të anëtarëve të KK dhe të qeverisjes vendore.

Grafiku 2: Numri i akteve ligjore të miratuara që kanë kaluar procedurën e konsultimit në KK, 2017-2022




Grafiku 3 dhe 4: Projekt-akte të inicuar nga ministrinë e linjës dhe të diskutuara në KK, 2022³³



³³ Burim: Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV)

Konsultimi me pushtetin vendor në procesin e miratimit të direktivave të BE-së në legjislacionin kombëtar është një proces shumë i rëndësishëm. Përveç procesit të konsultimit të ministrive të veçanta që zhvillohen për akte të veçanta ligjore të rëndësishme, NJQV-të kanë mundësinë të japin kontributin e tyre shtesë në momentin që këto akte ligjore diskutohen në Këshillin Konsultativ. Për vitin 2022, 18 nga 47 akte ligjore, ose gjithsej 39% e akteve të miratuara adoptojnë një ose më shumë direktiva, duke u dhënë kështu një mundësi NJQV-ve për t'u informuar jo vetëm për ndryshimet ligjore, por edhe për përputhshmërinë me legjislacionin dhe efektet nga adoptimi i direktivave të BE-së në proceset e NJQV-ve.

Grafiku 5: Aktet ligjore të konsultuara që miratojnë direktivat e BE-së në vitin 2022



Niveli i përfaqësimit të qeverisë qendrore dhe vendore: KK ka 22 anëtarë, nga të cilët 11 anëtarë (50%) janë nga pushteti vendor. Gjatë vitit 2022, në takimet e KK kanë qenë të pranishëm, mesatarisht, rreth 80% e ministrive të linjës; 4 ministri të linjës (36% të 11 ministrive) kanë marrë pjesë në të gjitha takimet. Pesë (5) ministri të linjës janë përfaqësuar me Zv. Ministrin dhe 2 ministri me Ministrin në 2 takime. Niveli i përfaqësimit të ministrive të linjës ka vijuar të jetë jo në nivelin e duhur të përfaqësimit, si edhe në vitet e mëparshme të raportimit. Konstatohet se niveli i përfaqësimit të ministrisë është i duhur në rastet kur konsultohet një projektakt i dorëzuar nga institucioni përgjegjës. Mesatarisht, 7 anëtarë nga qeverisja vendore (64%) kanë qenë të pranishëm në takimet e KK, ndërsa numri i bashkive pjesëmarrëse ka ndryshuar nga 7 në 40. Mesatarisht, 8 bashki pjesëmarrëse (13%) janë përfaqësuar me Kryetarin në takimet e KK – vihet re një rritje e lehtë e nivelit të përfaqësimit të qeverisjes vendore në krahasim me vitin e mëparshëm të raportimit (10%).

Sekretariati Teknik i KK, pjesë e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), ka koordinuar takimet e KK, duke siguruar shpërndarjen në kohë të projektakteve dhe të materialeve që kanë qenë objekt i konsultimit, duke kontribuar në rritjen e transparencës në procesin e formulimit dhe miratimit të projektakteve dhe të politikave me impakt për vetëqeverisjen vendore. Gjithashtu, AMVV ka dhënë një kontribut të veçantë në koordinimin e procesit midis institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore për hartimin e draft Strategjisë së re për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2023-2030, krahas aktivitetit të saj të rregullt dhe mbështetjes në koordinimin e aktiviteteve të ndryshme si pjesë e projekteve me financim të huaj në mbështetje të reformës për decentralizimin dhe vetëqeverisjen vendore - Bashkitë për Evropë³⁴, STAR³⁵ dhe Bashki të Forta³⁶ e projekte të tjera.

³⁴ Bashkitë për Evropë – një projekt i financuar nga fondet IPA (BE)

³⁵ Projekt i financuar nga disa donatorë – UNDP, BE, SDC, Qeveria Italiane dhe SIDA

³⁶ Bashki të Forta – një projekt i financuar nga SDC dhe zbatuar nga Helvetas

Probleme dhe sfida

- Niveli i përfaqësimit të qeverisë qendrore në përputhje me parashikimet ligjore dhe rritja e pjesëmarrjes së NJVV në takimet e Këshillit Konsultativ.
- Kapacitetet e NJVV për të ndërmarrë iniciativa për ndryshime ligjore nga vetë bashkitë për të adresuar problematikat e konstatuara në zbatimin e kuadrit ligjor ekzistues.
- Problemet e bashkëfinancimit dhe para-financimit për projekte në nivel vendor dhe procedurat komplekse për hapjen e llogarive bankare të dedikuara, si dhe rimbursimin e TVSH-së (për projektet me financim nga IPA).
- Ndërrimi i shpeshtë i stafit në Njësitë e Integrimit Evropian të bashkive rrezikon qëndrueshmërinë e tyre dhe aftësinë e tyre për të përformuar³⁷.

Rekomandime

Rekomandimet mbeten të vlefshme edhe për këtë raportim:

- Konsultimet me NJVV për çdo ndryshim ligjor që ndikon në vetëqeverisjen vendore duhet të iniciohen që në fillim të procesit për të ndihmuar që të kryhet një analizë më e plotë të ndikimeve social-ekonomike. AMVV duhet të mundësojë lehtësimin e analizës dhe të konsultimit me NJVV.
- AMVV duhet të ketë një qasje më proaktive për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve dhe komenteve të KK në procesin final të rishikimit dhe miratimit të projektaktit.

Ngritja e Zyrave me Një Ndalesë për Shërbimet Publike

Objektivi specifik: qeverisja e hapur, llogaridhënia dhe qeverisja elektronike në nivel vendor

Kornizat institucionale dhe ligjore për ofrimin e shërbimeve publike janë vendosur për të siguruar një administratë publike të orientuar nga përdoruesi. Numri i shërbimeve me një ndalesë dhe e-shërbimeve, edhe pse në nivele të ndryshme automatizimi vazhdoi të rritet dhe, informacioni për qytetarët mbi shërbimet publike u bë më i aksesueshëm.

Në vitin 2022, u miratua strategjia ndërsektoriale “Agjenda dixhitale e Shqipërisë” dhe Plani i Veprimit (2022 – 2026) me vendim të Këshillit të Ministrave³⁸, si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 252, datë 29.04.2022, “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve online nga institucionet shërbim-ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative”.

Duke ju referuar raportit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) “Busulla e Zhvillimit Dixhital”, Shqipëria u rendit e teta në Europë (5.21 pikë) pas Sllovenisë, për transformimin, kulturë inovacioni dhe kodifikim në legjislacion dhe e nëntëmbëdhjeta në rang botëror, sipas një treguesi të ri të publikuar nga Kombet e Bashkuara për shërbimet publike dixhitale³⁹.

³⁷ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Tetor 2022)

³⁸ VKM Nr. 370, datë 1.6.2022 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale “Agjenda digjitale e Shqipërisë”

³⁹ <https://e-albania.al/Pages/NewsDetail.aspx?id=750>; <https://akshi.gov.al/sherbimet-digjitale-okb-shqiperia-e-8-ta-ne-europe-e-19-ta-ne-bote/>


Grafiku 6: Busulla e Zhvillimit Dixhital, pikët sipas kriterëve të vlerësimit




Në kuadër të Projektit STAR III u siguroa mbështetje për përmirësimin e infrastrukturës së sistemeve TI në disa bashki të vendit, si dhe asistencë për mirëmbajtjen e sistemeve të ZNJN. Bashkitë kanë testuar dhe miratuar zgjerimin e funksionalitetit të ZNJN në 33 njësi administrative⁴⁰. Në maj 2022, qeveria vendosi të mbyllë të gjitha zyrat ‘front-office’ që ofrojnë shërbime administrative kombëtare në nivel lokal, duke lëvizur plotësisht drejt shërbimeve online. Ministri i Brendshëm rekomandoi hartimin e një udhërrëfyese për futjen e pushtetit vendor në transformimin dixhital dhe kalimin në shërbimet online⁴¹.

Zyrat me Një Ndalesë (ZNJN) janë të ngritura në të gjitha bashkitë e vendit, ndonëse Bashkia Durrës, Vlorë, dhe Memaliaj nuk kanë raportuar për këtë tregues. Në nivel vendi janë hapur gjithsej 11 qendra të integruara të cilat ofrojnë shërbime online të portalit e-Albania dhe shërbime vendore. Në vitin 2022 u hap Qendra e Integruar në Kamëz krahas qendrave në Tiranë, Kombinat Tiranë, Kavajë, Krujë, Fier, Gjirokastrë, Shkodër, Lushnjë, Elbasan, Pogradec.

Harta 1: Zyrat me Një Ndalesë 2022⁴²



Grafiku 7: Zgjerimi i sistemit të ZNJN në vite, 2017-2022




⁴⁰ Projekti STAR III, Raporti i Progresit 2022

⁴¹ Projekti STAR III, Raporti i Progresit 2022

⁴² Burim i të dhënave është raportimi i bashkive

Në nivel kombëtar, mesatarisht numri i shërbimeve të ofruara nga ZNJN është 147 (tipe të ndryshme). Numri i aplikimeve të qytetarëve nëpërmjet ZNJN në vitin 2022 është rritur në masën 125% (42,248 aplikime krahasuar me 33,693 aplikime në vitin e mëparshëm të raportimit)⁴³.

Grafiku 8: Numri i aplikimeve në ZNJN, 2022⁴⁴



Probleme dhe sfida

- Sfidë është funksionimi i sistemit në të gjithë sektorët e bashkisë (sidomos tek sektori i emergjencave civile) në mënyrë që shërbimi për qytetarin të ofrohet në kohë dhe me lehtësira⁴⁵.
- Azhurnimi i shërbimeve administrative në përputhje me ndryshimet ligjore dhe funksionet e vetëqeverisjes vendore⁴⁶.
- Ndërveprimi efektiv ndërmjet institucioneve për lëshimin në kohë të dokumentave të kërkuara nga qytetarët nëpërmjet sistemit e-Albania.
- Trajnimi i stafëve në ato bashki ku janë ngritur qendrat e integruara me një ndalesë.
- Niveli i ndryshëm i aftësive të qytetarëve në përdorimin e platformës digjitale (psh. grupet vulnerabël dhe mosha e tretë), kufizon aksesimin e sistemit në marrjen e shërbimeve.

Rekomandime

- Rritja e sigurisë kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave personale.
- Sigurimi i aksesit të platformës e-Albania nga personat me aftësi të kufizuara⁴⁷.
- Zhvillimi dhe miratimi i standardeve minimale të shërbimeve publike.

⁴³ Projekti STAR III, Raport Progresi (2022)

⁴⁴ Projekti STAR III, Raport Progresi (2022)

⁴⁵ Bashkia Tropojë - probleme dhe sfida

⁴⁶ Bashkia Shkodër - probleme dhe sfida

⁴⁷ Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI); <https://akshi.gov.al/>

1.1.2. Rritja e Transparencës së Financave Vendore

Bashkitë kanë inkurajuar pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen e tyre, duke organizuar takime online të Këshillit Bashkiak dhe takime të hapura për publikun. Transparenca buxhetore mbetet e kënaqshme me publikimin e dokumenteve kyçe buxhetore, gjë që mundëson debat të mjaftueshëm publik, megjithatë, kuadri institucional për pjesëmarrje efektive dhe gjithëpërfshirëse ka nevojë për fuqizim të mëtejshëm. Për sa i përket programit të transparencës janë evidentuar mangësi në lidhje me publikimin e informacionit të detyrueshëm në rubrikat e saj nga NJVV⁴⁸.

Rritja e transparencës së financave vendore vlerësohet nga tre grupe treguesish: (i) përgatitja nga bashkia e buxhetit vendor për qytetarët, (ii) buxheti vendor i publikuar në faqen e internetit të bashkisë dhe në faqen financatvendore.al; (iii) rritja e transparencës (numri i dëgjësive publike).

Konsolidimi i procedurave dhe sistemi i menaxhimit të financave vendore në të gjitha etapat, që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij, asistencë e drejtpërdrejtë ndaj NJVV-ve, përmes komenteve dhe konsultimit, përbëjnë disa nga drejtimet kryesore të përpjekjeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) gjatë vitit 2022 për forcimin e menaxhimit financiar në nivel vendor. Këto hapa parapërgatitore shërbejnë gjithashtu për zbatimin e sistemit AFMIS në nivel vendor në një periudhë afatmesme. MFE miratoi Udhëzimin nr. 7, datë 25.02.2022, “Për një ndryshim në udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i cili përcakton 20 programe të miratuara nga MFE për pushtetin vendor. Treguesi mbi aftësinë e bashkive për të përgatitur raportin e monitorimit për zbatimin e buxhetit ka përmirësim (55 bashki kanë përgatitur në krahasim me 53 për vitin e mëparshëm të raportimit). Mbi raportimin e të ardhurave të planifikuara përkundëjt atyre faktike nga NJVV, me status të njëjtë pozitiv paraqiten 39 bashki, me status të njëjtë negativ paraqiten 10 bashki (Poliçan, Belsh, Pustec, Has, Tropojë, Kavajë, Rogozhinë, Vorë, Konispol dhe Selenicë), me përkeqësim paraqiten 3 bashki (Këlcyrë, Mirditë dhe Sarandë)⁴⁹.


Gjithsej 47 bashki (77%) kanë përgatitur buxhetin në një format të kuptueshëm për qytetarët, 5 bashki (8%) nuk e kanë përgatitur, ndërsa 8 bashki (13%) nuk kanë ofruar të dhëna të vlefshme (bashkia Librazhd, Elbasan, Peqin, Divjakë, Skrapar, Dimal, Libohovë, Përmet (N=60)). Treguesi evidenton përmirësim krahasuar me vitin 2021 (43 bashki ose 70% e tyre.)

Publikimi i buxhetit të bashkisë në faqen zyrtare të bashkisë është kryer nga 58 bashki (N=61) – treguesi ka përmirësim në krahasim me vitin e kaluar të raportimit (51 bashki), ndërsa publikimi në faqen financatvendore.al është realizuar nga 45 bashki (N=60) duke mbetur në të njëjtin nivel me vitin e mëparshëm të raportimit.

⁴⁸ Raport i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Tetor 2022)

⁴⁹ Raporti i Përputhshmërisë së Monitorimit të Performancës në nivel Bashkie (Tetor 2022)


Grafiku 9: Publikimi i buxhetit vendor në faqen zyrtare të bashkisë.




Nga bashkitë e vendit, janë organizuar gjithsej 574 dëgjesa publike me qytetarët (N=60) në procesin e përgatitjes së buxhetit të ri vendor (ose 170 dëgjesa më shumë krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit), ose mesatarisht 9 dëgjesa në vitin 2022; Numri i dëgjesave në procesin e hartimit të buxhetit me grupet vulnerabël dhe PAK ka qenë 160 (N=59) ose mesatarisht 3 dëgjesa. Më shumë dëgjesa në vitin 2022 janë organizuar nga bashkitë me

këto grupe/shtresa në nevojë – 32 dëgjesa më shumë në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021. Bashkitë që raportojnë një numër më të lartë të dëgjesave publike të organizuara me grupet në nevojë, të rinjtë dhe PAK kanë qenë Bashkia Lushnjë dhe Sarandë (11 dëgjesa), Bashkia Fier (10), Bashkia Durrës dhe Mat (8), Bashkia Korçë dhe Pogradec (7).

Grafiku 10: Numri i dëgjesave publike mbi projekt-buxhetin nga NJQV, periudha 2017-2022



Grafiku 11: Numri i dëgjesave publike mbi projekt-buxhetin me grupet vulnerabël të përfaqësuar nga OSHC, personat me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë, gjatë vitit 2022



Kutia 1: Sfida për ofrimin e transparencës mbi financat vendore

Bashkia Përmet: Ndërgjegjësimi i komunitetit për të marrë informacion online duke përdorur faqet zyrtare web të Bashkisë; Kultura gjithëpërfshirëse qytetare për të qënë aktivë në procesin e hartimit të politikave nga Bashkia; Përfshirje sa më e gjerë, sidomos nga zonat e largëta rurale.

Bashkia Selenicë: Rritja e transparencës për buxhetin dhe informimi i qytetarëve.

Bashkia Tiranë: Rritja e pjesëmarrjes qytetare në takimet për konsultimin e projekt buxhetit të vitit të ardhshëm.

Bashkia Cërrik: Përfshirja e të gjithë grupeve të interesit.

Bashkia Devoll, Dropull, Kamëz: Rritja e numrit të konsultimeve me qytetarët në lidhje me përgatitjen e buxhetit dhe e pjesëmarrësve në dëgjesat publike, shkëmbim mendimesh për vendimarrje më efikase.

Bashkia Shkodër: Zhvillimi i takimeve me fokus grupe të veçanta.

Bashkia Tropojë: Rritja e numrit të dëgjesave për përgatitjen e PBA-së.

Bashkia Vorë: Rritja e numrit të dëgjesave publike me të gjithë aktorët dhe organizatat e shoqërisë civile.

Bashkia Korçë: Krijimi i një dëgjese publike për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara duke marrë parasysh dhe specifikat e grupit.

Bashkia Berat, Selenicë: Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve dhe pakicave, si dhe personave me aftësi të kufizuara në dëgjesat publike mbi buxhetin.

Mesatarisht, norma e rekomandimeve të ofruara nga aktorë të shoqërisë civile dhe grupet e të tjera të interesit, që janë marrë në konsideratë nga bashkia, në dokumentin e PBA/ose buxhetin vjetor ka qënë rreth 30% (N=55). Bashkitë që raportojnë një normë shumë të lartë të reflektimit janë bashkitë Tirana, Shkodër, Lushnjë dhe Kamëz (100%), Fier (90%), Elbasan (85%), Roskovec dhe Konispol (80%).

Në dëgjesat publike të organizuara nga bashkitë e vendit mbi realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara për vitin 2022 – gjithsej 636 dëgjesa publike (N=59), ose 2.5 herë më shumë dëgjesa krahasuar me vitin 2021, kanë marrë pjesë 11,806 qytetarë (N=41) ose rreth 5,500 qytetarë më shumë krahasuar me vitin 2021 (N=35).

Probleme dhe sfida

- Përgatitja e buxhetit në një formë të kuptueshme për qytetarët; Rritja e informimit nga bashkia për qytetarët në procesin e përgatitjes së projekt-buxhetit dhe në dëgjesat publike mbi ekzekutimin e buxhetit.
- Mungesa e analizës së treguesve ekonomikë dhe financiarë në përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe buxhetit vjetor.
- Një pjesë e bashkive nuk argumentojnë në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit, shkaqet dhe arsytet që ndikojnë negativisht në realizimin e buxhetit⁵⁰.
- Probleme në cilësinë e të dhënave që paraqiten dhe analizohen në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

⁵⁰ Raporti i Përputhshmërisë së Monitorimit të Performancës në nivel Bashkie (tetor 2022)

Rekomandime

- Përmirësimi i cilësisë së konsultimit publik në nivel vendor në procesin e hartimit të buxhetit dhe zbatimit të tij.
- Në përgatitjen e buxhetit afatmesëm dhe buxhetit vjetor, të merret parasysh pasqyrimi i parashkimeve të treguesve ekonomikë dhe financiarë të buxhetit duke u bazuar në prioritetet e NJVV-ve dhe në planin strategjik të zhvillimit në këto vite⁵¹.
- Bashkitë duhet të planifikojnë buxhetin duke mbajtur parasysh nivelin e dëshiruar të shërbimeve që i ofrohet qytetarëve, sasinë dhe cilësinë e produkteve të synuara, aftësinë paguese të bashkisë, kërkesat buxhetore për çdo program, projektet me ndikim në objektivin e programit, kapacitetet financiare për investime kapitale të NJVV-së⁵².
- Nevojitet një publikim në kohë i raporteve të ekzekutimit të buxhetit dhe i raportit të auditimit, në veçanti raportimi i detyrimeve të prapambetura nga NJVV⁵³.
- Raporti i monitorimit të buxhetit vjetor duhet të diskutohet në këshillin bashkiak dhe të publikohet në faqen zyrtare të bashkive me qëllim që të jetë i aksesueshëm nga të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit⁵⁴.

1.1.3. Administrata Publike

Progres është arritur në monitorimin e orientuar drejt rezultateve, duke përfshirë analizën e performancës në institucionet e administratës publike dhe në NJVV. Monitorimi rregullator dhe institucional dhe korniza raportuese për performancën e qeverisë vazhdojnë të jenë të fragmentuara. Mungesa e një politike pagash të bazuar në kritere të qarta për shtesat dhe rritjen e pagave dobëson drejtësinë dhe koherencën e sistemit⁵⁵.

Në vitin 2022, nën drejtimin e Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar një proces për analizën dhe sjelljen në standarde ligjore të strukturës organizative të bashkive, në bashkëpunim me DAP, Ministrinë e Brendshme/AMVV dhe Prefektin e Qarkut. Një progres të dukshëm ka patur situata e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, në fushën e rikthimit në punë të nëpunësve gjyqësorë në përgjithësi, pasi tashmë janë evidentuar të gjitha vendimet gjyqësore, janë regjistruar gjyqësuesit në listën e pritjes dhe po zbatohen detyrimet financiare / ose po bëhen përpjekje për emërimin e tyre në një pozicion në shërbimin civil ku ata i plotësojnë kërkesat specifike. Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil ka vlerësuar impaktin e vendeve të paplotësuara për periudhën 2019-2021 – mesatarisht 15.5% e pozicioneve të punës në shërbimin civil kanë qenë të paplotësuara. Numrin më të lartë të pozicioneve të paplotësuara (rreth 20%) e kanë patur bashkitë dhe prefekturat. Situata ndikon negativisht pasi administrata funksionon me kapacitet të munguar⁵⁶.

⁵¹ Raporti i Përputhshmërisë së Monitorimit të Performancës në nivel Bashkie (tetor 2022)

⁵² Raporti i Përputhshmërisë së Monitorimit të Performancës në nivel Bashkie (tetor 2022)

⁵³ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, Qeverisja (tetor 2022)

⁵⁴ Raporti i Përputhshmërisë së Monitorimit të Performancës në nivel Bashkie (tetor 2022)

⁵⁵ Agjencia për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Asistencës së Huaj, Agjencia për Dialog dhe Bashkë-qeverisje, Agjencia për Median dhe Informacion

⁵⁶ Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil në Kuvend (Maj 2022); <http://www.kmshc.al/wp-content/uploads/2022/05/Fjala-e-Komisioneres-ne-Kuvend-date-30.05.2022-final.pdf>


Në periudhën e raportimit është përgatitur udhëzuesi për organizimin e brendshëm dhe strukturën e NJVV, udhëzuesi për standardizimin e procedurave të rekrutimit dhe administrimin e burimeve njerëzore në NJVV⁵⁷, si dhe udhëzuesi për parandalimin dhe adresimin e dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në mjedisin e punës, si dhe në institucionet e administratës publike⁵⁸.

Sistemi HRMIS ka vijuar të plotësohet me të dhëna, ndonëse me një ritëm të ngadalshëm. HRMIS nuk mbulon ende të gjithë sektorin publik si dhe nuk përfshin të dhëna plotësisht të përditësuara për nëpunësit civilë. Qeveria ka arritur të vendosë masa për të krijuar një mekanizëm koordinues ndërmjet nivelit qendror dhe nivelit vendor për monitorimin dhe vlerësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore. Krahasuar me një vit më parë, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) rriti shtrirjen tematike dhe numrin e nëpunësve publikë të trajnuar. Megjithatë, mungesa e infrastrukturës pengon kapacitetin e saj për të ofruar kurse online. Aftësitë administrative të nëpunësve civilë të nivelit vendor duhet të përmirësohen⁵⁹.

Punësimi në administratën vendore dhe shërbimet publike në bashki

Në vitin 2022, numri gjithsej i punonjësve të 61 bashkive ka qenë 37,518 (N=61), ose rreth 3,100 punonjës vendorë më shumë, krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit. Norma mesatare e punonjësve të administratës vendore ndaj totalit të të punësuarve nga NJVV raportohet 33.6% ose 0.2 % më e lartë krahasuar me vitin 2021 (N=61). Rreth 0.46% e të punësuarve në bashkitë e vendit kanë qenë persona me aftësi të kufizuara, ndërsa niveli i punësimit të tyre në institucionet shtetërore ka qenë rreth 0.6% në vitin 2022⁶⁰.

Grafiku 12: Norma e punonjësve të administratës bashkiake dhe të shërbimeve ndaj numrit total të punonjësve të bashkisë, 2022



Mesatarisht, norma e punonjësve të shërbimeve bashkiake ka qenë 52% ose rreth 7 p.p. më e lartë krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit (N=61). Njëzet e dy (22) NjVV (36%) kanë patur një numër më të lartë të punonjësve të shërbimeve krahasuar me nivelin mesatar, midis të cilave bashkia Tiranë, Berat, Dimal, Fushë-Arrëz, Devoll, Gjirokastrë, Korçë, Krujë, Kuçovë, Konispol, Kavajë, Klos, Vlorë, Përmet dhe Shkodër.

⁵⁷ Departamenti i Administratës Publike/Raporti për Shërbimin Civil; <https://www.dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore>


⁵⁸ Udhëzuesi është hartuar me kontributin e Departamentit të Administratës Publike, Avokati i Popullit, Suedi Sverige dhe UNDP; <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/468-udhezues-per-parandalimin-dhe-adresimin-e-dhunës-ngacmimit-dhe-ngacmimit-seksual-ne-mjedisin-e-punes-ne-institucionet-e-administrates-shtetërore>

⁵⁹ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, Qeverisja (Tetor 2022)

⁶⁰ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: Raport Mbi Punësimin në Administratë të Personave me Aftësi të Kufizuara (2022)


Gjithsej, në administratën vendore kanë qenë **5,472 punonjës me status të nëpunësit civil** ose 43.2% të numrit të përgjithshëm të administratës vendore (N=60). Numri i nëpunësve civilë në NJVV në vitin 2022 është më i lartë krahasuar me vitin 2021 (4,076) dhe me vitin 2020 (4,625 nëpunës civilë). Rreth 40,6% është norma mesatare e nëpunësve civilë femra (N=58); Treguesi rezulton me rritje krahasuar me vitin 2021 (37.4%), (N=60).

Grafiku 13: Numri gjithsej i nëpunësve vendore me status të nëpunësit civil në bashki, 2022




Në vitin 2022, në pozicione drejtuese janë raportuar 2109 persona (N=60), nga të cilët rreth 29.3% ka qenë norma mesatare e punësuar nga femra (N=58). Punësimi i femrave në pozicione drejtuese është rritur në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 (norma mesatare 25.6%, N=60); Treguesi rezulton me rritje për periudhën 2020-2022.

Grafiku 14: Tendeca e punësimit të femrave në pozicione drejtuese në NJVV, 2020-2022 (norma mesatare, në %)



Grafiku 15: Masa e punësimit të femrave në pozicione drejtuese në NJVV, 2022 (në % të pozicioneve drejtuese)




Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të administratës vendore nëpërmjet trajnimeve

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) gjatë vitit 2022 ka trajnuar 5,397 individë dhe ka patur një ndjekje prej 20,780 pjesëmarrësish në trajnime, nga të cilët 4,737 (23%) janë nga NJVV. Gjithsej 1,195 individë përfunduan trajnimin e detyrueshëm për nëpunësin civil në periudhë prove “Prezantimi me Administratën Publike”, ndërsa 3,755 persona u trajnuan në fushën e Integrimit Evropian. Gjatë vitit 2022 u zhvillua vlerësimi i nevojave për trajnim për vitin 2023⁶¹.

Gjithsej 2,692 punonjës vendorë kanë ndjekur programet e trajnimit të afruar nga ASPA bazuar në raportimin e Drejtorive të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në NJVV, ose mesatarisht 46 persona (N=58), ndërsa 2,168 punonjës vendorë janë trajnuar nga ofruet të tjerë përveç ASPA (N=53). Mbi legjislacionin e nëpunësit civil janë trajnuar 751 nëpunës vendorë. Rezulton se më shumë punonjës vendorë janë trajnuar gjatë vitit 2022 nga ASPA krahasuar me vitin 2021, si dhe nga ofruet të tjerë të trajnimeve. Bashkia Tiranë ka patur numrin më të lartë të punonjësve të trajnuar nga ASPA (1142 persona), Bashkia Bulqizë (316) dhe Bashkia Pogradec (64).

Grafiku 16: Numri i punonjësve vendorë të trajnuar nga ASPA, 2018-2022




Në vitin 2022, bashkitë kanë shpenzuar mesatarisht rreth 0,0275% të buxhetit vendor për të mbështetur trajnime të stafit të bashkisë. Bashkia Shkodër ka shpenzuar më shumë krahasuar me bashkitë e tjera - 0,71% të buxhetit, ndërsa 31 bashki (51%) nuk kanë patur shpenzime në këtë kategori. Më pak fonde të shpenzuara nga NJVV në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 (mesatarisht 0.08% e buxhetit vendor).

Sistemi Informatik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (HRMIS) vazhdon të jetë i plotësuar dhe funksional, por nuk mbulon ende të gjithë sektorin publik dhe NJVV. Qeveria po vendos masa për një mekanizëm koordinues për monitorimin dhe vlerësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore ndërmjet nivelit qendror dhe vendor. Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil ka monitoruar zbatimin e ligjit për shërbimin civil dhe menaxhimin e burimeve njerëzore në nivel qendror dhe vendor gjatë vitit 2022⁶².

HRMIS ka qenë funksional në 33 bashki (55%, N=60) ose 7 p.p. më i ulët krahasuar me vitin 2021, pra më pak bashki kanë përdorur sistemin HRMIS në menaxhimin e burimeve të tyre njerëzore krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit (2021).

Harta 2: Sistemi HRMIS Funksional për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore




⁶¹ Burim: Shkolla Shqiptare e Administratës Publike; <https://aspa.gov.al/e-library/>

⁶² Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil në Kuvend (Maj 2022); <http://www.kmsch.al/wp-content/uploads/2022/05/>


Largimet nga administrata vendore

Largimet nga NJVV, në 2022, janë në nivelin e 1,802 personave (N=58) duke rezultuar në një nivel më të ulët në krahasim me vitin 2021 (1922 individë). Norma e largimeve nga NJVV, për shkak të daljes në pension dhe largimeve për shkaqe të tjera ka qenë 4.8% të numrit gjithsej të punonjësve (N=59). Largime për shkaqe të tjera - 1433 individë (79.5% të largimeve, N=58). Numri i individëve për shkak të daljes në pension ka qenë 369 (N=59), ose 20.5% të largimeve në vitin 2022. Norma më e lartë e largimeve ka qenë në bashkitë Pogradec, Mat, Gramsh (17%), Klos dhe Poliçan (15%), Gjirokastrë, Libohovë dhe Belsh (14%), Devoll, Lezhë, Pukë dhe Rrogozhinë (13%).


Grafiku 17: Largimet e personelit nga NJVV, 2022 në % (dalje për pension dhe largime për shkaqe të tjera)



Grafiku 18: Numri i të larguarve për shkaqe të tjera (përveç daljes në pension) nga NJVV, 2022



Grafiku 19: Numri i të larguarve nga NJVV, 2020 – 2022



Kutia 1: Sfida për menaxhimin e burimeve njerëzore

Bashkia Korçë: Rritja e numrit të trajnimeve për të rritur kapacitetet e punonjësve të bashkisë.

Bashkia Belsh dhe Konispol: Më shumë trajnime për punonjësit në fushat respektive. Rritja e numrit të femrave në pozicione të shërbimit civil.

Bashkia Korçë, Himarë, Rogozhinë: Plotësimi i vendeve vakante me punonjës të kualifikuar dhe sipas kërkesave/specifikave të pozicionit. Rritja e buxhetit për trajnime.

Bashkia Kamëz: Forcimi i kapaciteteve të administratës. Rritja e numrit të femrave në pozicione drejtuese. Rritja e buxhetit vendor për trajnime.

Bashkia Patos, Përmet: Trajnimi periodik i stafit dhe mbulimi i shërbimeve me specialistë të fushës. Mungesa e trajnimit të stafit përgjegjës për funksionimin e HRMIS.

Bashkia Shkodër: Krijimi i një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional dhe bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike. Përditësimi i sistemit HRMIS në kohë.

Bashkia Tropojë: Koordinimi dhe bashkëpunimi mes drejtuesve, kolegëve dhe vartësve drejt përmbushjes së qëllimit të përbashkët dhe në shërbim të komunitetit. Kualifikimi dhe specializimi i nëpunësve dhe stafit të ri sipas nevojave dhe fushës me qëllim rritjen e performancës në punë dhe përmirësimi i kushteve dhe mjeteve të punës.

Bashkia Selenicë: Përmirësimi i gjendjes së mjeteve që ofrojnë shërbime publike, bashkëpunimi me drejtori dhe institucione të tjera në mbulimin e plotë me shërbime në të gjitha Njësitë Administrative të bashkisë.

Bashkia Delvinë: Rritja e pjesëmarrjes në trajnime të punonjësve të bashkisë.

Bashkia Fushë-Arrëz: Të bëhet një shtrirje sa më e gjerë dhe gjithëpërfshirëse në shtim të programeve të trajnimit.

Bashkia Prrenjas: Përfshirja e të gjithë stafit të bashkisë në trajnimet e ASPA-s por për shkak se nje pjesë nuk ka statusin e nëpunësit civil nuk mund të marrin pjesë në trajnime.

Bashkia Kavajë: Sistemi HRMIS nuk është funksional.

Bashkia Roskovec: Regjistrimi i bashkisë në sistemin HRMIS.

Bashkia Mallakastër, Mirditë: Parashikimi dhe rritja e buxhetit vendor për zhvillimin e trajnimeve.

Probleme dhe sfida

- Sigurimi i qëndrueshmërisë së nëpunësve në administratën vendore dhe në mënyrë të veçantë i nëpunësve me përvojë.
- Mungesa e qëndrueshmërisë së stafeve të Njësive të Integrimit Evropian që kanë një rol të rëndësishëm në kordinimin e procesit të integrimit evropian dhe përthithjen e fondeve të Bashkimit Evropian.
- Sistemi i informacionit për menaxhimin e burimeve njerëzore (HRMIS) ka qenë funksional në 55% të NJVV.
- Mungesa e infrastrukturës të ASPA pengon kapacitetin e saj për të ofruar kurse online. Një cikël trajnimi për menaxhimin e cilësisë ende nuk është krijuar⁶³.
- Kontratat e përkohshme për pozicionet e shërbimit civil, megjithëse në ulje, vazhdojnë të jenë frekvente në NjVV⁶⁴.

Rekomandime

Disa nga rekomandimet e raportit të mëparshëm mbeten të vlefshme:

- Zbatimi i Ligjit të Nëpunësit Civil mbetet për t'u përmirësuar në nivelin vendor në të gjitha nivelet.
- Për plotësimin e vendeve vakante nevojitet një nivel më i lartë bashkëpunimi midis institucioneve që janë pjesë e shërbimit civil. Nevoja për një zgjerim të grupit të rekrutimit, me sa më shumë pozicione pune të nivelit ekzekutiv me tipare të njëjta, me qëllim që të rritet eficienta e konkurrimit si dhe të respektohet parimi i meritokracisë⁶⁵.
- Të përfundojë procesi i harmonizimit ligjor me Kodin e Procedurave Administrative⁶⁶.
- HRMIS duhet të shtrihet në nivel vendor; Automatizimi i sistemit të pagave përmes sistemit të informacionit të menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të shtrihet në të gjithë sektorin publik⁶⁷.
- Kërkohet vemendje dhe masa për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave (Nr. 708/2015 "Mbi tipin, periodicitetin dhe format e raportimit nga strukturat shtetërore dhe NJVV" për përmirësimin e mekanizmave të monitorimit dhe penalitetet që rezultojnë nga mungesa e zbatimit të kuotave të punësimit të personave me aftësi të kufizuar.
- Monitorimi i treguesve të reformës në administratën publike të shtrihet edhe në NjQV, dhe të bëhet publikimi i të dhënave në platformën "administrata.al".
- Aftësitë administrative dhe profesionale të nëpunësve civilë të nivelit vendor duhet të përmirësohen më tej⁶⁸.

⁶³ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

⁶⁴ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

⁶⁵ Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil (2022); Fjala e Komisioneres për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil në Kuvend (maj 2022); <http://www.kmshc.al/wp-content/uploads/2022/05/Fjala-e-Komisioneres-ne-Kuvend-date-30.05.2022-final.pdf>

⁶⁶ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

⁶⁷ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

⁶⁸ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

Objektivi specifik: përmirësimi i llogaridhënies së administratës vendore


Performanca e NJQV lidhur me këtë objektivi specifik vlerësohet mbi bazën e tre treguesve të performancës: (i) Norma e përgjigjeve të dhëna nga shërbimet bashkiakë për kërkesat e dorëzuara nga qytetarët ndaj numrit të përgjithshëm të kërkesave të dorëzuara pranë bashkisë, (ii) numri i akteve të vendimmarrësve vendor të publikuar në regjistrin elektronik të bashkisë, mbi numrin total të akteve të miratuar nga bashkia gjatë vitit të raportimit, (iii) numri i raporteve mbi konstatimet/ rekomandimet nga Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit, të cilat bashkia i ka refuzuar kundrejt numrit të përgjithshëm të raporteve të dorëzuara në bashki nga KMDDHP.

Në Këshillin Konsultativ qeverisja qendore - qeverisja vendore u konsultuan dy projektligje, gjatë vitit 2022, - projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”⁶⁹, qëllimi i të cilit është të përmirësojë dhe forcojë rregullat dhe procedurat e legjislacionit aktual për të drejtën e informimit, duke pasur në fokus interesin e qytetarëve për të ushtruar të drejtën për informim lidhur me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, si dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike dhe projektligji “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (Nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar). Ndryshimet ligjore synojnë të krijojnë një tërësi rregullash të njëtrajtshme në gjithë Bashkimin Evropian dhe në Shqipëri, të përshtatura për epokën digjitale, me qëllim përmirësimin e sigurisë juridike dhe përforcimin e besimit të qytetarëve dhe ndërmarrjeve tek tregu unik digjital⁷⁰.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka prodhuar në vitin 2022, “Indeksin e transparencës së njësisive të vetëqeverisjes vendore 2021”, sipas një metodologjie të caktuar. Nga monitorimi, konstatohet një rritje e lehtë e transparencës proaktive nga NJVV, përsa i përket plotësimit të Programit të Transparencës në të gjithë elementët e tij, si dhe përsa i përket Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve.

Në 2022, **norma mesatare e përgjigjeve të bashkisë ndaj kërkesave të qytetarëve të dorëzuara pranë bashkisë ka qenë 83%** (N=57), dukë rezultuar rreth 0.7 % më e lartë në krahasim me vitin e mëparshëm të raportimit. Njëzet e një (21) bashki kanë patur një normë 100% të kthim-përgjigjeve.


Grafiku 20: Norma e kthim-përgjigjeve ndaj kërkesave të qytetarëve nga NJVV, 2022 (në %)



⁶⁹ Shqipëria ka nënshkruar në vitin 2022 protokollet e Konventave CETS Nr.223 (108+) dhe CETS Nr. 205 të Këshillit të Evropës (KiE) - dy dokumenta të rëndësishme për forcimin e shtetit ligjor, demokracisë dhe respektimit të të drejtave themelore të njeriut, të cilat i përgjigjen sfidave të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, por sidomos atij teknologjik, duke zbatuar standardet më të larta në garantimin e të drejtave të njeriut. Ratifikimi i konventës 205/2009 “Mbi aksesin në dokumente zyrtare” është transpozuar në kuadrin rregullator të së drejtës për informim me Ligjin Nr. 33, datë 31.03.2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.


⁷⁰ Agjencia për Vetëqeverisjen Vendore / Sekretariati i Këshillit Konsultativ

Grafiku 21: Tendeca e normës mesatare të përgjigjeve të administratës vendore ndaj kërkesave/ankesave të qytetarëve, 2019-2022




Norma mesatare e akteve të vendimmarrjes të NJVV të publikuara ka qenë 70.02% (N=47) ose 11.12 p.p. më e lartë krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit. Vlera e treguesit mbi transparencën e akteve të publikuara duhet të jetë më e lartë por 20 bashki (33% e tyre) nuk kanë ofruar të dhëna të vlefshme për treguesin. Ndonëse jo të gjitha bashkitë kanë raportuar përsa më lart, vërehet një përmirësim i transparencës pasi të 61 bashkitë tani po publikojnë online vendimet e Këshillit Bashkiak⁷¹.

Grafiku 22: Norma e publikimit të akteve të vendimmarrësve vendorë, 2022 (në %)



Grafiku 23: Tendeca e normës së publikimit të akteve të organeve vendimmarrëse vendore, 2017-2022



⁷¹ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë i KE (tetor 2022)

Në vitin 2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dhënë Rekomandimin nr.1002, datë 07.07.2022 “Për garantimin në mënyrë efektive të Ndihmës Ekonomike (NE), nga viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe Rekomandimin nr.1080, datë 21.07.2022 “Rimbursimi i Energjisë Elektrike për Gratë me aftësi të kufizuar jo kryefamiljare”.

54 NJVV (88%) kanë patur një normë zero (0) refuzimi të rekomandimeve, ndërsa Bashkia Fier ka raportuar 57%, Bashkia Kamëz (4.6%), Bashkia Tiranë (2%), dhe Bashkia Kukës e Divjakë (1%), (N=59). Norma mesatare e refuzimit ka qenë 3.45% në vitin 2022 ose 3 p.p. më e ulët krahasuar me vitin 2021.

Probleme dhe sfida

- Njohja në tërësi e legjislacionit lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi është jo në nivelin e duhur⁷².
- Aspekte të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet agjencive shtetërore dhe institucioneve vendore për adresimin e çështjeve të rekomanduara nga KMD.
- Vonesa në adresimin në kohë brenda afateve ligjore të rekomandimeve të KMD nga strukturat përkatëse të NJVV.

Rekomandime

- Kërkohet vëmendje e shtuar për rritjen profesionale, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale, i cili me hyrjen në fuqi të kuadrit të ri rregullator të fushës do të ketë rol specifik brenda strukturës së bashkive.
- Rritja e cilësisë në procesin e trajtimit të kërkesave nga qytetarët për informacion.
- Vëmendje duhet t'i kushtohet përditësimit periodik të programit të transparencës dhe Regjistrimit të kërkesave, duke qenë se përbëjnë burimet kryesore për marrjen e dokumentacionit publik. Në këtë kontekst, informacionet rreth përmbajtjes së shpenzimeve buxhetore, procedurave të prokurimit publik apo auditimeve ndikojnë drejtpërdrejtë në transparencën proaktive, si dhe rrisin besueshmërinë dhe llogaridhënien e tyre për publikun⁷³.
- Respektimi i afateve ligjore dhe përgjegjshmëri me të lartë nga zyrtarët publikë në lidhje me shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve.


⁷² Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi; <https://www.kmd.al/rekomandime-te-komisionerit-2022/>

⁷³ Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale/Buletini nr 13 (2022); https://www.idp.al/wp-content/uploads/2022/08/revista_informim_dhe_privatesi_nr_13_ok.pdf


1.1.4. Avokati i Popullit

Avokati i Popullit ka paraqitur pranë NjVV gjithsej 176 rekomandime ose mesatarisht 3 rekomandime gjatë vitit 2022 (N=53) – një numër i konsiderueshëm më i ulët krahasuar me vitin 2021 (412 rekomandime). Norma e pranimit / dhe marrjes së masave respektive nga NJVV për adresimin e problematikës të ngritur nga Avokati i Popullit ka qenë 85% (N=53), ose 1.p.p më e lartë krahasuar me vitin 2021 (Bashkia Korçë ka pranuar dhe adresuar 27 rekomandime të AP kundrejt 15 rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2022, ndërsa Bashkia Prrenjas 5 rekomandime të pranuar nga 2 të dorëzuar gjatë vitit 2022). Të dy bashkitë e lartëcituar, kanë adresuar një pjesë të rekomandimeve të Avokatit të Popullit të dorëzuara tek të dy NJVV gjatë vitit të mëparshëm të raportimit (2021), krahas rekomandimeve të AP të vitit 2022.

Grafiku 24: Numri i raporteve dhe rekomandimeve nga Avokati i Popullit për NJQV, 2022



Grafiku 25: Numri i rekomandimeve të pranuar/adresuar kundrejt rekomandimeve të Avokatit i Popullit, 2022



Probleme dhe sfida

- Çështje të transparencës me Avokatin e Popullit për ndjekjen e rasteve të referuara në kohë nga NJVV.
- Plotësimi i rekomandimeve nga NJVV, brenda afateve ligjore, duke zgjeruar shërbimet dhe qartësimi i kompetencave.

Rekomandime

Disa nga rekomandimet mbeten relevante edhe për periudhën raportuese:

- E drejta e qytetarëve për administrim të mirë duhet të forcohet. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka koordinatori për të drejtën e informimit brenda autoriteteve publike.
- Rritja e transparencës ndaj publikut lidhur me zbatimin e rekomandimeve nëpërmjet publikimit të rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit në faqen zyrtare të bashkisë.


1.1.5. Shoqëria civile

“Nuk ka pasur progres në zbatimin e udhërrëfyesit për një mjedis të favorshëm për shoqërinë civile, i cili mbetet i varur nga mbështetja e donatorëve. Kërkohen përpjekje dhe burime shtesë për të avancuar zbatimin e tij. Mekanizmi monitorues i udhërrëfyesit nuk funksionon plotësisht⁷⁴.”

Progresi në arritjen e objektivit “forcimi i rolit të shoqërisë civile dhe rritja e bashkëpunimit në nivel vendor” është vlerësuar nëpërmjet 4 treguesve kryesorë:


Në 2022, **numri gjithsej i rekomandimeve të ofruara nga OSHC** për vendimmarrësit vendorë ka qenë 292 (n=54), ose mesatarisht 5, krahasuar me 135 rekomandime të raportuar për vitin e mëparshëm (2021), nga të cilat 240 rekomandime janë pranuar - norma e pranimit 82% (N=52). Krahasuar me vitin 2021, norma e pranimit nga organet vendimmarrëse të NJVV ka qenë pak më e ulët (- 5 p.p.). Tridhjetë e një (31) bashki kanë raportuar zero rekomandime nga përfaqësues të shoqërisë civile /ose nuk kanë ofruar të dhëna të vlefshme për treguesin, përfshirë Bashkinë Tiranë, Shkodër, Sarandë, Gjirokastrë dhe bashki të tjera.

Grafiku 27: Numri i rekomandimeve të ofruara nga shoqëria civile për NJVV, 2022



⁷⁴ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Tetor 2022)


Grafiku 28: Trendi i normës të pranimit të rekomandimeve të shoqërisë civile nga organet vendimmarrëse, 2019-2022




Gjithsej janë dhënë 109 grante nga bashkia për organizata të shoqërisë civile, në partneritet me agjenci donatore (N=56), nga të cilat 13 grante me vlerë totale deri në 1 milion lekë, 30 grante me vlerë 1 – 5 milion Lek dhe 66 grante me vlerë mbi 5 milion lekë. Më shumë grante të dhëna në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 (63 grante gjithsej në vitin 2021).

Numrin më të lartë të granteve gjatë vitit 2022 e kanë dhënë Bashkia Shkodër (26), Bashkia Tiranë (14), Bashkia Vlorë (7).


Grafiku 29: Grante nën 1 milion lekë



Grafiku 30: Grante 1-5 milion lekë



Grafiku 31: Grante > 5 milion lekë



Probleme dhe sfida

Disa nga sfidat dhe rekomandimet mbeten të vlefshme edhe për këtë periudhë raportimi:

- Programi i transparencës së bashkive nuk publikon rekomandimet e dhëna nga organizatat e shoqërisë civile për vendimmarrësit vendorë.
- Mungesa e OJF/OSHC-ve aktive në mjaft bashki.
- Burime financiare të vogla nga bashkitë për të financuar projekte në partneritet me organizata të shoqërisë civile.

Rekomandime

- Më shumë transparencë dhe qasje proaktive në ndarjen e informacionit nga institucionet publike, që do të kontribuonin në mekanizma bashkëpunimi efektivë me OJF-të në politikëbërje dhe vendimarrje si dhe në procesin e negociatave për anëtarësimin në BE .
- Qasja stimuluese dhe ngritja e fuqizimi i kapaciteteve për organizatat me karakter vendor, duhet forcuar dhe orientuar drejt bashkëpunimit .
- Më shumë iniciativa dhe përfshirje të organizatave të shoqërisë civile në proceset e vendimarrjes vendore.
- Rritja e angazhimit të bashkive për të rregjistruar dhe bërë publike në programin e transparencës rekomandimet e dhëna nga organizatat e shoqërisë civile dhe reflektimi i tyre në vendimarrjen vendore.

PËRFUNDIME MBI DEMOKRACINË

Këshilli Konsultativ ka funksionuar si forumi kryesor për dialogun institucional dhe koordinimin ndërmjet qeverisë qendrore dhe qeverive vendore duke mundësuar konsultimin e një numri më të lartë të projekteve të përgatitura nga ministristrinë e linjës. Ndonëse niveli i përfaqësimit të ministrive të linjës është rritur, ende mbetet problem përfaqësimi në nivelin e duhur, ndërkohë që vihet re një rritje e lehtë e nivelit të përfaqësimit të vetëqeverisjes vendore.

Në fushën e **shërbimeve dhe transformimit dixhital**, më shumë qytetarë kanë aplikuar për shërbime. Sfidë mbetet funksionimi i sistemit në të gjithë sektorët e bashkisë dhe azhornimi i shërbimeve administrative në përputhje me ndryshimet ligjore dhe funksionet e vetëqeverisjes vendore. Prioritete për ofrimin e shërbimeve digjitale janë rritja e sigurisë kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave personale, sigurimi i aksesit të platformës e-Albania nga personat me aftësi të kufizuar, krahas miratimit të standarteve të shërbimeve publike.

Administrata publike

Progres është arritur në monitorimin e orientuar drejt rezultateve, duke përfshirë analizën e performancës në NJVV. Sistemi HRMIS ka vijuar të plotësohet me të dhëna, ndonëse me një ritëm të ngadalshëm dhe jo funksional në një pjesë të bashkive. Është rritur numri i nëpunësve civilë në NJVV në vitin 2022 , por mbetet ende shqetësim numri i lartë i pozicioneve të paplotësuar. Norma e pjesëmarrjes së femrave në shërbimin civil në nivel vendor si dhe norma mesatare e nëpunësve civilë femra dhe në pozicione drejtuese ka pësuar përmirësime. Rrjeti i njëjtit të integritit evropian të BE-s ka forcuar përfshirjen e NJQV-ve në procesin e anëtarësimin në BE, por ndryshimi i stafëve të trajnuar nga këto struktura ulin efektivitetin dhe cilësinë e punës në NJVV.

⁷⁵ Partnerët Shqipëri Për Ndryshim dhe Zhvillim, Matrica e Monitorimit Mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (28.07.2022)

⁷⁶ Aleancat dhe Koalicionet e Shoqërisë Civile, Saimir Mustaj, LëvizAlbania, Shtator 2022; <https://levizalbania.al/sq/publikimet/blog-aleancat-dhe-koalicionet-e-shoqerise-civile>

Bashkitë kanë inkurajuar **pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen e tyre**, duke organizuar takime online të Këshillit Bashkiak dhe takime të hapura për publikun. **Transparenca buxhetore mbetet e kënaqshme me publikimin e dokumenteve kyçe buxhetore**, gjë që mundëson debat të mjaftueshëm publik, megjithatë, kuadri institucional për pjesëmarrje efektive dhe gjithëpërfshirëse ka nevojë për fuqizim të mëtejshëm⁷⁷. **Përmirësim është evidentuar në përgatitjen e buxhetit në një format të kuptueshëm për qytetarët si dhe publikimin e buxhetit vendor në faqen zyrtare të bashkisë**. Nevojitet një publikim në kohë i raporteve të ekzekutimit të buxhetit dhe i raportit të auditimit, në veçanti raportimi i detyrimeve të prapambetura nga NJVV⁷⁸.

Përmirësim ka patur llogaridhënia e pushtetit vendor lidhur me normën e kthim-përgjigjeve të administratës vendore ndaj kërkesave të qytetarëve si dhe publikimit të akteve të vendimmarrjes vendore, duke siguruar një rritje e lehtë e transparencës proaktive nga NJVV. Sfida mbeten forcimi i bashkëpunimit ndërmjet agjencive shtetërore në nivel rajoni dhe institucioneve vendore për adresimin e çështjeve të rekomanduara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi si dhe rritja profesionale, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale dhe përditësimi periodik i programit të transparencës dhe Regjistrimit të Kërkesave.

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore kanë marrë më pak rekomandime nga Avokati i Popullit në vitin 2022, ndërsa norma e pranimit / dhe marrjes së masave respektive për adresimin e problematikës të ngritur ka pësuar rritje. Rekomandohet rritja e transparencës ndaj publikut lidhur me zbatimin e rekomandimeve nëpërmjet publikimit nga NJVV të rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit në faqen zyrtare të bashkisë.

Janë rritur përpjekjet e organizatave të shoqërisë civile për të ofruar rekomandime për vendimmarrësit vendorë, por norma e pranimit/reflektimit nga organet vendimmarrëse të NJVV ka rënë kundrejt 2021. Ka më shumë grante të dhëna në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021.

⁷⁷ Raport i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Tetor 2022)

⁷⁸ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, Qeverisja (Tetor 2022)

1.2 Shteti i së drejtës

1.2.1. Lufta kundër korrupsionit

“Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit. Kapaciteti institucional dhe operacional i rrjetit antikorrupsion në nivel lokal është rritur lehtë⁷⁹. ”

1. **Objektivi specifik: Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit**

- **Numri i rasteve të ankimuar nga biznesi dhe qytetarët për shkelje të procedurave administrative dhe korrupsion** (përfshirë prokurimin publik). Në vitin 2022 janë regjistruar gjithsej 154 ankesa ose mesatarisht 2.7 ankesa për bashki (N=57). Treguesi shënon rritje krahuasuar me vitin 2021 ku janë regjistruar 106 ankesa. *Bashkia Fier zë vendin kryesor me një total prej 88 raste ose 57% të totalit të ankesave të regjistruara, pasuar nga Bashkia Shkodër me 19 dhe Bashkia Durrës me 16 kërkesa⁸⁰.*
- **Numri i deklarimeve të konflikteve të interesit nga nëpunësit vendorë dhe Këshilli Bashkiak gjatë marrjes së vendimeve.** Në vitin 2022 janë raportuar në total 12 deklarime të konfliktit të interesit nga 8 Bashki me një mesatare prej 0,22 persona (N=54). Kështu 75% e bashkive (46 Bashki) raportojnë 0 deklarime të konfliktit të interesit nga nëpunësit vendorë ndërsa 7 Bashki nuk japin informacion⁸¹.
- **Ngritja e një rrjeti të koordinatorëve vendorë anti-korrupsion në bashki.** Caktimi i nëpunësit publik në kapacitetin e koordinatorit vendor anti-korrupsion në zbatim të Planit të Veprimit në luftën kundër korrupsionit mbetet ende në nivele të ulta 66 % e bashkive.

2. **Objektivi specifik: Forcimi i kapaciteteve të administratës së qeverisjes vendore për të luftuar korrupsionin**

- **Ngritja e regjistrimit elektronik të kërkesave dhe ankesave ka njohur progres në vitin 2022, duke arritur në nivelin 88% të bashkive.** (54 bashki janë pësuar rritje nga 48 Bashki në 2021). Ky zhvillim pozitiv ka ndikuar edhe në rritjen e transparencës së bashkive ndaj komunitetit si dhe organeve të tjera ligjzbatuese. *Bashkitë që nuk e kanë ngritur regjistrin elektronik në vitin 2022 janë: Vlorë, Vorë, Prrenjas, Rrogozhinë, Kavajë ndërsa dy Bashki, si Librazhd dhe Malësia e Madhe nuk kanë dhënë informacion⁸².*
- **Shkalla e zgjidhjes së kërkesave dhe ankesave të qytetarëve sipas afateve të përcaktuara në legjislacion në vitin 2022 është raportuar në nivel mesatar prej 83% (N=55).** *Bashkitë Skrapar, Delvinë, Këlcyrë, Malësi e Madhe, Polican nuk japin informacion për këtë tregues.*
Numri i Bashkive që kanë ngritur Regjistrin Elektronik të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve ka ardhur në rritje nga viti 2018 deri në 2022 është rritur me 47%.


⁷⁹ Progres Raporti i KE për Shqipërinë (2022)

⁸⁰ Bashkitë Malësi e Madhe, Polican, Skrapar dhe Vlorë nuk kanë raportuar për këtë tregues


⁸¹ Bashkitë Vlorë, Skrapar, Shijak, Polican, Malësi e Madhe, Librazhd, Dibër nuk kanë raportuar për këtë tregues

⁸² Bashkitë Librazhd dhe Malësi e Madhe nuk kanë raportuar për treguesin

Harta 3: Ngritja e regjistrimit elektronik të bashkisë 2022




Grafiku 32: Ngritja e regjistrimit elektronik 2017-2022




3. Objektiv specifik: miratimi i politikave anti-korrupsion në nivel vendor

- Në vitin 2022 miratimi i Planeve të Integritetit Vendor në kuadër të masave antikorrupsion ka pësuar rritje dhe janë në total 31 Bashki që kanë miratuar Planin nga 23 Bashki në vitin 2021⁸³.

Harta 4: Plani i Integritetit në nivel vendor 2022



Harta 5: Planifikimi në buxhet i fondit për politikën antikorrupsion 2022



⁸³ Bashkitë Poliçan dhe Malësi e Madhe nuk kanë raportuar për treguesin

Probleme dhe sfida

- Problematikë mbetet niveli i ulët i njohurive të punonjësve të administratës vendore mbi çështjet që duhet të trajtohen për luftën kundër korrupsionit.
- Trajnimet për stafet e bashkive në luftën kundër korrupsionit mbeten në situata të pamjaftueshme për një numër të madh të bashkive.
- Zbatimi me efikasitet dhe i koordinuar i politikave dhe praktikave për parandalimin e korrupsionit.
- Mungesa e trajnimeve të vazhdueshme të punonjësve për përdorimin dhe përditësimin e regjistrit elektronik si dhe fondet e limituara për mirëmbajtjen e sistemit.
- Ndërgjegjësimi i ulët i qytetarëve për të adresuar në mënyrë elektronike kërkesat dhe ankesat e tyre.

Rekomandime

- Miratimi i planeve të integritetit për Luftën ndaj Korrupsionit në të gjitha bashkitë e vendit, sikundër është edhe rekomandimi i Raportit të Progresit të BE për Shqipërinë në 2022.
- Hartimi i programeve të trajnimit specifike për rritjen e njohurive të stafit të administratës vendore mbi politikën, strategjitë dhe kuadrin ligjor të lidhur me luftën ndaj korrupsionit.
- Ngritja e regjistrit elektronik për bashkitë që nuk e kanë ende funksional dhe përditësimin periodik.
- Rritja e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet ndërkombëtare për ofrimin e trajnimeve dhe mbështetjes financiare për trajtimin e korrupsionit në nivel vendor.

KONKLUZIONE MBI LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Progres është shënuar në procesin e ngritjes së regjistrit elektronik të kërkesave dhe ankesave, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e transparencës së Bashkive ndaj komunitetit si dhe organeve të tjera ligjzbatuese. I njëjti trend pozitiv është arritur në shkallën e zgjidhjes së kërkesave dhe ankesave të qytetarëve sipas afateve të përcaktuara në legjislacion. Treguesit që mbeten ende në nivele jo të kënaqshme lidhen me numrin e konsiderueshëm të bashkive që nuk kanë ndjekur trajnime për çështje të luftës ndaj korrupsionit hartimin e zbatimit të planeve të integritetit. Përpjekje të mëtijshme duhen bërë për përmirësimin e situatës në fushat më të prekura ndaj korrupsionit. Sektorët më të cënueshëm ndaj korrupsionit kërkojnë vlerësime të synuara të rrezikut dhe ndërmarrjen e veprimeve të dedikuara.

1.2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave

“Në përgjithësi Shqipëria vazhdon të përmbushë detyrimet e instrumentave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe ka ratifikuar shumicën e konventave ndërkombëtare. Në mars 2022, Komiteti i Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj grave miratoi një listë fushash ku Shqipëria duhet të demonstrojë progresin, duke përfshirë ...ndër të tjera dhunën me bazë gjinore dhe grupet e disavantazuara dhe të marginalizuara⁸⁴”.

Objektivi specifik: *Ngritja e kapaciteteve të vetëqeverisjes vendore për të zbatuar standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut*

- Në vitin 2022 janë kryer në total 147 programe trajnimi nga autoritetet dhe OSHC, ose mesatarisht 3 trajnime për bashki (N=51) me një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2021 (108 trajnime). 38% e Bashkive nuk raportojnë se nuk kanë ndjekur asnjë program trajnimi gjatë vitit 2022.
- Në 2022 janë trajnuar 240 nëpunës vendorë mbi zbatimin e standarteve të të drejtave të njeriut ose mesatarisht 5 nëpunës për bashki (N=53). Numri i nëpunësve të trajnuar është rritur me 6% në krahasim me 2021.
- Në vitin 2022, janë trajtuar gjithsej 429 raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut në bashkëpunim me Organizatat e Shoqërisë Civile, ose mesatarisht 7.8 raste për bashki (N=55); Vihet re një rënie e theksuar e rasteve të trajtuara në nivel vendor me 46% krahasuar me vitin 2021 (raportuar 929 raste). Numrin më të madh të rasteve të trajtuara e ka Bashkia Pogradec (126), Bashkia Kamëz (105) dhe Bashkia Maliq (79).
- Raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut në 2022 janë referuar gjithsej 766 ose mesatarisht 14 raste për Bashki (N=54). Numri i rasteve të referuara është 2 herë më i vogël se numri i referuar në vitin 2021 (1485). Numrin më të madh të rasteve të referuara për shkelje të të drejtave të njeriut e ka Bashkia Lezhë (350 raste), Bashkia Kamëz (105 raste) dhe Bashkia Pogradec (94 raste).
- Në vitin 2022, numri i rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut të trajtuar nga grupet ndërinstitucionale të Bashkisë është në total 590 ose mesatarisht 11 raste për Bashki (N=54). Përqindja e trajtimit të rasteve të referuara është rritur ndjeshëm nga 62% në vitin 2021 në 77% në vitin 2022. Bashkia Lezhë ka numrin më të madh të rasteve (200), pasuar nga Bashkia Pogradec (110) dhe Bashkia Maliq (79).

⁸⁴ Progres Raporti i KE për Shqipërinë (2022)

Probleme dhe sfida

- Nuk ekziston një sistem ku të mund të publikohen tematikat e trajnimeve mbi standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të cilat mund të ndiqen nga stafet e bashkive.
- Mungesa e stafëve të dedikuara dhe të trajnuara në bashki për të trajtuar rastet e shkëljes së të drejtave të njeriut.
- Burimet financiare të bashkive vazhdojnë të jenë të pamjaftueshme për të trajtuar me efektivitet të gjitha rastet e shkëljes së të drejtave të njeriut.
- Funkionimi i grupeve ndër-institucionale për trajtimin e rasteve të referuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut mbetet jo efektiv në disa bashki.
- Veprimtaria e OJF-ve për trajtimin e rasteve të drejtave të njeriut është e kufizuar në kohë dhe e lidhur me kohëzgjatjen e projekteve të donatorëve që financojnë punën e tyre.

Rekomandime

- Përmirësimi i njohurive dhe rritja e vetëdijes për standardet e të drejtave të njeriut për zyrtarët vendorë përmes trajnimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca kombëtare e rajonale.
- Rritja e burimeve financiare për trajtimin e problematikave të fëmijëve dhe përmirësimi i instrumentave për të realizuar buxhetimin me qendër fëmijën në nivel qendror dhe vendor.
- Forcimin e kapaciteteve të punonjësve që mbulojnë fushën e mbrojtjes dhe shërbimeve të fëmijëve si dhe ofrimi i trajnimeve të specializuara në këtë fushë.

KONKLUZIONE MBI TË DREJTAT E NJERIUT

Mbrojtja e të drejtave të njeriut vazhdon të jetë prioritet i Bashkive dhe vëmëndje i është kushtuar rritjes së kapaciteteve të nëpunësve vendor mbi çështjet e të drejtave të njeriut. Numri i rasteve të shkëljes së të drejtave të njeriut të referuara dhe të trajtuara në Bashki ka ardhur gjithashtu në rritje. **Bashkëpunimi ndër-institucional dhe me OJF-të që veprojnë në këtë fushë ka qënë në ritme të kënaqshme. Vëmëndje më e madhe duhet ti kushtohet trajtimit dhe mbrojtjes së të drejtave të pakicave dhe grupeve të marginalizuara.** Burimet financiare për trajtimin e çështjeve të referuara në bashki mbeten ende të kufizuara. Duhet të forcohet më tej bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë për të mundësuar zgjerimin e veprimtarisë së tyre në nivel lokal.

KRITERI EKONOMIK



2 Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

Ekonomi tregu funksionale dhe aftësia për të trajtuar konkurrencën e BE-së dhe forcat e tregut


“Shqipëria ka bërë disa përparime dhe ka njëfarë niveli përgatitjeje për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së. Infrastruktura e energjisë dhe transportit, dixhitalizimi dhe arsimit u përmirësuan, por njohuritë sipërmarrëse dhe teknologjike mbeten të ulëta, me nevoja të paplotësuara për investime në kapitalin njerëzor dhe fizik, boshllëqe në aftësim dhe arsim.”⁸⁵”

Objektivi specifik: përmirësimi i mjedisit të biznesit

Progresi mbi objektivin specifik vlerësohet nga pesë (5) tregues performance:

- **Hartimi i planeve të zhvillimit vendor mbetet në nivelet e vitit 2021: 54 Bashki.** Plani i Zhvillimit Vendor është një mjet i rëndësishëm për orientimin e prioriteteve vendore drejt nevojave të komunitetit dhe lidhja me programin buxhetor afatmesëm.
- **Në vitin 2022 janë ndërmarrë 152 aktivitete stimuluese** për nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla në zbatim të planeve të zhvillimit vendor, mesatarisht 3 aktivitete për bashki (N=53). Treguesi shënon rritje me 2 herë më shumë akitivitete të organizuara në krahasim me vitin 2021 me vetëm 77 aktivitete, aktivitete të raportuara nga 2/3 e bashkive. Numrin më të madh të aktiviteteve e ka ofruar Bashkia Krujë (21), Bashkia Berat (15) dhe Bashkia Kamëz (12).

Grafiku 33: Aktivitete stimuluese në mbështetje të biznesit të vogël e të mesëm, 2022



Në 2022 janë raportuar **në total 240 shërbime në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme** ose mesatarisht 4.6 për bashki (N=52). Treguesi ka pësuar rritje me 7% në krahasim me vitin 2021 (186 shërbime). Numrin më të madh e raporton Bashkia Tiranë me 124 shërbime pasuar nga Bashkia Kukës dhe Korçë me 11 shërbime.

Probleme dhe sfida

- Mbetet sfida zbatimi i Planeve Vendore të Zhvillimit dhe sigurimi i fondeve për zbatimin e projekteve strategjike të Bashkive të cilat kërkojnë investime të konsiderueshme.
- Kapacitetet njerëzore dhe burimet financiare tepër të limituara për zbatimin e planeve vendore të zhvillimit.
- Mungesa e mekanizmave për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet qeverisjes vendore dhe biznesit.
- Problematikë mbetet plotësimi i kuadrit rregullator që ndikon në përmirësimin e klimës së biznesit.
- Mungesa e Instrumentave për promovimin e produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative.
- Shpopullimi i zonave kryesisht malore dhe volumi i ulët i të ardhurave të realizuara që nuk arrijnë të mbulojnë shpenzimet e bizneseve.

Rekomandime

- Nxitja dhe lehtësimi për praktikën e punës në subjekte shtetërore dhe private si dhe promovimi i mundësive për punësim në sektorin e turizmit.
- Përmirësimi i konkurrencës dhe cilësisë së produktit turistik dhe i zinxhirëve territorialë të bashkëpunimit për një ekonomi vendore të qëndrueshme.
- Rritja e mundësive të bashkive për të ofruar edhe më shumë shërbime për NVM-të. Bashkëpunimi me donatorë, OJF, institucione të tjera për të ofruar shërbime mbështetëse për NVM-të.
- Krijimi i një sistemi të ofrimit të ndihmës për bizneset e reja dhe për të rinjtë si dhe atyre digjitale si dhe krijimi i një strukture informacioni për shtrirjen e bizneseve të reja në territorin e bashkisë.
- Parashikimi në buxhet dhe dhënia e granteve për bizneset e vogla me qëllim ngritjen e kompanive të reja (Start Up) dhe zhvillimin e atyre ekzistuese.

KONKLUZIONE MBI EKZISTENCËN E NJË EKONOMIE TREGU FUNKSIONALE

Kutia: Aktivitete stimuluese në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Bashkia Kavajë në bashkëpunim me rrjetin Shqiptar për Zhvillimin Rural ka ngritur për herë të parë Qendrën e Artizanëve. Kjo qendër është ngritur me anë të marrëveshjes ndërmjet Rjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural, Shkollës së Mesme së Përgjithshme "Aleksandër Moisiu" dhe Grupit të Grave Artizane në Bashkinë Kavajë. Qëllimi i marrëveshjes është fuqizimi ekonomik i grave dhe të zinxhirit të vlerës së artizanit.

Bashkia Mallakastër ka organizuar Festën e Ullirit me fokus tregëtimin e vajit të ullirit nëpërmjet ndërmarrjeve më të mëdha në bashkëpunim me fabrikat e vajit të cilat bëjnë përpunimin e këtij produkti. Gjithashtu u bë prezantimi i shumë produkteve të tjera blektorale dhe atyre artizanale. Heqja e tarifave për fasoneritë, është një nisëm tjetër e Bashkisë Mallakastër për të tërhequr sa më shumë biznese të këtij lloji në ndihmë të komunitetit dhe rritjes ekonomike familjare.

Bashkia Mat: Ka ndërmarrë iniciativë për studentët e arsimuar në dy vitet e fundit duke hequr detyrimet e taksave vendore për çdo student që ka një aktivitet biznesi.

Bashkia Përmet: Ka ofruar disa shërbime për NVM-të si: Këndi i Biznesit; Informimi për akses në financim; Trajnime dhe promovimi i produkteve të tyre; Lehtësira fiskale për disa kategori.

Megjithë shtimin e numrit të iniciativave stimulese dhe shërbimeve të ndërmarra nga bashkitë për të mbështetur aktivitetin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme sërisht financimi është në nivele të ulta. **Planet e Zhvillimit Vendor nuk janë miratuar ende në disa Bashki duke krijuar premisa për një** zhvillim jo të qëndrueshëm të rajoneve, mos-shfrytëzim të potencialeve ekonomike dhe të integruar me prioritetet afatgjata. Kapacitetet njerëzore dhe financiare të Bashkive për të mbështetur me aktivitete dhe financime direkte krijimin e biznesve të reja mbeten shumë të ulta dhe e përqëndruar tek bashkitë e mëdha.

**AFTËSIA PËR
TË MARRË
PËRSIPËR
DETYRIMET E
ANËTARËSIMIT**



3.1 Kapitulli 11: Bujqësia dhe Zhvillimi dhe Rural

Politika e përbashkët bujqësore (PPB) mbështet fermerët dhe zhvillimin rural. Kjo kërkon sisteme të forta menaxhimi dhe kontrolli. Ka gjithashtu edhe rregulla të përbashkëta të BE-së për politikën e cilësisë dhe bujqësinë organike.

“Progres është arritur në lidhje me krijimin e një regjistri të fermave dhe zhvillimin e kapaciteteve administrative për përgatitjen e instrumentit për asistencën para anëtarësimit për programin e zhvillimit rural (IPARD III). Të forcohen kapacitetet administrative të nevojshme për të zbatuar masat e vlefshme nën programin IPARD III (2021-2027) ⁸⁶”.

Në Këshillin Konsultativ pushteti qendror – vetëqeverisja vendore janë konsultuar disa projektakte gjatë vitit 2022 të inicuar/dhe të hartuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR): Për forcimin e partneritetit lokal në zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit rural, u miratua Ligji Nr. 36, datë 14.04.2022 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Grupeve Vendore të Veprimit”, qëllimi i të cilit është përcaktimi i parakushteve për krijimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit (GVV); Projekt-akte të tjera kanë qenë Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 308, datë 11.5.2022 “Për caktimin e MBZHR, si organ qendror blerës, për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Mbrojtjen e gështenjës nga parazitit grerëza galeformuese”; Projektligj mbi bletarinë, i cili përcakton detyrimin e miratimit të një programi 3 vjeçar të zhvillimit të bletarisë, që do të jetë një hap i rëndësishëm në zhvillimin e sektorit⁸⁷.

Në vitin 2022 është rritur me 14% financimi nga buxheti i shtetit për përballimin e ndryshimeve klimatike, përsa i takon infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit dhe mbrojtjes së përmytjeve⁸⁸.

Në nivel vendor, synimet e politikës kombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural dhe në kuadër të integritit evropian, vlerësojnë progresin në arritjen e rezultateve të lidhura me tre objektiva specifike: (i) forcimi i kapaciteteve të vetëqeverisjes vendore për sistemin e bujqësisë, zhvillimit rural dhe këshillimor, (ii) përmirësimi i produktivitetit dhe konkurrencës në sektorin e bujqësisë, (iii) zbatimi i qasjes LEADER.

Rritja e kapaciteteve të administratës vendore në sistemin e bujqësisë, zhvillimit rural dhe këshillimor:


Nuk është bërë progres lidhur me ngritjen dhe funksionimin e **Zyrës të Informacionit dhe të Këshillimit Bujqësor** (ZIKB) – ZIKB ka qenë funksionale në 35 bashki, gjatë vitit 2022, në krahasim me 41 ZIKB të raportuara për vitin e mëparshëm të raportimit (N=59). Bashkitë të cilat nuk i kanë patur funksionale ZIKB në vitin 2022 janë Bashkia Belsh, Cërrik, Kolonjë, Vorë, ndërsa Bashkia Malësi e Madhe dhe Poliçan nuk kanë ofruar të dhëna të vlefshme për treguesin.

⁸⁶ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)


⁸⁷ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; <https://bujqesia.gov.al/ligji-i-ri-per-bletarine-ministrja-krifca-mbeshtetje-fermereve-per-certifikim-te-produktit-mbrojtje-popullatave-autoktone-te-bletes/>

⁸⁸ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; <https://bujqesia.gov.al/ministrja-krifca-ne-konferencen-financimi-i-gjelber-14-rritje-te-buxhetit-per-perballimin-e-ndryshimeve-klimatike/>

Harta 6: ZIKB funksionale



Grafik 34: ZIKB në NJVV, 2022



Numri i fermerëve dhe personave të interesuar të cilët kanë përfituar nga trajnimi dhe këshillimi nëpërmjet ZIKB, ka qenë mjaft më i madh, gjithsej 79,548 gjatë vitit 2022 (N=50), krahasuar me 29,882 persona në vitin 2021. Numrin më të madh të personave të këshilluar e ka patur Bashkia Lushnjë (50,000), pasuar nga Bashkia Elbasan (6,200). Numri mesatar i përfituesve nga këshillimi nëpërmjet ZIKB është 720 fermerë pa përfshirë bashkinë Lushnjë (N=41), ndërsa në nivel kombëtar duke përfshirë Bashkinë Lushnjë (edhe njësitë që kanë raportuar zero këshillim) ka qenë 1590 persona.

Kutia 2 : Sfida për këshillimin në bujqësi

Bashkia Bulqizë: Asistencë teknike për kultivimin e kulturave bujqësore dhe blegtorale, ndihmë financiare me mjete për bujqësinë.

Bashkia Delvinë, Mallakastër, Mat, Patos: Hapja e Zyrës së Këshillimit dhe Informimit për Bujqësinë (ZIKB) pranë bashkisë për të informuar fermerët e zonës.


Bashkia Dibër, Shkodër: Plotësimi i stafit të Zyrës (ZIKB) me specialistë dhe ngritja profesionale.

Bashkia Prrerjas: Ka mungesë të hapësirave për shkak të godinës së vogël të bashkisë.

Bashkia Tropojë: Ngritja e ZIKB do të jetë një risi për bashkinë.


Bashkia Belsh, Bulqizë, Himarë, Mallakastër, Patos, Rogozhinë, Roskovec, Shkodër: Duhet të shtohet fondi për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Grafik 35: Numri i personave të kështilluar nga ZIKB, 2020 - 2022



Përmirësim i lehtë konstatohet në fondin e përdorur nga bashkia për bujqësinë dhe zhvillimin rural në 2022 – mesatarisht 4.21% të buxhetit vendor (N=54) krahasuar me 4.16% për vitin 2021, por mbetet më i ulët në krahasim me nivelin 5.3% të raportuar për vitin 2020. Bashkia Fushë-Arrëz ka patur alokimin më të lartë për bujqësinë (45%) të buxhetit vendor, ndjekur nga Bashkia Selenicë (25%).

Grafiku 36: Fondi vendor i NJVV për bujqësinë dhe zhvillimin rural, 2022




Objekti specifik: përmirësimi i produktivitetit dhe konkurrencës në sektorin e bujqësisë, përmirësimi i infrastrukturës rurale, zhvillimi i balancuar territorial dhe ekonomik i zonave rurale.

Treguesit e performancës në lidhje me këtë objektiv specifik përfshijnë: (i) vlerësimin e menaxhimit dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes, (ii) vlerësimin e menaxhimit dhe mirëmbajtjen e sistemit të kullimit (iii) grante të dhëna për fermerët.


Përmirësim është bërë për administrimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujitjes nga NJVV gjatë vitit 2022 – **norma mesatare e mirëmbajtjes është 63.9% (N=59), duke patur një rritje me 11.1 p.p.** në krahasim me vitin e mëparshëm të raportimit.

Grafiku 37: Shkalla mesatare e mirëmbajtjes së rrjetit të ujitjes dhe kullimit nga NJVV, 2018-2022




Rreth 26% e bashkive (16 NJVV) kanë një nivel të barabartë/ose më të lartë së 80% të mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes. Gjithashtu, përmirësim është bërë lidhur me **mirëmbajtjen e rrjetit të kullimit** – norma mesatare është 79.5% në vitin 2022 ose me një rritje 15.1 p.p. në krahasim me vitin 2021 (N=55).

Grafiku 38: Norma e mirëmbajtjes së rrjetit ujitës, 2022




Grafiku 39: Norma e mirëmbajtjes së rrjetit të kullimit, 2022




Treguesi mbi marrjen në dorëzim nga NJVV të rrjetit ujitës dhe kullues paraqitet me rritje – 1 p.p (N=56) në krahasim me vitin 2021. Gjithashtu, me rritje gjatë vitit 2022 paraqitet edhe norma mesatare e sipërfaqes së tokës bujqësore që vaditet - në nivelin 42,5% (N=56) ose 4,2 p.p krahasuar me vitin 2021 por i barabartë me nivelin e raportuar për vitin 2020.

Grafiku 40: Sipërfaqja e tokës bujqësore që ujitet në raport me totalin e sipërfaqes, 2022 (në %)



Grafiku 41: Ndryshimi i normës mesatare të tokës bujqësore që ujitet, 2020-2022 (në % të sipërfaqes)




Objektivi specifik: zbatimi i metodës LEADER

Ligji Nr. 36, datë 14.04.2022 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Grupeve Vendore të Veprimit” përcakton parakushtet për krijimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit (GVV). Këto grupe do të mundësojnë, përmes partneritetit lokal dhe parimit nga poshtëlart, përfshirjen e komuniteteve lokale në identifikimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit rural, të drejtuara nga vetë komuniteti, në varësi të nevojave të tyre, marrjen e vendimeve për alokimin e burimeve financiare dhe menaxhimin e tyre bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, sigurimin e një mjedisi për investimet në zonat rurale nga vetë komuniteti, si dhe ngritjen e kapaciteteve vendore⁸⁹. Aktorët në një GVV, brenda kufijve të zonës Leader (zonë e pandërprerë gjeografikisht, e cila mbulon një territor rural më popullsi jo më pak se 10,000 banorë dhe jo më shumë se 150,000 banorë). Ato mund të përfshijnë NJVV⁹⁰, qarkun, përfaqësues të sektorit jo publik (fermerë, jo fermerë, OJF/OSHC, mediat) dhe aktorë të tjerë⁹¹.


Në vitin 2022, konstatohet i njëjti nivel për GVV (LAG), gjithsej 25 (N=59). Katër bashki nuk kanë raportuar si, Bashkia Tiranë, Malësi e Madhe, Poliçan dhe Konispol.

Grafiku 42: Ngritja e Grupit Vendor të Veprimit (GVV), 2019-22



Disa nga sfidat dhe rekomandimet janë të vlefshme për periudhën e raportimit:

Harta 7: Ngritja e GVV, 2022



⁸⁹ Ligji Nr. 36, datë 14.04.2022 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Grupeve Vendore të Veprimit”, neni 1

⁹⁰ NJVV duhet të kenë minimum 20% të së drejtës së votës, por së bashku me autoritete të tjera publike përfaqësojnë jo më shumë se 49% të të drejtave të votës; GVV fillon aktivitetin pasi paiset me autorizim nga Ministri për politikën e zhvillimit bujqësor dhe rural dhe pas regjistrimit në regjistrin e organizatave joqeveritare. GVV-të e regjistruara në regjistër raportojnë për veprimtarinë e tyre pranë strukturës përgjegjëse në ministri, në baza vjetore.

⁹¹ Ligji Nr. 36, datë 14.04.2022 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Grupeve Vendore të Veprimit”, neni 17

Probleme dhe sfida

- Mungesa e mjeteve dhe financimi i pamjaftueshëm nga NJVV për të vënë në funksionim të plotë skemat ujitëse dhe për të rritur nivelin e mirëmbajtjes të rrjetit ujitës dhe kullues.
- Për disa NJVV, sfidë mbetet rehabilitimi i kanaleve të treta.
- Niveli i ulët i pagesës për tarifën e shërbimit të ujitjes, menaxhim financiar i dobët apo jo transparent, pasiviteti i Organizatave të Përdoruesve të Ujit (OPU-ve).
- Mungesë e ZIKB në disa NJVV.
- Mungesa e çertifikimit të produkteve bujqësore, përfshirë edhe vajin e ullirit, është shkak për mosshfrytëzimin e potencialit për eksportet e prodhimit bujqësor. Sfidë mbetet krijimi i pashaportës së produkteve bujqësore për të rritur eksportet dhe për të ulur stokun në bujqësi.

Rekomandime

- Realizimi në praktikë i një sërë nismash që kanë të bëjnë me afrimin e bujqësisë me qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare duke konsideruar zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme përballë sfidave të ndryshimeve klimatike.
- Rritja e financimit nga qeveria për bujqësinë dhe zhvillimin rural krahas financimit nga programi IPARD⁹², si dhe rritja e financimit nga buxheti vendor për bujqësinë.
- Nevojiten përpjekje për të shmangur mos-angazhimet në 2023 të programit IPARD, për shkak të vonësave në zbatimin e projektit⁹³.
- Hartimi i skemave ujitëse bazuar në buxhete specifike dhe në performancë shërbimi.
- Ngritja dhe fuqizimi i ZIKB në bashkitë e tjera.
- Mirëmbajtja dhe rikonstruksioni i rezervuareve dhe veprave, si dhe krijimi i një fondi specifik në buxhetin e bashkisë për këtë qëllim.

PËRFUNDIME MBI BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

Kuadri ligjor është fuqizuar me hartimin e disa akteve ligjore. Është rritur financimi nga buxheti i shtetit për përballimin e ndryshimeve klimatike, përsa i takon infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytjet⁹⁴. **Fondi i alokuar për bujqësinë nga NJVV ka pësuar një rritje të lehtë, si dhe është bërë përmirësim për administrimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujitjes dhe rrjetit të kullimit**, duke sjellë rritje të sipërfaqes së tokës bujqësore të ujitur krahasuar me vitin 2021. Numri i fermerëve të këshilluar nga ZIKB është rritur ndjeshëm në vitin 2022, por ende Zyrat e Informacionit dhe të Këshillimit Bujqësor nuk janë ngritur në gjithë bashkitë.

Nevojitet realizimi në praktikë i një sërë nismash që kanë të bëjnë me zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme përballë sfidave të ndryshimeve klimatike, rritja e financimit nga qeveria dhe buxheti vendor për bujqësinë dhe zhvillimin rural krahas financimit nga programi IPARD⁹⁵, përmirësimi i mëtejshëm i administrimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nga NJVV, hartimi i skemave ujitëse bazuar në buxhete specifike dhe në performancë shërbimi, ngritja e ZIKB pranë bashkive të tjera dhe ngritja/funksionimi i grupeve vendore të veprimit sipas legjislacionit të miratuar në 2022.

⁹² Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

⁹³ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

⁹⁴ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; <https://bujqesia.gov.al/ministrja-krifca-ne-konferencen-financimi-i-gjelber-14-rritje-te-buxhetit-per-perballimin-e-ndryshimeve-klimatike/>

⁹⁵ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

3.2 Kapitulli 12: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare

Përparim është bërë në fushën e sigurisë ushqimore, politikave veterinarë dhe fitosanitare por më tepër efikasitet kërkohet në kryerjen e hapave për hartimin dhe miratimin e një politike sektoriale koherente. Është inicuar përafrimi me acquis të BE-së për kontrollet zyrtare, shëndetin e kafshëve dhe shëndetin e bimëve, por progresi është modest deri tani⁹⁶.

Rregullat e higjienës në BE për prodhimin e produkteve ushqimore sigurojnë një nivel të lartë të sigurisë ushqimore. Shëndeti, mirëqenia e kafshëve dhe siguria ushqimore me origjinë shtazore garantojnë së bashku me cilësinë e farave, materialin për mbrojtjen e bimëve, mbrojtjen nga organizmat e dëmshëm dhe ushqimin e kafshëve.


Reforma e sektorit veterinar kërkon plotësimin e gjitha vendeve vakante dhe rritjen e kapaciteteve të nevojshme për mbikëqyrjen pasive dhe aktive, duke përfshirë vlerësimin e besueshme të prevalencës së sëmundjeve, vlerësimin e plotë të të dhënave, si dhe hartimin, planifikimin dhe zbatimin e sistemeve efektive për parandalimin dhe/ose çrrënjësjen e sëmundjeve.

Objektivi specifik: përmirësimi i kushteve sanitare dhe veterinarë me qëllim që të mbrohet shëndeti i konsumatorëve

Në vitin 2022, janë raportuar 81 raste të shkeljeve në lidhje me sigurinë ushqimore (N=51), ose 9 raste mesatarisht për nëntë bashkitë që kanë patur raste të shkeljeve; 43 NJVV (70%) kanë patur zero raste të shkeljeve. Krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit, më shumë raste të shkeljeve në lidhje me sigurinë ushqimore janë raportuar (29 raste gjithsej gjatë 2021).

Mesatarisht, norma e **tregjeve të kafshëve të gjalla të liçensura** ka qenë 18% duke zbritur me 2.9 p.p kundrejt vitit 2021 (N=55); 39 bashki (66%, N=59) kanë raportuar zero tregje të liçensura, ndërsa 4 NJVV kanë raportuar “nuk ka”. Edhe për tregjet e shitjes me pakicë, në vitin 2022 evidentohet ulje e lehtë e normës mesatare të tregjeve të shitjes me pakicë të liçensuara – 34% , ose 2.7 p.p. më pak nga 2021 (N=57); 25 NJVV (41%) kanë raportuar zero tregje të liçensuara të shitjes me pakicë.

Grafiku 43: Shkalla mesatare e liçensimit të tregjeve në NJQV, 2017-2022



⁹⁶ Raporti i Progresi të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

Progres është bërë lidhur me ngritjen e qendrave për mbrojtjen e kafshëve, si një masë e politikës sektoriale të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – 8 qendra kanë qenë funksionale (N=49) kundrejt vitit 2021 (ose 2 qendra më shumë). Në vitin 2022, NJVV me qendra funksionale janë bashkia Shkodër, Durrës, Tiranë, Lushnjë, Pogradec, Skrapar, Korçë, Gjirokastër. Ndërsa në vitin 2021, qendra të tilla janë raportuar të ngritura /e funksionale në bashkitë Mat dhe Elbasan, por për vitin 2022 janë raportuar ‘jofunksionale’ nga këto NjVV.

Objektivi specifik: Funksonimi eficient i sistemit të mbrojtjes së konsumatorëve


Nuk është bërë progres në ngritjen e zyrës të konsumatorit pranë NJVV – gjithsej ka patur 32 Zyra të Konsumatorit të ngritura në NJVV në vitin 2022 (N=59), krahasuar me 34 të raportuara për vitin 2021.

NJVV, të cilat kanë hapur zyrën për mbrojtjen e konsumatorit gjatë vitit 2022 janë Bashkia Cërrik dhe Kuçovë, ndërsa bashkia Malësia e Madhe, Vau i Dejës dhe Roskovec raportojnë se nuk e kanë patur operacionale zyrën e konsumatorit në vitin 2022, në dallim nga viti 2021.


Gjithsej, nga qytetarët janë paraqitur 616 ankesa për sigurinë ushqimore pranë zyrës së konsumatorit (N=52), ose mesatarisht 12 ankesa (treguesi ka rritje të konsiderueshme në krahasim me vitin 2021 (378 ankesa në total) dhe me vitin 2020 (292 ankesa në total).

Numri më i madh i ankesave për sigurinë ushqimore raportohet nga bashkia Belsh (168), Bashkia Peqin (150) dhe Bashkia Bulqizë (100). 33 NJVV (54%) raportojnë zero ankesa mbi sigurinë ushqimore të paraqitura në bashki (N=52).

Harta 8: Zyra për mbrojtjen e konsumatorit



Grafiku 44: Nr i ankesave të qytetarëve për sigurinë ushqimore në zyrën e konsumatorit/bashki, 2020-2022



Probleme dhe sfida

- Mungesa e investimeve në ngritjen e tregjeve publike në përputhje me standartet e nevojshme.
- Mungesa e Zyrës së Konsumatorit pranë NJVV vështirëson adresimin e problemeve mbi sigurinë ushqimore nga ana e qytetarëve.
- Kapacitete të pakta të NJVV lidhur me monitorimin dhe kontrollin mbi sigurinë ushqimore dhe rregjistrin e ankesave të qytetarëve.
- Një numër relativisht i konsiderueshëm i NJVV nuk raportojnë të dhëna të vlefshme mbi rastet e shkeljeve në lidhje me sigurinë ushqimore dhe fitosanitare.

Disa nga rekomandimet për periudhën e mëparshme janë relevante edhe për këtë raportim:

Rekomandime

- Të përmirësohet cilësia e statistikave të inspektimit, duke mos e kufizuar në numrin e inspektimeve apo të masave të marra për shkeljet si dhe përmirësimi i menaxhimit të të dhënave për të rritur efikasitetin në raportim⁹⁷.
- Zvogëlimi i barrës administrative për planifikimin dhe raportimin mbi kontrollet zyrtare të bazuara në rrezik dhe sigurimi i transparencës së të dhënave kombëtare⁹⁸.
- Ngritja e zyrës për mbrojtjen e konsumatorëve në NJVV e tjera dhe trajnimi i punonjësve të rinj.
- Rritja e financimit nga ana e NJVV për të përmirësuar standartet e tregjeve dhe liçensimi i tyre i plotë, në përputhje me protokollet dhe standartet e kërkuara.
- Të merret pronësia e plotë e fushatave të vaksinimit dhe të kalohet në planifikimin dhe përdorimin e mjeteve të veta për fushata të tilla në të ardhmen, në përputhje me detyrimet për të harmonizuar me acquis të BE-së⁹⁹.

PËRFUNDIME MBI POLITIKAT E SIGURISË USHQIMORE, VETERINARE DHE FITOSANITARE

Në vitin 2022, është ulur norma mesatare e tregjeve të shitjes me pakicë konform standarteve të kërkuara. Ky trend zbritës konstatohet gjithashtu në normën mesatare të tregjeve të kafshëve të gjalla të liçensura në krahasim me vitin e mëparshëm të raportimit. Lidhur me objektivin e funksionimit eficient të sistemit të mbrojtjes së konsumatorëve, konstatohet një numër më i lartë i ankesave të qytetarëve mbi sigurinë ushqimore të paraqitura pranë zyrës së konsumatorit në bashki, në vitin 2022, në krahasim me vitin e mëparshëm të raportimit. Reforma e sektorit veterinar kërkon plotësimin e gjithë vendeve vakante dhe rritjen e kapaciteteve të nevojshme për mbikëqyrjen pasive dhe aktive, miratimin e një politikë kombëtare të konsoliduar për sigurinë ushqimore dhe harmonizimin e ligjeve përkatëse për kontrollet zyrtare, shëndetin e kafshëve dhe shëndetin e bimëve në këtë kuadër¹⁰⁰.

Gjithashtu, nevojitet ngritja e zyrës për mbrojtjen e konsumatorëve në NJVV e tjera dhe trajnimi i punonjësve të rinj, rritja e financimit nga ana e NJVV për të përmirësuar standartet e tregjeve dhe liçensimi i tyre plotë.

⁹⁷ Raport i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

⁹⁸ Raport i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

⁹⁹ Raport i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

¹⁰⁰ Raport i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)


3.3 Kapitulli 14: Politikat e transportit

Shqipëria zotëron një inventar rrugësh rurale prej 12 mijë km, nga të cilat 4,980 km janë rrugë rurale me karakter komunal dhe 4,471 km janë rrugë me karakter rajonal. Bashkitë janë përgjegjëse për të kryer shërbimet e ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve lokale, për të kryer klasifikimin e rrjetit rrugor, krijimin e hartave të rrugëve dhe kadastrës së rrjetit rrugor në administrimin e NJVV, dhënien e autorizimit dhe lejet për ndërtimin dhe mbrojtjen e rrugëve dhe hapësirave publike, kanalet e ujit, linjat e energjisë, telekomunikacionit, deklasifikimin e rrugëve lokale, installimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit e sinjalistikës rrugore dhe administrimin e transportit rrugor¹⁰¹.


Objektivi specifik: rritja e sigurisë rrugore në nivel vendor

Infrastruktura rrugore urbane që përmbush standartet e ndërtimit ka qenë në nivel të ngjashëm me vitin e mëparshëm të raportimit - 59.5% (N=56), ndërsa është bërë përparim në përmirësimin e rrjetit rrugor rural sipas standardeve të ndërtimit – norma mesatare raportohet 40.6% (N=55) ose +1.9 p.p kundrejt vitit 2021. Gjithashtu, përmirësim është bërë nga NJVV në përmirësimin e sinjalistikës rrugore të rrugëve të administruara nga bashkia – norma mesatare e rrjetit rrugor ekzistues të territorit të bashkisë, me sinjalistikë në përputhje me standartet ka qenë 46.9% (N=56) në vitin 2022 ose +2.2 p.p. krahasuar me vitin 2021.

Grafiku 45: Norma e përputhshmërisë të rrjetit urban me standartet, 2022




Grafiku 46: Norma e përputhshmërisë të rrjetit rural me standartet, 2022




¹⁰¹ Ligj Nr. 139/2015, neni 23, Urdhër i Kryeministrit (nr. 127/2015), VKM Nr. 915/2015 për transferimin e funksionit, Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, Ligjin për transportin rrugor Nr. 83/1998.

Grafiku 47: Tendeca e përputhshmërisë të rrjetit rrugor dhe sinjalistikës me standartet, 2018- 2022




Lidhur me lidhshmërinë e fshatrave, në 2022, konstatohet që fshatrat që nuk lidhen me qendrën e bashkisë në raport me numrin e plotë të fshatrave është ulur në një normë mesatare 23% (N=54), ose -1.4 p.p. në krahasim me vitin 2021; Evidentohet rritje e normës së fshatrave të NJA të lidhura midis tyre nëpërmjet rrjetit rrugor – mesatarisht në 83.8% (N=54) ose +4.8 p.p. krahasuar me vitin 2021.

Grafiku 48: Norma e konektivitetit të fshatrave nëpërmjet rrjetit rrugor, 2019-2022 (*)¹⁰²

Në 2022, konstatohet që financimi nga buxheti vendor për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve ka pësuar ulje – norma mesatare ka qenë 11.03% të buxhetit vendor (N=52), ose – 1.84 p.p. krahasuar me vitin 2021, ndërsa financimi për mirëmbajtjen e rrugëve dhe përmirësimin e sinjalistikës për të rritur sigurinë rrugore është rritur, përkatësisht në 6.7% e buxhetit të NjVV, ose +1.4 p.p. kundrejt vitit 2021 (N=52), dhe 3.5% për përmirësimin e sinjalistikës (ose +1.1 p.p. referuar vitit 2021).

Grafiku 49: Buxheti vendor për mirëmbajtjen, ndërtimin e rrugëve dhe sinjalistikën, 2018 - 2022



¹⁰² (*) Treguesi është riformuluar në vitin 2021, si rrjedhim nuk ka të dhëna për vitin 2019 dhe 2020.

Objektivi specifik: përmirësimi i transportit publik

Përmirësimi i transportit publik vlerësohet nëpërmjet dy treguesve të performancës: Harta e linjave të transportit publik të bashkisë publikuar në stacione të autobusëve, oraret e (urban dhe interurban) të publikuar në stacione të autobusëve.

Progres i lehtë është bërë gjatë vitit 2022 lidhur me publikimin e hartës së linjave të transportit publik - gjithsej kanë qenë 22 bashki të cilat e kanë realizuar publikimin e hartës ose 1 bashki më shumë krahasuar me vitin 2021 (N=59). NJVV që raportojnë mbi plotësimin e kësaj mase në vitin 2022 janë bashkia Fier, Dibër, Patos, Finiq dhe Bulqizë, ndërsa NJVV që nuk e kanë plotësuar këtë masë krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit janë bashkia Pogradec, Mirditë, Vorë dhe Memaliaj.


Gjithashtu, progres është bërë nga NJVV lidhur me publikimin e orareve të lëvizjes të mjeteve të transportit publik - gjithsej 35 bashki ose 3 bashki më shumë krahasuar me vitin 2021 (N=58). NJVV që raportojnë mbi plotësimin e kësaj mase në vitin 2022 janë bashkia Tiranë, Durrës, Vlorë, Finiq dhe Mallakastër, ndërsa NJVV që nuk e kanë plotësuar këtë masë krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit janë bashkia Pogradec, Has, Kolonjë dhe Poliçan.

Objektivi specifik: nxitja e ecjes në këmbë dhe e përdorimit të biçikletës


Progres i lehtë është bërë nga NJVV për zgjerimin e rrjetit të korsive të dedikuara për lëvizjen me biçikleta në zonat urbane të bashkisë - niveli mesatar ka qenë 5.49% në vitin 2022 (N=54), ose 0.47 p.p. më shumë krahasuar me vitin 2021. Bashkia Tiranë raporton rritjen më të madhe të rrjetit të lëvizjes me biçikleta dhe përkatësisht në nivelin 78% ose 5 p.p. më shumë nga vitit 2021. Njëzet e gjashtë (26) NJVV (ose 43%) raportojnë zero km linjë të dedikuar për lëvizjen me biçikleta.

NJVV kanë rritur gjatësinë e rrjetit rrugor të brendshëm të zonave urbane të bashkisë të pajisur me trotuarë – në 2022, norma mesatare ka qenë 61.8% (N=57) ose një rritje me 4.2 p.p. në krahasim me vitin 2021. Dyzet e dy (42) bashki (ose 69%) kanë një normë të barabartë ose më të lartë se 50% të rrjetit urban me trotuarë. Gjithsej, janë organizuar 171 fushata promovimi të lëvizjes në këmbë dhe me biçikleta ose mesatarisht 3 fushata (N=56) ose 87 fushata më shumë të ndërmarra, krahasuar me vitin 2021. Në vitin e raportimit, vetëm 2 NJVV nuk kanë ndërmarrë fushata promovimi kundrejt 30 bashkive në vitin e mëparshëm të raportimit.

Grafiku 50: Norma e rrjetit rrugor urban të plotësuar me trotuarë, 2022 (në %)



Grafiku 51: Fushata promovimi të ecjes në këmbë dhe me biçikleta të kryera nga NjVV, 2022



Kutia 3: Sfida të bashkive për mirëmbajtjen e rrugëve dhe sinjalistikën gjatë vitit 2022

Bashkia Berat: Gjetja e burimeve alternative të financimit nëpërmjet bashkë-financimeve.

Bashkia Delvinë: Përmirësimi i infrastrukturës rrugore për 70% të rrjetit rrugor ekzistues.

Bashkia Dibër, Divjakë: Kapacitete të pakta financiare për ndërhyrje në infrastrukturën rrugore dhe mirëmbajtjen. Dëmtimi i sinjalistikës ekzistuese paraqet një problem për përmirësimin e shërbimit.

Bashkia Himarë: Rritja e sigurisë në rrugë dhe vendosja e sinjalistikës

Bashkia Këlcyrë: Rritje të investimeve në rrugë. Duhet krijuar baza e të dhënave.

Bashkia Lezhë: Rikualifikimi i rrugëve të paasfaltuara.

Bashkia Pogradec: Përmirësimi i infrastrukturës dhe plotësimi në masën 20% të standardeve të ndërtimit të 40 km të akseve më të rëndësishme.

Bashkia Kamëz Korçë: Rritja e standardeve të rrjetit rrugor dhe sinjalistikës.

Bashkia Shkodër: Përbalimi i kostove për ndërtimin për përmirësim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës.

Bashkia Tropojë: Në vitin 2022 është instaluar semafori i parë. Sfidë mbetet që i gjithë rrjeti të jetë në përputhje me standartet e ndërtimit.

Bashkia Korçë: Krijimi i kushteve infrastrukturore për të lidhur fshatrat me qendrën e bashkisë.

Bashkia Librazhd: Përmirësimi i politikave të transportit.

Bashkia Sarandë: Mirëmbajtja e rrugëve.

Disa nga sfidat dhe rekomandimet të raportimit të mëparshëm mbeten të vlefshme:

Probleme dhe sfida

- Burime financimi të pamjaftueshme për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore.
- Sinjalistika në rrugë nuk përmbush standartet e kërkuara.
- Një numër i konsiderueshëm i bashkive nuk kanë hartuar dhe publikuar hartën e transportit publik.
- Numri i kufizuar i linjave të transportit ndërrurban (nuk ka mbulim të gjithë territorit).
- Mungesë e terminaleve të përshtatshme të mjeteve të transportit publik në NjVV.

Rekomandime

- Fuqizimi i kapaciteteve të menaxhimit për funksionin e administrimit të rrugëve nga NjVV.
- Sigurimi i mbështetjes financiare në zbatimin e programeve të zhvillimit rural që mund të financohen nga vetë NJVV-të, Qeveria apo partnerë të tjerë të zhvillimit.
- Mbështetje financiare për investime në ndërtimin e terminaleve të reja të mjeteve të transportit publik / ose të stacioneve multimodale.
- Shtimi i linjave të reja të transportit publik ndërrurban për të përmirësuar mbulimin e territorit dhe popullsisë me këtë shërbim.

PËRFUNDIME MBI POLITIKËN E TRANSPORTIT

Kanë vijuar gjatë vitit 2022 zbatimi i projekteve nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), që përfshin edhe infrastrukturën rrugore nga disa programe të financuara nga Banka Botërore (BB), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Qeveria Shqiptare në disa bashki të vendit, si Bashkia Shkodër, Sarandë, Gjirokastër, Fier, Korçë, Pogradec dhe investime nën programin 100 Fshatrat.

Progres është arritur në përmirësimin e rrjetit rrugor rural sipas standarteve dhe sinjalistikës rrugore krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit, ndërsa infrastruktura urbane paraqitet në të njëjtin nivel. Gjithashtu, evidentohet një rritje e normës së fshatrave të NJA të lidhura midis tyre nëpërmjet rrjetit rrugor. Financimi nga buxheti vendor për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve ka pësuar ulje në vitin 2022 krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit.

Evidentohet një rritje e rrjetit të lëvizjes më biçikleta (në veçanti për bashkinë Tiranë), si edhe e fushatave të promovimit të lëvizjes në këmbë dhe me biçikleta të ndërrmarra nga bashkitë e vendit.

Nevojiten forcimi i mëtejshëm kapaciteteve të menaxhimit dhe të financimit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor urban dhe rural të administruar nga NJVV në përputhje me standartet, përmirësimi i sinjalistikës rrugore, shtimi i linjave të transportit ndërrurban, përgatitja dhe publikimi i hartës të lëvizjes së mjeteve të transportit publik.

3.4 Kapitulli 15: Energjia

Politika energjetike e BE-së përfshin furnizimin me energji, infrastrukturën, tregun e brendshëm të energjisë, konsumatorët, energjinë e rinovueshme, efikasitetin e energjisë, energjinë dhe sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi.

“Në kuadrin e krizës globale të energjisë, përpjekje të tilla, si dhe masa për eficientë e energjisë, duhet të përshpejtohen duke marrë parasysh angazhimet e Shqipërisë sipas Marrëveshjes së Parisit dhe nevojën për t'u angazhuar në tranzicionin e energjisë së pastër, në përputhje me Axhendën e Gjelbërt për Ballkanin Perëndimor¹⁰³. Progres është bërë me zbatimin e Direktivës të Performancës Energjetike në Ndërtesa, përfshirë trajnimin dhe çertifikimin e audituesve të energjisë dhe të performancës energjetike¹⁰⁴”.

Një skemë çertifikimi ka qenë operacionale për performancën e energjisë në vitin 2022. Progres është bërë me zbatimin e Direktivës të Performancës Energjetike në Ndërtesa por mungon një strategji afat-gjatë të rinovimit të ndërtesave. Agjencia për Eficientë e Energjisë ka nisur krijimin e trupës së audituesve të energjisë, e cila do të ketë si detyrë auditimin dhe çertifikimin e të gjitha godinave shtetërore apo private dhe pajisjen e tyre me çertifikatë energjie. Gjithsej janë trajnuar 93 auditues të energjisë në ndërtesa, 11 Auditues të energjisë në instalime industriale, 153 Menaxherë të energjisë të çertifikuar¹⁰⁶.

Aktualisht, Agjencia për Eficientë e Energjisë (AEE), në bashkëpunim me SECO, është duke zhvilluar projektin e bashkive inteligjente, në 4 bashki të vendit Korçë, Berat, Shkodër dhe Përmet. Ky projekt, ndër të tjera, përfshin hartimin e planeve vendore për EE (PVEE) për këto bashki. Këto modele të PVEE, më pas do të implementohen në të gjithë bashkitë e vendit¹⁰⁷.

Përpjekje duhet të bëhen për zbatimin e kushteve të çertifikimit për Alb-Gaz dhe për ta bërë atë një operator të sistemit të transmetimit operacional. Veprime të targetuara duhet të ndërmerren për të krijuar një treg funksional të gazit me qëllim përdorimin e potencialit të infrastrukturës aktuale në vend dhe plane të zhvillimit të infrastrukturës. Miratimi i akteve nën ligjore për të zbatuar Ligjin për EE dhe miratimi i rregullave të etiketimit të paisjeve mbetet një prioritet. Të kryhet një vlerësim i plotë i potencialit për aplikim të bashkë-gjenerimit me eficientë të lartë dhe ngrohje-ftohje eficientë në nivel distrikti (rajon) në përputhje me Direktivën e EE¹⁰⁸.

Objektivat specifike të zhvillimit në kuadër të axhendës së integritit evropian, në nivel vendor, në fushën e energjisë janë (i) Rritja e eficientës së përdorimit të energjisë, (ii) përmirësimi i zbatimit të kërkesave minimale për ndërtesat, shërbimet publike dhe private dhe (iii) rritja e përdorimit të burimeve të rinovueshme dhe politikave promovuese për përdorimin e burimeve të rinovueshme.

¹⁰³ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

¹⁰⁴ Raporti i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për 2022 <https://www.google.com/search?q=Progress+raport+on+Energy+Komunitetit>

¹⁰⁵ Raporti për 2022 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (2022 Report of Energy Community) <https://www.google.com/search?q=Progress+raport+on+Energy+Komunitetit>

¹⁰⁶ Agjencia Kombëtare për Eficientë e Energjisë (AEE); <http://eficenca.gov.al/>

¹⁰⁷ Burim: Agjencia Kombëtare për Eficientë e Energjisë

¹⁰⁸ Raporti i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për 2022


Objektivi specifik: Rritja e efijencës së përdorimit të energjisë.

Progres është arritur lidhur me caktimin e menaxherit për efijencën e energjisë në bashkitë e vendit, si pjesë e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Efijencën e Energjisë, 2021-2030. Gjithsej, 29 NJVV kanë plotësuar këtë masë krahasuar me 15 bashki për vitin e mëparshëm të raportimit. Bashki të reja që raportojnë për caktimin e menaxherit për EE në vitin 2022, janë përkatësisht bashkitë Fier, Mirditë, Korçë, Gjirokastër, Delvinë, Dropull, Divjakë, Kavajë, Devoll, Roskovec, Patos dhe Mallakastër (N=59).

Në vitin 2022, dy (2) projekte janë inicuar nga AEE, të cilat janë në fazë zbatimi për përmirësimin e kushteve të ndërtesave shumëfamiljare në Bashkinë Korçë dhe Bashkia Tepelenë. Gjithashtu, një investim për ndriçimin me Efijencë të Lartë në Unazën Lindore të Bashkisë Shkodër dhe projekte auditimi energjetik në banesa shumëfamiljare, në rreth 40 Bashki të vendit, me qëllim implementimin e mëvonshëm të investimit për rinovimin e këtyre ndërtesave.

Në vitin 2022, nga shërbimi përkatës i bashkisë janë kryer gjithsej 546 kontrolle mbi zbatimin e kërkesave të efijencës së energjisë në ndërtesa për shërbime publike dhe private (afërsisht 2 herë më shumë) krahasuar me numrin e kontrolleve në vitin e mëparshëm të raportimit (N=47). Gjatë inspektimit, janë konstatuar 32 shkelje nga 40 raste të shkeljeve të raportuara në vitin 2021 (N=50), përkatësisht nga Bashkia Tropojë dhe Konispol. Bashkia Klos raporton numrin më të madh të kontrolleve për EE (225), ndjekur nga Bashkia Kamëz (82).

Grafiku 52: Numri i kontrolleve mbi zbatimin e masave për efijencën e energjisë të kryera nga bashkitë, 2018-2022

**Objektivi specifik:** Rritja e përdorimit të burimeve të rinovueshme dhe politikat promovuese për përdorimin e burimeve të rinovueshme.

Siguria në furnizim: Direktiva 2005/89/EC është transpozuar por nuk ka rregulla të përfshira/të miratuara në sigurinë e furnizimit në vend. Sasia totale e energjisë së rinovueshme është 2507 megavat. Lidhur me zbatimin e masave për energjinë e rinovueshme, është vendosur target për efijencën e energjisë 2030 dhe masat respektive janë bërë pjesë e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën miratuar në Shkurt 2022¹⁰⁹.

¹⁰⁹ Raporti i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për 2022

Në vitin 2022, janë zbatuar 22 projekte që bazohen në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë (N=49) krahasuar me 42 projekte për vitin 2021. Bashkia Himarë ka zbatuar 4 projekte të bazuara në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, e ndjekur nga Bashkia Has, Maliq dhe Devoll (2 projekte), dhe bashki të tjera, si Bashkia Finiq, Pustec, Përmet, Berat, Kukës, Kavajë, Dibër, Krujë, Gjiro-kastër, Durrës, Belsh, Malësi e Madhe dhe Kurbin (1 projekt).

Kutia 4: Sfida të bashkive për zbatimin e politikave për eficientë e energjisë në vitin 2022

Bashkia Belsh, Delvinë: Trajnimi dhe çertifikimi i menaxherit për eficientë e energjisë (EE).

Bashkia Dropull: Buxheti i pakët.

Bashkia Himarë, Përmet, Roskovec: Rekrutimi i menaxherit për eficientë e energjisë.

Bashkia Sarandë: Mungesë të kapaciteteve për hartimin e një plani vendor mbi EE.

Bashkia Korçë: Çertifikimi i menaxherit për EE dhe hartimi i PVEE.

Bashkia Dibër: Mungesë të kapaciteteve për hartimin e planit Vendor për EE.

Bashkia Përmet, Prrenjas, Rogozhinë, Selenicë, Tropojë: Hartimi dhe zbatimi i PVEE.

Bashkia Shkodër: Përmirësim i situatës energjitike nëpërmjet zbatimit të planit vendor për EE.

Bashkia Mirditë, Roskovec, Selenicë: Shtimi i projekteve që përmbushin kërkesat për EE.

Bashkia Tiranë: Janë në proces zbatimi 2 shkolla dhe 1 kopsht dhe ka përfunduar godina e qendrës rinore në përputhje me kërkesat për EE. Në rreth 64 investime të kryera në infrastrukturë rrugore, ndriçimi është realizuar LED. Objektet që do të rikonstruktohen/ose ndërtime të reja do të përmbushin kërkesat për eficientë e energjisë.

Disa nga sfidat dhe rekomandimet e raportimit të mëparshëm janë të vlefshme edhe për këtë periudhë raportimi.

Probleme dhe sfida

- Rreth 52% e NJVV nuk kanë caktuar menaxherin për eficientë e energjisë.
- Kapacitete të vogla në bashkitë e vendit për hartimin e planit vendor për EE (PVEE).
- Burime financiare të limituara për të mbuluar pozicionin e menaxherit për eficientë e energjisë në bashkitë e vogla.
- Mungesa e menaxherit për eficientë e energjisë është pengesë në kryerjen e inspektimeve që duhet të ndërmerret bashkia në zbatimin e masave për EE në rikonstruksione dhe ndërtime të reja, si publike ashtu edhe private.
- Aspekte të bashkëveprimit midis NJVV dhe AEE për të mundësuar trajnimin dhe çertifikimin e menaxherit për eficientë e energjisë të punësuar nga bashkia.

Rekomandime

- Caktimi i menaxherit për efikasitetin e energjisë në të gjitha bashkitë, trajnimi dhe çertifikimi i tij.
- Hartimi dhe miratimi i PVEE nga të gjitha bashkitë, në përputhje me Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (2021-2030) dhe parashikimi i tij në PBA për të mbështetur zbatimin e tij.
- Rritja e kapaciteteve për prokurimin e gjelbërt.
- Rritja e kapacitetit kontrollues dhe inspektimit të shërbimeve bashkiake në zbatimin e masave të kontrollit dhe kërkesave në ndërtesat për shërbimet publike dhe private dhe ndërtimet për banesa.

PËRFUNDIME MBI ENERGIJË

Progres është bërë në caktimin e menaxherit për efikasitetin e energjisë, por më shumë se 50% e NJVV nuk e kanë ende caktuar dhe çertifikuar menaxherin për efikasitetin e energjisë. Numri i projekteve të zbatuara sipas kërkesave të efikasitetit të energjisë është rritur në krahasim me vitin e mëparshëm të raportimit. Gjithashtu, numri i kontrolleve të ndërmarra gjatë vitit 2022 nga shërbimet bashkiake mbi zbatimin e kërkesave të efikasitetit të energjisë në ndërtesa për shërbime publike dhe private është pothuajse dyfishuar krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit. Sfidat për NJVV mbeten caktimi dhe çertifikimi i menaxherit për efikasitetin e energjisë në bashkëpunim me AEE dhe hartimi/ miratimi dhe zbatimi i PVEE.

3.5 Kapitulli 16: Taksat

Rregullat e BE-së mbi taksimin mbulojnë taksën mbi vlerën e shtuar dhe detyrimet e akcizës, si dhe aspektet e taksimit të korporatave, si dhe me bashkëpunim midis administratave tatimore, përfshirë shkëmbimin e informacionit për të parandaluar evazionin fiskal.

“Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e taksave. Është bërë përparim, në veçanti duke adresuar rekomandimet e vitit të kaluar, të cilat përfshijnë respektimin e planeve të pagesave të dakorduara për rimbursimet e TVSH-së dhe reduktimin e stokut të detyrimeve të prapambetura në rimbursimet e TVSH-së, miratimin e një kalendarit të ri për akcizën e duhanit dhe konsultimin e draft strategjisë afatmesme, i cili përfshin propozime për adresimin e shpenzimeve tatimore.”¹¹⁰

Në vitin 2022, u hartua dhe konsultua projektligji mbi “Sistemin e taksës së pasurisë” që pasqyron përmbushjen e standarteve të sigurisë juridike, vlerësimin e pronës sipas vlerës reale dhe përafrimin e shkallës së taksimit me vendet e rajonit. Taksa e pasurisë është një element kyç për sistemin e financave vendore. Të ardhurat nga taksa e pasurisë në periudhën afatmesme janë rritur nga 0.33% të PBB në 1% (5.67 miliard lekë në 2022). Aktualisht në 9 bashki po pilotohet “Kadastra fiskale”, por aksesit dhe funksionalitetet janë të njëjta për të gjithë NJVV¹¹¹.

Në vitin 2022, u hartua dhe miratua projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i cili u konsultua gjithashtu edhe në KK pushtet qendror – vetëqeverisje vendore (ligji hyri në fuqi në datën 1 janar 2023). Ndryshimet ligjore u projektuan me qëllim zëvendësimin e shpenzimeve vjetore të miratuara me shpenzimet vjetore faktike, në formulën e përlllogaritjes së përqindjes që zë vlera e stokut të detyrimeve të konstatuara dhe të papaguara, që kanë njësitë e vetëqeverisjes vendore ndaj palëve të treta. Po ashtu për qëllim uljen e masës së detyrimeve të prapambetura që mund të krijojnë NJVV, përcaktohet “përdorimi i fondeve të trashëguara dhe të pa angazhuara nga viti i kaluar, jo më pak se 30 përqind e tyre të përdoren automatikisht për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe pagimin e nënshpërve të papaguara në kohë”. Procedurat dhe mënyra e përdorimit të fondeve të trashëguara nga viti i kaluar dhe të pa angazhuara, bëhen me udhëzim të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë.

Bashkitë kanë patur performancë pozitive në të gjithë zërat e treguesve fiskalë në 2022. Të ardhurat vendore kanë konsoliduar, burime të qëndrueshme si të ardhurat nga taksa e pasurisë apo tarifatat e pastrimit. Të ardhurat e veta të pushtetit vendor janë realizuar në vlerën e 24.4 miliard lekë për periudhën janar-shtator 2022 (përbëjnë 6% të totalit të të ardhurave publike). Rreth 90.7% ose 22 miliard lekë e zënë taksat dhe tarifatat vendore (realizuar 80% e planit vjetor). Krahasuar me vitin 2021, të ardhurat vendore janë rritur me 5.5% (rreth 1.3 miliard lekë). Rritja e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore kanë qenë rreth 4.9%, ndërsa të ardhurat jo tatimore janë rritur me 10.8%. Nga pikëpamja strukturore, 4 lloje të taksave dhe tarifave vendore kanë siguruar 85% të të ardhurave të veta të mbledhura nga NJVV – taksa e ndikimit në infrastrukturë (36%), taksa mbi ndërtesat (17%), tarifa pastrimi e higjiene (18%) dhe zëri taksa të tjera (14%) në 9 mujin 2022¹¹².

¹¹⁰ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

¹¹¹ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, fjala e Zev. Ministres në takimin e Këshillit Konsultativ (2022)


¹¹² Raporti i Treguesve Fiskalë Vendorë, janar-shtator 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, projekti Financat Lokale

Ecuria e reformës së decentralizimit ka nxjerrë si domosdoshmëri rritjen e përqindjes së transfertës së pakushtëzuar nga 1% të PBB në 1.2 deri 1.4%, me qëllim që qeverisja vendore të ketë më shumë buxhet për të realizuar reformën e decentralizimit në disa sektorë, në të cilat shërbimet janë nën standardet minimale, si shërbimi i pastrimit dhe mbetjet urbane, furnizimi me ujë të pijshëm e kanalizimet, infrastruktura rrugore, infrastruktura ujitëse, mirëmbajtja e rezervuarëve, mbrojtja nga zjarri, administrimi i pyjeve, emergjencat civile. Bashkitë e zonave minerare nuk janë mbështetur financiarisht për pjesën e rentës minerare që përfitonin përpara ndryshimit të ligjit 9975/2006 “Për taksat kombëtare” dhe ligjit 68/2017 “Për Financat Vendore”, duke vështirësuar mundësitë për investime apo mirëmbajtjen e rrugëve, kanaleve vaditëse, etj. Ligji 139/2015 “Për vetqëqeverisjen vendore”, neni 34, pika 5 detyron kompesimin e uljes së të ardhurave, nëpërmjet rritjes së transfertës financiare¹¹³.


Objekti i Specifik: Përmirësimi i administrimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore në drejtim të rritjes së bazës së tatueshme.

Performanca vlerësohet mbi bazën e pesë treguesve: (i) politika tatimore të zbatuara nga bashkia me qëllim parandalimin e ekonomisë informale; (ii) numri i inspektimeve në terren; (iii) numri i dëgjësive publike me grupet e biznesit të organizuara nga bashkia me qëllim informimin dhe përfshirjen në diskutimin e politikave tatimore të bashkisë; (iv) baze të dhënash (program) të debitorëve të bashkisë e ngritur dhe funksionale; (v) ndryshimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore në vitin e raportimit.

Harta 9: Politika tatimore nga NjVV, 2022



Grafiku 53 : Numri i inspektimeve nga tatimet vendore, 2022



¹¹³ Vendim Nr. 6, datë 28.10.2022 (nr.363 prot, dt. 3/11/2022) të Këshillit Konsultativ qeverisje qendore – vetëqeverisje Vendore

Në 2022, 46 NJVV (75%) kanë miratuar *programe të politikave tatimore* që kanë patur për qëllim nxitjen e formalizimit të ekonomisë (4 NJVV më shumë nga 2021), (N=57). Numri i inspektimeve në terren të ndërmarra nga administrata tatimore vendore me qëllim parandalimin e ekonomisë joformale ka qenë 28,892 (87% më shumë nga 2021, N=59), ose mesatarisht 490 inspektime, krahasuar me 15,447 inspektime të ndërmarra në vitin e mëparshëm të raportimit. Bashkia Tiranë ka kryer numrin më të lartë të inspektimeve -13,390 (46% të totalit të inspektimeve (Bashkia Tiranë nuk është përfshirë në grafikun më poshtë)).

Numri i dëgjësive publike me grupet e interesit me qëllim informimin dhe përfshirjen në diskutimin e politikave tatimore të bashkisë ka qenë pak më i ulët në vitin e raportimit – gjithsej 289 dëgjësia (N=59), ose 6.5 p.p. më i ulët nga 2021.

Baza e të dhënave të debitorëve të bashkisë është e ngritur dhe funksionale në 47 NJVV (77% të NJVV) nga 46 që ka qenë në vitin e mëparshëm të raportimit (N=60). Bashki që raportojnë për bazën e të dhënave të debitorëve funksionale në 2022 janë Kurbini dhe Këlcyrë, ndërsa bashkitë Tropojë, Vorë, Divjakë dhe Pogradec nuk e kanë patur programin funksional në 2022 në dallim nga viti i mëparshëm i raportimit.

Kutia 5: Sfida të bashkive për zbatimin e politikave tatimore vitin 2022

Bashkia Delvinë, Gjirokastrë, Korçë: Bashkëpunimi me Drejtorinë Tatimore Rajonale Sarandë për një fushatë promovimi për nxitjen e formalizimit të ekonomisë; Vazhdimi i punës kundër informalitetit; Formalizimi 100% i bizneseve që operojnë në territorin e bashkisë.

Bashkia Dropull: Ulja e debitorëve në numër dhe vlerë.

Bashkia Kavajë: Përjashtimi nga taksat në vitin e parë të regjistrimit të subjekteve të reja (kategoria i vetëpunësuar).

Bashkia Librazhd: Përmirësimi i administrimit të sistemit të taksave në drejtim të rritjes së bazës së tatueshme.

Bashkia Shkodër: Nxitja e pjesëmarrjes së grupeve të biznesit në vendimmarrje.

Bashkia Selenicë: Hartimi i politikave mbështetëse nga ana e bashkisë.


Bashkia Tiranë: Krijimi i një sistemi të taksave e tarifave të mbështetur mbi ndërtesën (harta GIS). Përmirësimi i hapësirave ligjore për nxitjen e formalizimit për taksën e ndërtesës duke ndryshuar VKM nr.132, datë 7.3.2018, të ndryshuar.

Bashkia Durrës: Lufta kundër informalitetit; rritja e numrit të tatimpaguesve të kategorisë që janë shpërngulur nga zona të tjera të vendit.

Bashkia Klos: Mungojnë strukturat e inspektimit në terren.

Në vitin 2022, ndryshimin më të lartë të të ardhurave të veta krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit (2021) e kanë patur bashkitë Dibër (124%), Gramsh (52%), Skrapar (48%), ndërsa rritjen më të ulët (negative) e ka patur Bashkia Dropull i Poshtëm (-47%), Bashkia Këlcyrë (-30%), dhe Bashkia Selenicë (-24%); 21 NJVV (rreth 34% e tyre) kanë patur ulje të të ardhurave të veta në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021.

Grafiku 54: Norma e ndryshimit të të ardhurave të veta (2022/2021)



Burim: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë/Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Disa nga sfidat dhe rekomandimet të periudhës së mëparshme janë të vlefshme edhe për këtë raportim:

Probleme dhe sfida

- Ulja e detyrimeve të prapambetura (ulja e debitorëve në numër dhe vlerë).
- Mungesa e një sistemi unik dhe modern për administrimin e taksave vendore nga të gjitha bashkitë.
- Mungesa e formalizimit të tatimpaguesve (të kategorisë që janë shpërngulur nga zona të tjera të vendit).
- Mungojnë strukturat e mjaftueshme të inspektimit në terren në disa NJVV.

Rekomandime

- Zbatimin e masave për reduktimin e shpenzimeve tatimore, veçanërisht për shkak të përjashtimeve.
- Thjeshtëzimi i sistemit të tatimeve duke inkurajuar rritjen e pajtueshmërisë së tatimeve¹¹⁴.
- Rritja e të ardhurave në mënyrë miqësore dhe forcimi i administrimit fiskal.
- Përmirësimi i transparencës mbi performancën në ekzekutimin e buxhetit dhe të ardhurave të pushtetit vendor.
- Krijimi i një sistemi të taksave e tarifave të mbështetur mbi ndërtesën (hartat GIS). Përmirësimi i hapësirave ligjore për nxitjen e formalizimit për taksën e ndërtesës duke rishikuar VKM nr.132, datë 7.3.2018 “Për Metodologjinë për Përcaktimin e Vlerës së Taksueshme të Pasurisë së Paluajtshme “Ndërtesa”, të ndryshuar.
- Përmirësimi i formulës së transfertës së pakushtëzuar që diskriminon bashkitë e varfra të zonave minerale për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve publike nga bashkia.
- Zbatimi i kadastrës fiskale në të gjitha NJVV. Bashkitë duhet të identifikojnë të gjitha pronat, të identifikojnë të gjithë taksapaguesit dhe gabimet në regjistrë¹¹⁵.

PËRFUNDIME PËR TAKSAT

Në fushën e taksave, përparim është bërë në respektimin e planeve të pagesave të dakorduara për rimbursimet e TVSH-së dhe reduktimin e stokut të detyrimeve të prapambetura në rimbursimet e TVSH-së¹¹⁶. Ndryshime ligjore u miratuan me qëllim zëvendësimin e shpenzimeve vjetore të miratuara me shpenzimet vjetore faktike, në formulën e përlllogaritjes së përqindjes që zë vlera e stokut të detyrimeve të konstatuara dhe të papaguara, që kanë njësitë e vetëqeverisjes vendore ndaj palëve të treta. Bashkitë kanë patur performancë pozitive në të gjithë zërat e treguesve fiskalë në 2022. Të ardhurat vendore kanë konsoliduar, burime të qëndrueshme si të ardhurat nga taksat e pasurisë apo tarifatat e pastrimit. Ecuria e reformës së decentralizimit ka nxjerrë si domosdoshmëri rritjen e përqindjes së transfertës së pakushtëzuar nga 1% të PBB në 1.2 deri 1.4%, me qëllim që qeverisja vendore të ketë më shumë buxhet për të realizuar reformën e decentralizimit në disa sektorë, në të cilat shërbimet janë nën standardet minimale¹¹⁷.

¹¹⁴ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

¹¹⁵ Ministria e Financave dhe Ekonomisë_Këshilli Konsultativ pushtet qendror - vetëqeverisja vendore

¹¹⁶ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

¹¹⁷ Vendim Nr. 6, datë 28.10.2022 (nr.363 prot, dt. 3/11/2022) të Këshillit Konsultativ qeverisje qendore – vetëqeverisje Vendore

Disa tregues të përformancës kanë patur trend rritës krahasuar me vitin e kaluar të raportimit, si më shumë programe të politikave tatimore janë zbatuar gjatë vitit të raportimit, është rritur ndjeshëm numri i inspektimeve në terren, të ndërmarra nga administrata tatimore vendore me qëllim parandalimin e ekonomisë joformale, baza e debitorëve të bashkisë është e ngritur dhe funksionale. Ulje ka patur numri i dëgjësive publike që shërbimet bashkiake kanë ndërmarrë me grupet e interesit, me qëllim informimin dhe përfshirjen e tyre në diskutimin e politikave tatimore të bashkisë.

Sfida mbeten përmirësimi i sistemit të administrimit të taksave vendore (dixhitalizimi dhe unifikimi i sistemit për të gjitha bashkitë), informimi dhe ndërgjegjësimi për formalizimin e bizneseve, rritja e numrit të tatimpaguesve të kategorisë së qytetarëve që janë shpërngulur nga zona të tjera të vendit në disa bashki, kapacitete të kufizuara të inspektimit në terren në disa NJVV.

Rekomandohet zbatimi i masave për reduktimin e shpenzimeve tatimore, veçanërisht për shkak të përjashtimeve, thjeshtëzimi i sistemit të tatimeve duke inkurajuar rritjen e pajtueshmërisë së tatimeve¹¹⁸, forcimi i administrimit fiskal dhe zbatimi në shkallë të plotë i kadastrës fiskale në të gjitha NJVV.

¹¹⁸ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

3.6 Kapitulli 19: Politikat sociale dhe punësimi

“Shqipëria ka një nivel përgatitjeje për politikat sociale dhe punësimin. Njëfarë progresi është bërë veçanërisht duke forcuar cilësinë dhe efektivitetin e institucioneve të tregut të punës dhe ofrimin e shërbimeve të punësimit për grupet më vulnerabël. Reforma e kujdesit social po përparon, por përpjekjet financiare dhe administrative duhet të rriten për të forcuar kapacitetet e nivelit vendor për ofrimin e shërbimeve dhe lidhjen me masat e tregut të punës aktiv.¹¹⁹”

Gjatë vitit 2022 në Këshillin Konsultativ (KK) për vetëqeverisjen vendore janë paraqitur për diskutim:

- Projekt Vendimi “Për miratimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve të ofrimit të shërbimeve për një jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuar”, i miratuar me VKM nr. 436, datë 22.6.2022.
- Projekt Vendimi “Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve të ofrimit të vendim-marrjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuar”, i miratuar me VKM nr. 470, datë 6.7.2022.
- Udhëzuesi për Bashkitë “Mbi Buxhetimin e Përgjithshëm për Pakicat Rome dhe Egjiptiane në Nivel Vendor në Shqipëri”. Ky Udhëzues është hartuar me mbështetjen e Programit Romatec financuar nga BE.

Progresi në zbatimin e politikave në fushën sociale dhe punësimin në nivel vendor lidhet me tre objektiva specifike dhe vlerësimin e 23 treguesve të performancës.

Objektivi specifik: *Mbrojtja sociale në nivel vendor*

Progresi i objektivit specifik *mbrojtja sociale në nivel vendor vlerësohet me treguesit e mëposhtëm:*


- Numri i nëpunësve të administratës vendore përgjegjës për përfshirjen sociale në bashki për vitin 2022 në kategorinë “**Njësia për mbrojtjen e fëmijëve**” është në total 103 nëpunës, ose mesatarisht 1.78 për Bashki (N=58). Treguesi ka ulje në krahasim me vitin 2021 ku janë raportuar 109 dhe në vitin 2020 ku janë raportuar në total 128 nëpunës për këtë kategori. Numrin më të madh të punonjësve e raportojnë Bashkitë Durrës dhe Gjirokastër me 7 dhe Kamëz me 6 nëpunës. Bashkitë Librazhd, Malësi e Madhe dhe Poliçan nuk raportojnë për këtë tregues.
- Numri i nëpunësve të administratës vendore, përgjegjës për përfshirjen sociale në bashki, për vitin 2022 në kategorinë “**Nëpunësi për barazinë gjinore**” është në total 79 nëpunës ose mesatarisht 1.34 për bashki (N=59) me rritje të lehtë nga 69 nëpunës në vitin 2021. Numrin më të madh e ka Bashkia Skrapar me 12 nëpunës për barazinë gjinore. Bashkitë Malësi e Madhe dhe Poliçan nuk raportojnë për këtë tregues.
- Numri i nëpunësve të administratës vendore përgjegjës për përfshirjen sociale në bashki, në kategorinë “**Nëpunësi për dhunën në familje**” është në total 69 ose mesatarisht 1 nëpunës për Bashki (N=59¹²⁰). Numri mesatar është në të njëjtat nivele për bashki të raportuar në 2021.

¹¹⁹ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022)

¹²⁰ Bashkitë Malësi e Madhe dhe Poliçan nuk kanë raportuar

- **Në vitin 2022 raportohet që Sektori i Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit është ngritur në 26 Bashki nga 22 të raportuara në vitin 2021.** Ndërsa buxheti i bashkive i planifikuar për shpenzime të kujdesit social në 2022 përbën mesatarisht 5% të buxhetit total të bashkive nga 7% raportuar në 2021. *Bashkitë Dibër, Gramsh, Has, Himarë, Këlcyrë, Krujë, Malësi e Madhe, Peqin dhe Tropojë, nuk kanë parashikuar fonde në buxhetin e tyre për shpenzime të kujdesit social, dhe 8 Bashki nuk raportojnë për këtë tregues¹²¹.*
- Në vitin 2022 raportohet që **25% e përfituesve në shërbimet sociale janë Persona me Aftësi të Kufizuar.** Ndërkohë që mesatarisht 4 % e strehimit social është ofruar për viktimat të trafikimit ndaj numrit gjithsej të përfituesve të strehimit social në bashki. *Treguesi ka pësuar ulje nga viti 2021 ku është raportuar mesatarisht 7.75% e rasteve të strehimit social për viktimat e trafikimit.*
- **Numri i personave nga grupet vulnerabël që përfitojnë shërbime sociale** në qendrat e themeluara të kujdesit social është në total 12,748 në vitin 2022 ose mesatarisht 220 persona për Bashki (N=58). Numrin më të madh të përfituesve e raporton Bashkia Shkodër me 6,000, Bashkia Tiranë me 1,646 dhe Elbasani me 1,162 persona.
- **Baza statistikore për përfshirjen sociale është ngritur dhe bërë funksionale në 34 Bashki ose 57 % e Bashkive.** *Treguesi mbetet në të njëjta nivele me vitin 2021. Bashkitë Durrës, Peqin, Poliçan, dhe Tepelenë nuk kanë ofruar të dhëna për këtë tregues.*
- **Në 2022 është raportuar për 4,051 nxënës që kanë ndjekur arsimin profesional të cilët kanë përfituar bursa për vitin shkollor ose mesatarisht 71.1 nxënës për bashki (N=57).** Ka patur rritje të lehtë nga viti 2021 ku në total kanë qënë 3,982 nxënës që kanë përfituar bursa.
- Në vitin 2022 kanë përfituar nga strehimi social 35.3 % e rasteve kundrejt nevojave të paraqitura në bashki për strehim social. Vetëm 53 Bashki kanë raportuar për këtë tregues ndërkohë që bashkitë: Belsh, Delvinë, Dibër, Këlcyrë, Poliçan, Rogozhinë, Shijak, Skrapar nuk japin asnjë të dhënë.

Harta 10: Bazë të dhënash për përfshirjen sociale



Objektivi specifik: Mbështetje për programet aktive të punës

- **Numri i të papunëve që marrin ndihmë ekonomike** të cilët janë mbështetur financiarisht nga Bashkia për arsim dhe trajnim profesional në përputhje me nevojat e tregut në nivel vendi janë raportuar gjithsej 6,603 persona ose mesatarisht 137.56 (N=48). *Treguesi ka rritje në numër absolut me 500 persona më shumë krahasuar me vitin 2021. Vihet re se 21% e bashkive nuk kanë raportuar për këtë tregues.* Numrin më të madh e ka raportuar Bashkia Peqin me 3,762 persona dhe Bashkia Memaliaj me 1,180 persona.
- **Numri i personave të papunë-punëkërkuar të mbuluar me skemën e Ndihmës Ekonomike** ka pësuar sërish rritje në vitin 2022 me një shtesë prej 1500 persona më shumë në krahasim me 2021.

¹²¹ Belsh, Cërrik, Konispol, Libohovë, Poliçan, Selenicë, Shijak, Skrapar

- Numri i **PAK që janë përkrahur nga Bashkia** për arsim dhe trajnim profesional në vitin 2022 kundrejt numrit total të PAK që mund të punësohen në tregun e punës janë raportuar në vetëm 4.2% (N=52).
- Në vitin 2022 **numri i të rinjve që përfundojnë arsimin universitar dhe aftësimin profesional**, të cilët janë mbështetur financiarisht nga Bashkia për fillimin e një biznesi privat në fushën e tyre profesionale, janë në total 277 ose mesatarisht 5.33 individë për bashki (N=52). Ky tregues ka rritje nga viti 2021 ku janë raportuar 199 të rinj të mbështetur.
- Në 2022 **numri i bashkive që kanë firmosur Memorandum Bashkëpunimi me Zyrën e Punës** për punësimin e të rinjve si edhe për riintegrimin socio-ekonomik të personave të trajtuar me Ndihmë Ekonomike ka arritur në 52 nga 43 të raportuara në 2021.

Probleme dhe sfida

- Kapacitetet njerëzore në strukturat e mbrotjes sociale sipas tre kategorive janë të pamjaftueshme, për trajtimin e rasteve të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve, dhunës në familje dhe barazisë gjinore.
- Burime të kufizuara teknike dhe financiare për krijimin e bazës së të dhënave statistikore sipas treguesve të BE-së për përfshirjen sociale nga të gjitha bashkitë në vend.
- Mungesa e banesave sociale dhe e programeve të strehimit social është një sfidë për bashkitë, kundrejt nevojave të paraqitura për strehim.
- Përfitimi i shërbimeve sociale në qendrat e themeluara të kujdesit social duhet të jetë më i gjerë dhe më gjithëpërfshirës.
- Përfshirja në skemën e ndihmës ekonomike të familjeve më në nevojë dhe dhënia prioritet grave kryefamiljare dhe atyre me probleme sociale.
- Mungesa e fondeve dhe kapaciteteve profesionale në bashki për personat që trajtohen nga skema e Ndihmës Ekonomike me qëllim integrimin e tyre në tregun e punës.
- Koordinimi ndër-institucional për të nxitur punësimin dhe në mënyrë të veçantë për shtresat në nevojë mbetet në nivele jo të kënaqshme.

Rekomandime

- Organizimi i vazhdueshëm i trajnimeve të dedikuara për barazinë gjinore dhe aspekte të tjera të mbrotjes së fëmijëve dhe rastet e dhunës në familje.
- Miratimi i planeve sociale vendore nga të gjitha bashkitë dhe harmonizimin e tyre me programin buxhetor afatmesëm.
- Rritja e bashkëpunimit me OJF-të lokale të specializuara për ofrimin e shërbimeve sociale si dhe krijimi i instrumentave financiarë për të mbështetur me fonde dhe projekte të dedikuara.
- Nxitja e të rinjve për të ndjekur arsimin profesional përmes ndërmarrjes së fushatave informuese dhe ndërgjegjësuese është domosdoshëmi për të përmirësuar tregun e punës në të ardhmen.
- Rritja e bashkëpunimit me Zyrën e Punës mbi përmirësimin dhe zgjerimin e mundësive për arsim dhe aftësim profesional.

- Rritja e kapaciteteve financiare të Bashkisë për të mbështetur financiarisht të rinjtë për fillimin e një biznesi privat në fushën e tyre profesionale.
- Të sigurohet zbatimi i Fondit Social të Punësimit dhe të vazhdojë forcimi i strukturave të punësimit në nivel vendor¹²².

PËRFUNDIME MBI POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMIN

Zbatimi i politikave sociale dhe të punësimit ka patur një zhvillim të kufizuar gjatë vitit 2022. Kanë vijuar përpjekjet e bashkive për të ngritur Sektorin e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit i cili tashmë është bërë funksional në 26 Bashki. Procesi i hartimit të planeve vendore dhe ngritja e bazës statistike për përfshirjen sociale nuk ka shënuar progres në vitin 2022 duke mbetur në të njëjtat nivele në raport me numrin total.

Më tepër vëmendje i është kushtuar mbështetjes financiare së të rinjve që përfundojnë arsimin universitar dhe aftësimin profesional, për fillimin e një biznesi privat në fushën e tyre profesionale numri i të cilëve ka ardhur në rritje. **Është bashkëpunuar ngushtë me institucionet e tjera sidomos me Zyrën e Punës** për punësimin e të rinjve si edhe për ri-integrimin socio-ekonomik të personave të trajtuar me Ndihmë Ekonomike.

¹²² Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022)

3.7 Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumentave strukturorë


“Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e politikave rajonale dhe të koordinimit të instrumentave strukturorë. Është bërë përparim i kufizuar veçanërisht për miratimin e legjislativionit zbatues të Ligjit për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin. Shqipëria duhet të përgatitet për zbatimin efektiv të acquis të BE-së të kapitullit 22 dhe të faktorizojë kërkesat e fondeve të ardhshme strukturorë/kohezionit në strukturën institucionale, në sistemet financiare të menaxhimit dhe kontrollit, dhe kapacitetet administrative, duke siguruar që të gjitha instrumentet dhe fondet të bëhen gradualisht në përputhje me kërkesat e BE-së të lidhura me parimet e programimit dhe partneritetit¹²³”.

Në shkurt të vitit 2022 në Këshillin Konsultativ (KK) për vetëqeverisjen vendore është paraqitur për diskutim projektvendimi “Për krijimin, përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, i miratuar me VKM nr. 497 datë 27.07.2022. Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin është organi ndërinstitucional, përgjegjës për hartimin, monitorimin e zbatimit, dhe vlerësimin e politikës së zhvillimit rajonal, si dhe koordinimin e zbatimit të masave të ndërmarra në kuadër të programit operacional për zhvillimin rajonal.

Objekti i specifik: forcimi i bashkëpunimit në zhvillimin rajonal dhe lokal në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe të zvogëlojnë pabarazitë (të sigurohet kohezioni ekonomik dhe social ndërmjet rajoneve).


- Në vitin 2022 janë ndërmarrë në total 142 iniciativa me interes të përbashkët me bashkitë e tjera ose mesatarisht 2.5 iniciativa për bashki (N=57), duke shënuar një rënie të lehtë në krahasim me vitin 2021 (152 iniciativa). Numrin më të madh të bashkëpunimeve e ka Bashkia Lezhë me 16 dhe Bashkia Lushnjë e Korçë me 12 ndërkohë që 26 Bashki nuk kanë marrë pjesë në asnjë iniciativë.
- Janë raportuar në total 131 pjesëmarrje në iniciativa të përbashkëta rajonale dhe Europiane me synim reduktimin e diferencave rajonale (programet e bashkëpunimit rajonal dhe transnacional, ose mesatarisht 2.43 iniciativa për bashki (N=54). Numrin më të madh e ka Bashkia Lezhë e Gjirokastrë me 20 dhe Bashkia Durrës me 16 iniciativa të përbashkëta. Treguesi ka përmirësim të lehtë nga 113 pjesëmarrje në Iniciativa rajonale të raportuara në vitin 2021 ndërkohë që 27 Bashki nuk kanë marrë pjesë në asnjë iniciativë rajonale apo Europiane.

Grafiku 55: Numri i bashkëpunimeve ndërmjet NJQV, 2022



¹²³ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022)

Grafiku 56: Pjesëmarrje në iniciativa të përbashkëta rajonale dhe Europiane të NJQV, 2022



Kutia 6: Praktika të bashkëpunimit në zhvillimin rajonal dhe lokal

Bashkia Divjakë: Ka realizuar një aktivitet socio-kulturor si Shkolla Verore e Bashkimit Evropian ku është bashkëpunuar me Bashinë e Lushnjës dhe Roskovecit për të zhvilluar aktivitete paralele me tematika të njëjta. Për dy ditë Bashkia Divjakë ka qënë bashki pritëse për të rinjtë e rajonit të Fierit të cilët patën mundësi të rrjetëzohen me njëri-tjetrin për të konsoliduar grupin për vitin pasardhës.

Bashkia Durrës: Ka bashkëpunuar me Bashkinë Tiranë në kuadër të zbatimit të Projektit EUSAIR 4 Youth, të financuar nga programi EUSAIR i Komisionit Evropian, DG Regio. Ky projekt parashi-konte organizimin e një aktiviteti sportiv basketboll 3x3, me pjesëmarrjen e 80 sportistëve nga zona Adriatiko Joniane.

Bashkia Korçë: Ka bashkëpunuar me bashkitë e qarkut të Gjirokastrës dhe Beratit në kuadër të zhvillimit të turizmit. Bashkëpunime ka patur dhe me bashki të tjera në kuadër të projektit "Bashki të Forta" si dhe me bashkinë e Tiranës për përmirësim të performancës dhe zgjerimit të përthithjes së donacioneve.

Bashkia Roskovec: Në kuadër të projektit "Fuqizimi i Zërit të Shoqërisë civile për një Mjedis të pastër në Patos-Marinzë" Bashkia Roskovec dhe Bashkia Patos janë partnere në bashkëpunim.

Rekomandime

- Rritja e bashkëpunimit midis institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor për një zhvillim më të mirë rajonal dhe kohezionin social përmes hartimit dhe zbatimit të planeve zhvillimore rajonale.
- Rritja e aktivizimit dhe ndërgjegjësimit të stafeve të bashkive për rëndësinë e bashkëpunimit rajonal si edhe në nivel Evropian përmes organizimit të fushatave sensibilizuese dhe aktiviteteve të përbashkëta.
- Shtimi i numrit të projekteve dhe financimeve që marrin bashkitë nga BE si edhe donatorë të tjerë për iniciativa ndër-rajonale dhe projekte zhvillimore në nivel qarku/rajoni.
- Forcimi i kapaciteteve të stafeve të bashkive për hartimin e projekteve dhe pjesëmarrjes me aplikime të sukseshme në programet e BE-së rajonale dhe ndërkufitare.

PËRFUNDIME MBI POLITIKAT RAJONALE

Iniciativat ndërmjet Bashkive dhe bashkëpunimet në nivel Rajonal e Europian kanë ardhur në rritje. 55 % e Bashkive kanë patur bashkëpunime apo pjesëmarrje në projekte të përbashkëta rajonale. Megjithatë, kapacitetet e bashkive për përthithjen e financimeve nga fondet e BE-së dhe donatorëve të tjerë me përfitues disa bashki mbeten ende të kufizuara dhe të varura nga partnerët e vendeve të rajonit apo ato europianë.

Hap pozitiv shënoi miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 497 datë 27.07.2022 “Për krijimin, përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin”. **Hapat e mëtejshme të nevojshme janë të hartohet strategjia dhe plani kombëtar për zhvillimin dhe kohezionin rajonal (2021-2027) dhe të plotësohen planet e zhvillimit rajonal (2021-2024).** Këto plane synojnë të nxisin potencialin e zhvillimit përmes ndërhyrjeve të decentralizuara dhe të integruara lokale dhe rajonale. Një tjetër hap i rëndësishëm është sqarimi i përgjegjësive ndërmjet autoriteteve qendrore dhe vendore dhe forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative të organeve qendrore, rajonale dhe vendore, veçanërisht duke siguruar personel adekuat dhe rishikuar strukturën e pagave të qeverisjes vendor, si dhe duke mbajtur decentralizimin fiskal në krye të axhendës¹²⁴.

¹²⁴ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022)

3.8

Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

“Kuatridhejsh ligjor që rregullon **të drejtat e fëmijës** është i vendosur dhe është bërë njëfarë progresi në ngritjen e kapaciteteve institucionale për zbatimin efektiv të tij. Plani kombëtar i de-institucionalizimit u përfshi në programin e reformës ekonomike me një paketë financiare për zhvillimin e shërbimeve alternative të kujdesit për fëmijët dhe mbylljen e institucioneve të kujdesit social. Nevojiten përpjekje shtesë për të zbatuar dhe trajtuar më tej të gjitha shkeljet e të drejtave të fëmijëve”¹²⁵.

Progresi në ushtrimin e funksioneve dhe rolit të NJQV për këtë fushë vlerësohet mbi bazën e 45 treguesve të performancës për gjashtë objektiva specifike.

Objektivi specifik: *forcimi i sistemit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*


Progresi në këtë objektiv sipas treguesve është si më poshtë:

- Në vitin 2022 kanë ngritur Njësine për Mbrojtjen e Fëmijëve 55 Bashki. Njësia rezultoi e pa ngritur ende në gjashtë bashki: Dropull, Kolonjë, Mat, Roskovec dhe Sarandë. Bashkitë Skrapar dhe Poliçan nuk japin informacion për këtë tregues.
- Në vitin 2022 janë raportuar në total **1,417 raste të identifikuar dhe të trajtuara për shkelje të të drejtave të fëmijëve ose mesatarisht 24.43 raste për bashki** (N=58) me një rritje të lehtë nga viti 2021 ku janë raportuar 1,248 raste. Numrin më të madh e raportojnë Bashkia Tiranë me 384 raste, Shkodër me 290 raste dhe Bashkia Durrës me 171 raste.
- **Shkalla mesatare e urdhërave për mbrojtje të lëshuara kundrejt numrit të rasteve të identifikuar është rreth 42%** (N=58). Referuar shërbimeve të posaçme, mesatarisht për 50% të rasteve të identifikuar të fëmijëve, bashkitë kanë mundësuar ofrimin e shërbimeve të veçanta. Treguesi ka ulje nga 2021 ku shërbimet ishin ofruar në 45% të rasteve.
- Në vitin 2022 raporti i rasteve të trajtuara për mbrojtjen e fëmijëve të ofruara nga Bashkia kundrejt numrit gjithsej të rasteve të identifikuar është rreth 50%. Ky numër i trajtimit të rasteve mbetet në të njëjtat nivele me vitin 2021.
- Mesatarisht, 3.9% e buxhetit për mbrojtjen sociale është përdorur nga NJQV për rastet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve (N=55). Treguesi ka ulje nga viti 2021 me 5.2% të buxhetit të alokuar. Gjashtë bashki nuk kanë ofruar të dhëna për treguesin¹²⁶.
- **Në vitin 2022 bashkitë kanë raportuar gjithsej 181 punonjës social për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF), ose mesatarisht 3 punonjës social për bashki** (N=60). Treguesi ka rritje nga viti 2021 ku janë raportuar 132 punonjës. Numrin më të madh të punonjësve social e ka raportuar Bashkia Tiranë me 27 dhe Bashkia Elbasan me 16.
- **Në vitin 2022, janë organizuar në total 625 aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, ose mesatarisht 10.59 aktivitete për Bashki** (N=59). Treguesi ka një rritje të ulët nga viti 2021 me 613 aktivitete. Numrin më të madh të aktiviteteve e ka Bashkia Tiranë me 88 pasuar nga Bashkia Shkodër me 70 dhe Fier me 50 aktivitete të organizuara.

¹²⁵ Raport i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022)

¹²⁶ Çërrik, Polican, Librazhd, Skrapar, Tepelenë, Tiranë

Grafiku 57: Aktivitete të organizuara nga NJQV për promovimin e të drejtave të fëmijëve 2017-2022



Probleme dhe sfida

Problematikat vazhdojnë të jenë si në vitet e kaluara të lidhura me:

- Kapacitetet e pamjaftueshme dhe faktin që njësi për mbrojtjen e fëmijëve ende nuk është funksionale në një pjesë të bashkive. Gjithashtu, burimet financiare mbeten të ulëta në nivel lokal.
- Punojësit socialë në bashki për mbrojtjen e fëmijëve janë në numër shumë të kufizuar dhe në një pjesë të bashkive ende nuk ka asnjë punonjës social.
- Mungesën e një planifikimi buxhetor koherent me nevojat për trajtimin e rasteve të dhunës apo mbrojtjen e fëmijëve në gjithë territorin e Bashkisë.
- Fondin nga buxheti i bashkive për mbrojtjen sociale për rastet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve që mbetet në nivele shumë të ulëta.
- Sistemin e monitorimit të rasteve të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve kur nuk është ende funksional në të gjitha bashkitë.
- Bashkëpunimin jo efektiv me strukturat e arsimit dhe organet e rendit.

Rekomandime

- Ngritja dhe bërja funksional e sistemit duke u lidhur me të gjitha institucionet e shërbimeve shoqërore për referimin e rasteve.
- Rritja e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor në lidhje me procedurat e mbrojtjes së fëmijëve, identifikimin e rasteve dhe bashkëpunimin ndër-institucional.
- Përmirësimi i kapaciteteve të Grupeve Teknike Ndërmministrorë për menaxhimin e rasteve të Fëmijëve në Nevojë dhe për Mbrojtje.
- Sigurimi i aksesit në shërbime të fëmijëve nga zonat rurale të largëta si dhe fëmijët në situatë rruge, përmes bashkërendimit të veprimeve dhe shkëmbimin e informacionit midis strukturave përgjegjëse për trajtimin e rasteve.

Objektivi specifik: zbatimi efektiv i ligjit 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"

- Në vitin 2022 janë trajnuar 294 nëpunës civilë të administratës lokale mbi ligjin e mbrojtjes nga diskriminimi ose mesatarisht 5.16 nëpunës për bashki (N=57). Treguesi ka shënuar rritje nga viti 2021, ku janë trajnuar 221 nëpunës në total ose mesatarisht 3.81 persona. Numrin më të madh të nëpunësve të trajnuar e ka bashkia Bulqizë me 73, Elbasan me 34 dhe Pukë me 32.¹²⁷
- Në vitin 2022 sistemi i monitorimit të rasteve të identifikuara të diskriminimit është ngritur në 21 Bashki, duke mbetur në të njëjtin nivel me vitin 2021. Sistemi i monitorimit të rasteve është një instrument për trajtimin efektiv të rasteve nga nëpunësit vendorë, në bashkërendim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Në vitin 2022 janë raportuar në total 87 aktivitete të Bashkive të ndërmarrë në kuadër të bashkëpunimit me Komisionerin për mbrojtjen nga diskriminimi ose mesatarisht 1.71 aktivitete për bashki (N=51). Vetëm 21 bashki kanë dhënë informacion mbi nivelin e bashkëpunimit me Komisionerin, ku numrin më të madh e ka raportuar Bashkia Krujë me 25 aktivitete.
- Në vitin 2022 janë ndërmarrë në total 53 fushata ndërgjegjësuese në shkolla dhe komunitete për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI ose mesatarisht 1 fushatë për bashki (N=53). Numrin më të madh të fushatave e ka Bashkia Lushnjë me 10 aktivitete dhe Bashkia Tiranë me 9.

Objektivi specifik: zbatimi efektiv i ligjit 96/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e pakicave etnike"

Progresi nga NJQV në këtë objektiv sipas treguesve është si më poshtë:

- Në vitin 2022 sistemi i monitorimit për shkelje të të drejtave të pakicave është ngritur dhe është funksional në vetëm 20 Bashki. Treguesi mbetet në të njëjtin nivel që nga viti 2021.
- Në 2022 janë organizuar 234 aktivitete kulturore dhe fushata ndërgjegjësimi për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Minoriteteve Etnike, ose mesatarisht 4.25 aktivitete për bashki (N=585). Numri i aktiviteteve është i njëjtë me vitin 2021¹²⁸. Numrin më të madh të aktiviteteve e ka Bashkia Lezhë me 30, Shkodër me 23 dhe Bashkia Devoll me 21.
- Numri i nëpunësve lokalë të trajnuar për zbatimin e Planit Kombëtar për Romët dhe Egjiptianët në vitin 2022 është në total 108 punonjës ose mesatarisht 1.83 nëpunës për bashki (N=59). Treguesi ka shënuar rritje krahasuar me vitin 2021 ku kanë ndjekur trajnime në total 65 punonjës. Numrin më të madh të nëpunësve të trajnuar e kanë Bashkia Elbasan me 34 dhe Bashkia Maliq me 22 nëpunës.


Objektivi specifik: Përmirësimi i koordinimit të punës ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e minoriteteve Rome dhe Egjiptiane.

- Në vitin 2022 vetëm 27 Bashki kanë raportuar për trajnimin e nëpunësit civil të administratës lokale për angazhimet e Bashkisë për Planin Kombëtar për Romët dhe Egjiptianët. Treguesi ka ulje nga viti 2021 ku kanë qënë 32 bashki që kanë raportuar për nëpunës të trajnuar. Bashkitë Shijak, Poliçan dhe Librazhd nuk kanë dhënë informacion për treguesin.
- 37% e bashkive (23 Bashki) kanë raportuar se plani i veprimit për integrimin e pakicave Rome dhe Egjiptiane në nivel vendor është hartuar dhe miratuar nga Këshilli Bashkiak në vitin 2022. Treguesi ka rritje vetëm më një bashki nga viti 2021. Bashkitë Skrapar dhe Poliçan nuk japin informacion për këtë tregues.
- 37% e bashkive (23 Bashki) kanë raportuar se plani i veprimit për integrimin e pakicave Rome dhe Egjiptiane në nivel vendor, është hartuar dhe miratuar nga Këshilli Bashkiak në vitin 2022. Treguesi ka rritje vetëm më një bashki nga viti 2021. Bashkitë Skrapar dhe Poliçan nuk japin informacion për këtë tregues.


¹²⁷ Bashkitë Cërrik, Librazhd, Poliçan, Skrapar nuk kanë dhënë informacion

¹²⁸ Bashkitë Cërrik, Vlorë, Shijak, Poliçan, Bulqizë nuk kanë dhënë informacion

Harta 11: PV për Integrimin e pakicave, 2022




Grafiku 58: Plani lokal i veprimit për përfshirjen e R&E 2017-2022



Në vitin 2022, trajnimet për grumbullimin e të dhënave dhe raportimin në kuadër të sistemit ROMALB janë ndjekur nga 42 nëpunës (N=59), ose mesatarisht më pak se një trajnim për bashki. Treguesi është në të njëjtat nivele me vitin 2021. Numrin më të madh të nëpunësve të trajnuar e ka Bashkia Krujë me 7 dhe Shijak me 4, Bulqizë e Peqin me nga 3.

- 29 Bashki kanë raportuar për shfrytëzim të rregullt të sistemit ROMALB për statistika dhe analiza, si dhe raportim për vendimmarrjen e Bashkisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Treguesi ka ulje nga viti 2021 me 32 bashki që shfrytëzojnë sistemin ROMALB.
- Në vitin 2022 rreth 11% janë përfitues R&E nga programet e strehimit social në bashki në raport me numrin gjithsej të aplikimeve për vitin e raportimit. Treguesi mbetet në të njëjtin nivel me vitin 2021. Janë zbatuar 33 projekte, në mbështetje të pakicave rome dhe egjiptiane ose mesatarisht 0.58 projekte për bashki (N=57). Treguesi ka ulje të ndjeshme me vitin 2021 me 72 projekte. Numrin më të madh e kanë Bashkia Shkodër, Gjirokastrë dhe Elbasan me nga 3 projekte.
- Numri i të punësuarve të pakicave rome dhe egjiptiane në vitin 2022 është në total 417 ose mesatarisht 8.34 për bashki (N=50). Treguesi ka ulje nga viti 2021 ku kanë qënë 661, ose mesatarisht 12.47 për bashki. Numrin më të madh të punësuarve R&E, e ka Bashkia Berat me 121, pasuar nga Bashkia Kavajë me 32.

Grafiku 59: Numri i të punësuarve R&E në institucionet e Bashkisë gjatë vitit 2022



Probleme dhe sfida

- Sistemi i monitorimit për shkelje të të drejtave të pakicave nuk është ngritur ende në një numër të konsiderueshëm të bashkive.
- Burimet financiare të pamjaftueshme për mbështetjen me programe të veçanta, me projekte dhe strehim si dhe për organizimin e aktiviteteve të drejtpërdrejta për pakicat R&E.
- Programet e strehimit social në bashki në raport me numrin gjithsej të aplikimeve janë të kufizuara.
- Mungesa e organizatave të shoqërisë civile të specializuara që ofrojnë shërbime për qytetarët në luftën kundër diskriminimit dhe njohjen e të drejtave të minoriteteve.
- Bashkëpunimi dhe ndihma e pamjaftueshme nga institucionet nderkombëtare dhe Organizata të specializuara për mbrojtjen e të drejtave të pakicave.

Rekomandime


- Ngritja e sistemit të monitorimit për shkeljen e të drejtave të pakicave si dhe përdorimi i sistemit ROMALB nga të gjitha bashkitë.
- Mbështetja me trajnime për stafet e bashkive që trajtojnë çështjet e pakicave etnike R&E.
- Shtimi i burimeve njerëzore pranë shërbimit social të bashkive për çështjet e pakicave rome dhe egjiptiane, për të vlerësuar situatën, monitorimin në terren dhe ndjekjen e problematikave.
- Miratimi i planeve vendore për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane nga bashkitë që ende se kanë realizuar, si dhe përfshirjen në PBA të fondeve për zbatimin e tyre.
- Bashkëpunimi më i mirë me OJF e licensuara për ofrimin e shërbimeve të specializuara në mbrojtje të fëmijëve.

Objektivi specifik: *Forcimi i sistemit për sigurimin e barazisë gjinore*

Progresi nga NJQV në këtë objektivi sipas treguesve është si më poshtë:

- Në 2022, numri i trajnimeve të nëpunësve civil të administratës lokale me ekspertë të barazisë gjinore është raportuar në total 231 ose mesatarisht 4 trajnime për bashki (N=57). Numri i trajnimeve është ulur krahasuar me vitin 2021 ku janë raportuar 272 trajnime.
- Numri i shërbimeve të specializuara të ofruara nga Bashkitë për gratë viktime të dhunës në familje/strehëza, të ndara sipas njësive administrative janë raportuar në total 572 ose mesatarisht 10.59 trajnime për bashki (N=54). Numri i shërbimeve është rritur krahasuar me vitin 2021 ku janë ofruar gjithsej 380. Numrin më të madh të shërbimeve ose 44% të totalit e ka Bashkia Kamëz me 252, Gjirokastrë me 70 dhe Kavajë me 69 shërbime. 16 Bashki nuk ofrojnë asnjë shërbim ndërkohë që shtatë nuk japin informacion.


Grafiku 60: Shërbime të specializuara të ofruar nga NJQV për viktimat e dhunës në familje, viti 2022



Në vitin 2022 janë bërë në total 1,677 raportime për rastet e dhunës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përmes sistemit REV-ALB, ose mesatarisht 34.94 raste për bashki (N=48). Treguesi shënon ulje nga 2,092 raportime të bëra në vitin 2021. Numrin më të madh të raportimeve e ka Bashkia Tiranë me 283 dhe Bashkia Durrës me 264.

- Hartimi i buxhetimit gjinor të Bashkisë është detyrim ligjor. Në vitin 2022 vetëm 34% e Bashkive (21 Bashki), kanë raportuar hartimin e buxhetit me ndjeshmëri gjinore me një rritje prej 5 Bashki krahasuar me vitin 2021. Vihet re një mungesë e theksuar planifikimi ku 19 Bashki kanë raportuar që nuk e kanë kryer buxhetimin gjinor dhe 21 nuk kanë dhënë asnjë informacion.
- Në kuadër të bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe projektet e donatorëve janë realizuar në total 252 aktivitete kundër diskriminimit gjinor, ose mesatarisht 4.34 aktivitete për bashki (N=58). Treguesi mbetet në të njëjtat nivele me vitin 2021. Numrin më të madh të aktiviteteve e kanë Bashkitë Shkodër (47), Krujë (31) dhe Kavajë (20).


Grafiku 61: Aktivitete të Bashkive dhe OSHC për diskriminimin gjinor, 2022



- Në vitin 2022, janë raportuar gjithsej 1,032 shërbime për menaxhimin e rastit ose mesatarisht 19.47 për bashki (N=53). Treguesi ka rritje me 45% krahasuar me vitin 2021 me 568 shërbime. Bashkia Kamëz raporton numrin më të madh me 600 shërbime pasuar nga Kavajë me 130.
- Në vitin 2022 janë raportuar 742 kopshte dhe çerdhe që kanë marrë shërbime për mirëmbajtje dhe rindërtimi nga bashkitë (N=57), ose mesatarisht 13 për bashki. Treguesi ka rritje nga viti 2021 me një total prej 537 kopshte dhe çerdhe.

- 7.2 % e buxhetit të bashkive (N=55) është alokuar në vitin 2022 për çështje të mbrojtjes së viktimave nga dhuna në familje. 23% e bashkive raportuese kanë akorduar 0 % buxhet për çështje të mbrojtjes së dhunës në familje, ndërkohë që 6 bashki nuk japin asnjë të dhënë. Fondi ka rritje të lehtë nga viti 2021, ku është alokuar 6.95% % e buxhetit.
- Janë ndërmarrë në total **382 aktivitete për promovimin e barazisë gjinore** dhe në zbatim të Kartës Evropiane për barazinë e personave M/F në jetën vendore, ose mesatarisht 6.7 aktivitete për Bashki (N=57). Treguesi shënon rritje nga viti 2021 me 352 aktivitete. Numrin më të madh të aktiviteteve e raporton Bashkia Tiranë me 66, Shkodër me 47 dhe Elbasan me 30.

Grafiku 62: Aktivitete promovimi për barazinë gjinore 2017-2022



Probleme dhe sfida

- Buxheti i bashkive i alokuar për çështje të mbrojtjes së viktimave nga dhuna në familje vazhdon të jetë në nivele tejet të ulëta.
- Sistemi REV-ALB nuk përdoret nga të gjitha bashkitë dhe mungesa e raportimit të rregullt në MSHMS.
- Kapacitetet e ulëta të nëpunësve vendorë dhe personelit të qendrave komunitare për përballimin e shërbimeve dhe menaxhimin e të gjithë rasteve.
- Mungesë koordinimi ndër-institucional dhe funksionimi jo efektiv e mekanizmave në nivel vendor në kuadër të harmonizimit të masave për të luftuar dhunën në familje.


Rekomandime

- Të ofrohen shërbime të specializuara dhe ri-integruese për viktimat dhe, duhet të forcohet më tej puna në menaxhimin e rasteve.
- Të rritet asistencë teknike dhe financiare ndaj bashkive në drejtim të caktimit të buxhetit të dedikuar për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe e bashkive që kanë hartuar PBA me ndjeshmëri gjinore.
- Të përmirësohet ndërveprimi ndërmjet bashkive dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Të rritet numri i fushatave ndërgjegjësuese për mbrojtjen nga çdo formë diskriminimi, për çështje të barazisë gjinore, për mbrojtjen e komuniteteve romë dhe egjiptiane, si dhe për njohjen e të drejtave të minoriteteve dhe të drejtave të njeriut.

Objekti i specifik: Zbatimi efektiv i ligjit 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesin e personave me aftësi të kufizuara"

- Në vitin 2022 janë realizuar në total 158 aktivitete ndërgjegjësimi dhe trajnime mbi standartet e aksesueshmërisë nga personat me aftësi të kufizuara (PAK), ose mesatarisht 3 aktivitete për bashki (N=52). Numri është pothuaj në të njëjtin nivel me vitin 2021. Nga bashkitë raportuese 26% e tyre (16 Bashki) nuk kanë ndërmarrë asnjë aktivitet ndërgjegjësimi. Numrin më të madh të aktiviteteve dhe trajnimeve e ka Bashkia Elbasan me 18, Tiranë, Maliq dhe Lushnjë me nga 10.


Grafiku 63: Aktivitete mbi standartet e aksesueshmërisë nga personat me aftësi të kufizuara (PAK), 2022




Në 2022, është raportuar ngritja e Njesisë për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit në 24 Bashki nga 20 Bashki në vitin 2021. Përgatitja e Planit Lokal të Veprimit për Përfshirjen Sociale të PAK është realizuar nga 50 % e bashkive (31 Bashki) duke mbetur në të njëjtin nivel me 2021.

- Në 2022, është raportuar 6.94% rritja e fondit të buxhetit lokal për heqjen e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore të PAK. Treguesi ka ardhur në ulje nga viti 2021 ku është raportuar në 8.24 %.
- Mesatarisht **36.37% e shkollave të sistemit para-universitar kanë infrastrukturë të aksesueshme** nga personat me aftësi ndryshe (N=59), duke u rritur me 3,27 p.p. në krahasim me vitin 2021. Bashkitë Gjirokastër, Kamëz, Roskovec, Rrogozhinë raportojnë 100% infrastrukturë të aksesueshme nga PAK, ndërkohë që Bashkitë Poliçan e Shijak nuk japin asnjë informacion.


Grafiku 64: Numri i shkollave të aksesueshme për fëmijët me aftësi ndryshe, 2022



Grafiku 65: Shkalla e aksesueshmërisë së infrastrukturës shkollore nga fëmijë me aftësi ndryshe 2017-2022




Grafiku 66: Shkalla e institucioneve publike të aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe, viti 2022



- Në 2022, vlera mesatare e raportit të institucioneve publike të aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe, kundrejt numrit gjithsej të institucioneve në nivel vendor ka qenë 39.49 % (N=56); treguesi është rritur me 2.59 p.p. krahasuar me vitin 2021. Bashkitë Kamëz dhe Roskovec kanë raportuar 100% infrastrukturë të institucioneve publike të aksesueshme nga PAK.
- Në 2022 janë raportuar 278 nëpunës vendorë të punësuar në strukturat e përkrahjes dhe mbrojtjes sociale për PAK, ose mesatarisht 4.71 nëpunës për bashki (N=59), me një rritje të lehtë krahasuar me 264 nëpunës në 2021. Numrin më të madh të nëpunësve e ka Bashkia Vlorë me 24. Bashkitë Fushë-Arrëz, Këlcyrë, Peqin, Sarandë dhe Skrapar nuk kanë asnjë punonjës për PAK ndërkohë që Bashkia Poliçan nuk ka ofruar të dhëna për treguesin.
- Rreth 31.4 % është mesatarja e infrastrukturës rrugore e aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe në raport me gjatësinë e rrjetit urban në territorin e bashkisë (N=53). Treguesi shënon rritje me 4.7 p.p. krahasuar me 2021 ku është raportuar 26.27 %. Bashkitë Rrogozhinë, Peqin dhe Roskovec raportojnë se 100% e rrugëve urbane janë të aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe. Ndërkohë që 20% e bashkive raportojnë 0% infrastrukturë rrugore të aksesueshme.

Grafiku 67 : Shkalla e rrjetit urban e aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe, 2022



Në 2022 numri i qendrave historike dhe kulturore në territorin e Bashkisë të pajisura me infrastrukturën e duhur për personat me aftësi ndryshe është raportuar në total 123 nga 86 në 2021. Rreth 38% e bashkive (23 bashki) kanë raportuar se nuk kanë infrastrukturën e duhur dhe 5 bashki¹²⁹ nuk kanë dhënë asnjë informacion.

Probleme dhe sfida

- Infrastruktura bazë për të siguruar aksesin e personave me aftësi të kufizuar mbetet në nivele jo të mira. Gjithashtu, pamjaftueshmëria e buxheteve për investime serioze dhe të qëndrueshme në bashki, është e evidente.
- E dukshme është mungesa e të dhënave të përditësuara dhe analizave të thelluara mbi gjëndjen dhe nevojat e personave me aftësi ndryshe në nivel bashkie dhe qarqesh.
- Shkalla e aksesueshmërisë në shkolla, institucione publike dhe shërbime të ndryshme, si edhe në objektet kulturore është ende e limituar në një numër të madh të bashkive.
- Janë të pakëta mundësitë për punësim në përputhje me nevojat dhe aftësitë për punë të PAK, me qëllim rritjen e integritit të tyre në shoqëri.
- I ulët është numri i shërbimeve dhe punonjësve të dedikuar për personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të marrin shërbimin e duhur në kohë dhe me cilësi.

¹²⁹ Skrapar, Poliçan, Maliq, Këlcyrë, Elbasan

Rekomandime

- Bashkëpunimi më i mirë midis aktorëve të ndryshëm në nivel lokal dhe qendror, si dhe monitorimi periodik i shërbimeve të kujdesit shoqëror që ofrohen për kategoritë në nevojë dhe PAK.
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe krijimi i kushteve për lehtësimin e aksesit të Personave me Aftësi të Kufizuara në institucione, qendrat kulturore dhe shërbime të tjera në territorin e bashkisë.
- Forcimi i bashkëpunimit me strukturat e arsimit, formimit profesional, punësimit si dhe me shërbimet shëndetësore, psiko-sociale, integruese, rehabilituese, etj. për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara.
- Shkëmbimi më i mirë i informacionit lidhur me vlerësimin, monitorimin dhe shkallën e cilësisë së ofruesve të shërbimeve për kategoritë e ndryshme të përfituesve.

PËRFUNDIME MBI GJYQËSORIN DHE TË DREJTAT THEMELORE

Edhe në vitin 2022 kanë vazhduar përpjekjet e bashkive për të zbatuar detyrimet ligjore dhe rritur kapacitetet e tyre në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore. Progres është shënuar në rritjen e numrit të punonjësve socialë për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF), si dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe projektet e donatorëve, në mbrojtje të të drejtave të pakicave. Sistemi i monitorimit për shkeljen e të drejtave funksionon në vetëm 33% të Bashkive.

Sfidë mbeten kapacitetet njërzore të pamjaftueshme për të menaxhuar rastet e shkeljes së të drejtave, si dhe burimet financiare shumë të limituara. Megjithëse treguesi ka pësuar rritje nga vitet e kaluara, ai sërish mbetet në nivele të ulëta në krahasim me nevojat e bashkive për të trajtuar të gjitha rastet. *Ka ende mungesë të theksuar planifikimi i buxhetit me ndjeshmëri gjinore në një numër të konsiderueshëm të bashkive.*

Nevojiten përpjekje më të fuqishme për të trajtuar diskriminimin dhe dhunën ndaj personave me aftësi të kufizuara, për të përmirësuar aksesin e përgjithshëm, për të promovuar punësimin dhe për të mbledhur të dhëna statistikore për situatën e tyre. Cilësia e arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht fëmijët me dëmtim të dëgjimit, vazhdon të jetë shqetësim. Mbetet një numër i pamjaftueshëm i asistentëve për fëmijët me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor parauniversitar. Nevojiten përpjekje shtesë për të ofruar trajnime mbi qasjet e arsimit gjithëpërfshirës për të gjithë mësuesit dhe zbulimi i hershëm i aftësisë së kufizuar.


3.9 Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria

Objektivi specifik: Avancimi i luftës kundër krimit të organizuar


Në vitin 2022 grupi i punës për zbatimin e Planit të Veprimit për luftën kundër krimit të organizuar në nivel vendor, është krijuar në 28 bashki. Treguesi nuk ka rritje krahasuar me vitin 2021. Nuk konstatohet progres lidhur me hartimin e Strategjisë për Sigurinë Publike në nivel vendor, vetëm në 36 bashki.

Progres është bërë nga bashkitë për ngritjen e Këshillit të Sigurisë Vendore gjatë 2022, si një mekanizëm në luftën kundër krimit të organizuar tashmë i ngritur në rreth 77% të Bashkive (47 Bashki). Treguesi ka rritje me vetëm 1 Bashki krahasuar me 2021.

Harta 12: Këshilli i Sigurisë Vendore kundër krimit të organizuar 2022



Grafiku 68: Ngritja e Këshillave të Sigurisë Vendore 2017-2022



- **Në vitin 2022 ngritja e Zyrës së Policimit në komunitet**, në secilën njësi administrative raportohet me një mesatare prej 52.3 % (N=50). Treguesi shënon rritje prej 11.7 p.p. *Ndërkohë janë 11 Bashki që nuk kanë ofruar informacion për këtë tregues.*
- **Numri i rasteve të referuara pranë Zyrës së Policimit në komunitet nga qytetarët**, në total në vitin 2022 kanë qënë 2,348 raste, ose mesatarisht 52.18 raste për bashki (N=45). Numrin më të madh të rasteve të referuara e ka Bashkia Maliq me 350 dhe Lushnjë me 300 raste.

Probleme dhe sfida

- Problematikë mbetet mos-ngritja e grupit të punës në luftën kundër krimit të organizuar në të gjitha bashkitë dhe bashkëpunimi jo efektiv me strukturat e Policisë së Shtetit.
- Mungesa e Strategjive të Sigurisë Publike për një pjesë të bashkive ka krijuar sfida në menaxhimin e situatës dhe reagimit të koordinuar.
- Mos-funksionimi i plotë i Këshillave të Sigurisë Vendore është evident në të gjitha bashkitë e vendit.
- Sfidë është ngritja e zyrës së policimit në komunitet dhe kryesisht në Njësitë Administrative dhe në zonat rurale.

- Ndërgjegjësimi i qytetarëve për të referuar çdo rast është në nivele të ulëta dhe bashkëpunimi ndërinstytucional është jo efektiv.
- Shkëmbimi i informacionit dhe përditësimi i të dhënave adekuate dhe të sakta për numrin e rasteve mbetet problematikë.
- Numri i ulët i shërbimeve dhe punonjësve të dedikuar për personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të marrin shërbimin e duhur në kohë dhe me cilësi.

Rekomandime

- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional në nivel qendror me ministrinë e linjës dhe në nivel lokal nëpërmjet KVSP-ve për vlerësimin e riskut dhe dëmit dhe marrja e masave parandaluese në lidhje me çështje të sigurisë.
- Funkcionimi i plotë i shërbimit të policimit në komunitet. Forcimi i bashkëpunimit për menaxhimin e rasteve me të gjithë partnerët e përfshirë në proces.
- Ngritja e Zyrës së Policimit në komunitet në të gjitha bashkitë dhe në secilën njësi administrative.

Hartimi dhe miratimi i Strategjive të Sigurisë Publike vendore dhe Ngritja e Këshillave të Sigurisë Publike nga të gjitha bashkitë.

PËRFUNDIME MBI DREJTËSINË LIRINË DHE SIGURINË

Në vitin 2022 kanë vijuar përpjekjet e Bashkive për zbatimin e masave të parashikuara në Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, si dhe Planin e Vepërimit 2021-2022, miratuar në vitin 2021. Në përputhje me funksionet e qeverisjes vendore të lidhura me çështjet e drejtësisë dhe sigurisë **progres është bërë nga bashkitë në ngritjen e Këshillit të Sigurisë Vendore, si një mekanizëm në luftën kundër krimit të organizuar, por nuk ka vijuar me të njëjtat ritme hartimi i Strategjisë për Sigurinë Publike në nivel vendor. Gjithashtu **ngritja e Zyrës së Policimit në komunitet** në secilën njësi administrative nuk ka bërë progres domethënës.**

Prioritet mbetet krijimi i besueshmërisë dhe rritja e sigurisë së komunitetit përmes policimit në komunitet. Policia e Shtetit në raportin e monitorimit të vitit 2022 të Ministrisë së Brendshme thekson se në punën e saj do të rrisë masat për identifikimin e zonave me risk të lartë dhe prioritare, si dhe ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të policimit në komunitet dhe mekanizmave të referimit të problematikës. Bashkëpunimi me komunitetin, strukturat vendore dhe realizimi i fushatave ndërgjegjësuere të policisë në zonat me rrezik të lartë mbeten prioritare për të promovuar policimin në komunitet dhe rolet e tyre për komunitetin.

3.10 Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura

“Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e arsimit dhe kulturës. Duhet të alokohen burimet financiare të duhura, për të siguruar zbatimin e reformave dhe politikave të reja.¹³⁰”

Gjatë vitit 2022 në Këshillin Konsultativ të Qeverisë qendrore me atë vendore është diskutuar projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimore që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”. Ky vendim synon krijimin e kushteve më të mira të nxënësve dhe mësuesve të sistemit arsimor parauniversitar publik, që punojnë jashtë vendbanimit dhe të nxënësve, që mësojnë jashtëvendbanimit, duke vënë në përdorim fondet publike për sigurimin e transportit të tyre.

Objektivi specifik: Rritja e pjesëmarrjes në klasa përgatitore për arsimin parashkollor


Në vitin 2022, kanë funksionuar 1674 kopshte në total, ose mesatarisht 28.37 kopshte (N=59). Numrin më të madh e kanë bashkia Tiranë me 131 Kopshte, Dibër me 85 kopshte, Lushnjë me 75, dhe Fier me 73 kopshte. Bashkia Poliçan dhe Malësi e Madhe nuk kanë raportuar për treguesin.

- Në 2022 raportohet se 15.17% e kopshteve janë me numër fëmijësh nën kapacitetet e lejuara sipas raportimeve të Bashkive (N=55). Në vitin 2021, treguesi ka qënë në nivelin 27.37 %. Bashkia Divjakë ka numrin më të madh të kopshteve nën kapacitet me 93%.

Raportet mesatare në nivel kombëtar në vitin 2022 raportohen të jenë:

- Raporti mesatar fëmijë/edukatorë në zonën urbane është 15.78 (N=59)
- Raporti mesatar nxënës/mësues në zonat urbane është 15.1 (N=57)
- Raporti mesatar nxënës/mësues në qytet-qendër e bashkisë është 18.02 (N=58)
- Raporti mesatar i nxënësve/klasë në zonën urbane është 23.48 (N=57)

Grafiku 69: Numri i kopshteve sipas NJQV, 2022



¹³⁰ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022)

- Në vitin 2022 raportohet se bashkitë kanë ndërmarrë **236 fushata ndërgjegjësimi ndaj prindërve** për përfshirjen e fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor ose mesatarisht 4.14 për bashki (N=57). Numrin më të madh e ka Bashkia Elbasan me 34 fushata, Dimal dhe Gjirokastër me 20 fushata. Treguesi ka rritje me gati 36% nga viti 2021 ku janë ndërmarrë 151 fushata.
- Në 2022 **fondi i alokuar nga buxheti vendor për rindërtimin e kopshteve** ekzistuese ose ndërtimin e kopshteve të reja është 2.53 % (N=56) me një rritje fare të lehtë nga viti 2021. Rreth 48% e bashkive (29 bashki) kanë raportuar zero përqind fond të alokuar në buxhetin e tyre ndërkohë që 5 bashki nuk japin asnjë informacion¹³¹.
- Në 2022, **numri i fëmijëve në Bashki të grup moshës të arsimit bazë** (të detyrueshme) që i përkasin grupeve të marxhinalizuara është raportuar në total 11,341 ose mesatarisht 257.75 fëmijë për Bashki (N=44). Numri ka ulje me 37% krahasuar me vitin 2021 ku raportuar 15,610 fëmijë të grupeve të marxhinalizuara në bashki. Numrin më të madh e ka Bashkia Tiranë me 1,982, Bashkia Elbasan me 1,943 fëmijë dhe Kucovë me 1,749 fëmijë.

Objektivi specifik: rritja e pjesëmarrjes në institucionet e arsimit të detyrueshëm për fëmijët e grupeve të marxhinalizuara.

- **Parashikimi i infrastrukturës PAK** në projektet për rindërtimin/ndërtimin e shkollave në bashki në vitin 2022 është bërë nga 50 Bashki ose 82%. Treguesi ka rritje me 4 p.p. nga viti 2021. Janë 6 bashki: Tepelenë, Shijak, Pustec, Peqin, Mirditë, Himarë që nuk kanë parashikuar infrastrukturën për PAK dhe 5 bashki që nuk raportojnë asnjë të dhënë¹³².
- Mesatarisht është alokuar 2.54 % e **fondit të investimit vendor për ndërtimin e shkollave të reja dhe rikonstruksionin e shkollave** ekzistuese në raport me buxhetin vendor të miratuar në vitin 2022. Treguesi shënon ulje nga viti 2021 me 3.11%, nga 2020 me 5.64% dhe 2019 ku fondi i parashikuar për rindërtimin e shkollave ekzistuese ose ndërtimin e shkollave të reja ka qënë mesatarisht 7.55%.

Objektivi specifik: Përmirësimi i procesit të vendimmarrjes në shkollat e arsimit parauniversitar

Vlerësohet se 97% e bashkive kanë përfaqësimin e nëpunësit të bashkisë në bordin e shkollës në vitin 2022 duke pësuar rritje nga viti 2021 me 90%. Vetëm Bashkia Peqin raporton që nuk e ka përfaqësuesin e bashkisë në bordin e shkollës, ndërsa Bashkia Poliçan nuk raporton për treguesin.

Probleme dhe sfida

- Vazhdon të mbetet sfidë buxheti i ulët i bashkive për ndërtimin dhe rikonstruksionin e ndërtesave të kopshteve dhe shkollat e arsimit parauniversitar.
- Mbipopullimi i kopshteve është problematikë në disa bashki, si dhe nga pamundësia për ti plotësuar nevojat e të gjithë komunitetit për regjistrimin e fëmijëve.
- Vështirësia për të rregjistruar në arsimin parashkollor, çfaqet veçanërisht tek fëmijët të komunitetit Rom dhe Egjyptian, si një prioritet për integrimin e këtyre komuniteteve në arsim.
- Mungesa e infrastrukturës për sigurimin e aksesit të Personave me Aftësi të Kufizuar duket qartë në disa institucione arsimore.
- Sfidë mbetet parashikimi në buxhet dhe aplikimi në thirrjet për projekte të financuara nga BE dhe donatorë të tjerë apo gjetja e burimeve alternative të financimit për bashkë-financime për projektet e shkollave.

¹³¹ Skrapar, Polican, Memaliaj, Mallakastër, Librazhd nuk raportojnë për këtë tregues

¹³² Bulqizë, Dimal, Elbasan, Librazhd, Poliçan nuk raportojnë për këtë tregues

Rekomandime

- Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave, duke planifikuar dhe akorduar më shumë buxhet për këtë qëllim.
- Bashkitë duhet të ndërmarrin nisma dhe mekanizma vendorë për të ndërtuar kanale komunikimi ndërmjet prindërve, mësuesve dhe bashkisë, në mënyrë që të rriten njohuritë dhe vetëdijësimi për arsimin, si dhe ngritja e zërit për shqetësime të ndryshme.
- Rritja e kapaciteteve të administratës vendore për monitorimin dhe raportimin vjetor mbi përgjegjësitë dhe detyrat e NJQV në mirëadministrimin e kopshteve dhe shkollave si dhe bërja publike e raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të bashkisë.
- Krijimi i lehtësirave dhe mekanizmave për sigurimin e infratsruktuës së duhur në shkolla për fëmijët PAK si dhe grupeve të tjera të marginalizuara.

Objektivi specifik: *Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo-materiale, thesari kombëtar i gjenerimit të popullit shqiptar*

- Në vitin 2022, **rastet e shkeljeve dhe ndërtimeve të paligjshme** në zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore janë raportuar në total 17 nga 12 të raportuara në vitin 2021. *Numrin më të madh e raporton Bashkia Bulqizë dhe Gjirokastër me nga 4 shkelje dhe Selenicë me 3.*
- Në vitin 2022, janë ndërmarrë gjithsej 109 masa kundër shkeljeve dhe masa të tjera për ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore (nga 855 masa në 2021). *Numrin më të madh të masave e raporton Bashkia Lushnjë me 60 masa dhe Kuçovë me 11 masa, si dhe Bashkia Sarandë me 11 masa.*

Objektivi specifik: *Mbështetja e krijimtarisë dhe veprimtarisë krijuese të artistëve shqiptarë, përmes forcimit të veprimtarisë kulturore dhe përfshirjes së artistëve*

- **Numri i aktiviteteve kulturore të organizuara** është 1,643 ose mesatarisht 27.38 aktivitete për bashki (N=60). Numri vjen në rritje krahasuar me vitin 2021 ku u organizuan 770 aktivitete kulturore. *Numrin më të madh të aktiviteteve e ka Bashkia Tiranë me 550 dhe Bashkia Durrës me 108.*
- **Fondi vendor i miratuar për aktivitete kulturore** të bashkisë në raport me buxhetin për trashëgiminë kulturore në vitin 2021 është raportuar 8.18% (N=53). *Buxheti për aktivitete kulturore ka ardhur në rritje nga viti 2021 me 7.64 % dhe 2020, ku është raportuar 5.56%.*

Probleme dhe sfida

- Burime financiare të ulëta për të promovuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar trashëgiminë kulturore, promovimin dhe organizimin e festivaleve të përvitshme, si dhe ruajtja e muzikës folklorike.
- Rritja e bashkëpunimit me institucione të tjera publike dhe private, sipërmarrës si dhe me artistë të rinj, për të ndikuar në ide të reja rreth zhvillimit të aktiviteteve kulturore për promovimin e zonës.
- Rritje e bashkëpunimit me Ministrinë e Kulturës dhe institucionet e tjera qendrore për të ruajtur e trashëguar traditat kulturore si këngët folklorike dhe veshjet e punimet artizanale të krahinave.
- Bashkëpunim më i mirë me komunitetin për përmirësim të kushteve të jetesës dhe kërkesës për ruajtjen e autenticitetit të trashëgimisë së tij kulturore.

Rekomandime

- Forcimi i bashkëveprimit dhe koordinimit midis administratës vendore dhe strukturave të policisë së shtetit për të parandaluar shkeljet e paligjshme dhe dëmtimin e trashëgimisë kulturore.
- Hartimi i planeve të menaxhimit të pasurive kulturore përmes evidentimi të detajuar të llojit dhe rëndësisë së objektit me vlera të trashëgimisë kulturore.
- Ndërmarrja e veprimeve dhe politikave nga NJQV-të për të konsideruar kulturën si nxitës për zhvillimin e turizmit.
- Aplikimi i skemave financiare mbështetëse që të mundësojnë ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore që janë në pronësi të qytetarëve.
- Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe financiare për zhvillimin e aktiviteteve kulturore nga bashkia për promovimin e kulturës së zonës dhe kulturës kombëtare.

PËRFUNDIME PËR ARSIMIN DHE KULTURËN

Megjithë progresin e bërë në nivel qendror me miratimin e Strategjive sektoriale dhe Legjislacionit përkatës sërish bashkitë hasin vështirësi në zbatimin e politikave. **Edhe në vitin 2022 vihet re mungesa e buxheteve të bashkive për të investuar në infrastrukturën e kopshteve dhe shkollave.** Fondi i alokuar nga buxheti vendor për rindërtimin e kopshteve ekzistuese ose ndërtimin e kopshteve të reja është në nivele të ulta. **Ka patur progres në parashikimin e infrastrukturës PAK në projektet për rindërtimin/ndërtimin e shkollave në 82% të bashkive.**

*Problematika e ndërtimeve të paligjshme në zonat e trashëgimisë kulturore është e evidente dhe në vitin 2022 si dhe kufizimet e buxhetit vendor për aktivitete kulturore të harmonizuara me nevojat e komunitetit. **Sfidë mbetet ruajtja dhe mirëmbajtja e objekteve të trashëgimisë kulturore.*** Rritja e ndërgjegjësimit të banorëve dhe bashkëpunimi i ngushtë me strukturat e policisë dhe institucionet e tjera qendrore për parandalimin dhe dënimin e rasteve të shkeljeve është i një rëndësie të veçantë. Hartimi i planeve për mbrojtjen dhe zhvillimin e objekteve të trashëgimisë kulturore si dhe alokimi i buxheteve për investime dhe mirëmbajtje është një problematikë që kërkon adresimin e duhur dhe të qëndrueshëm.

Sipas Raportit të BE-së në 2022, **nevojiten më shumë burime për të modernizuar sistemin arsimor** dhe për të siguruar cilësi, barazi dhe gjithëpërfshirje në arsim për të gjithë nxënësit. Autonomia financiare e shkollës nuk ka përparuar pasi aktet nënligjore dhe dispozitat për sigurimin e autonomisë aktuale financiare në shkollë nuk janë zhvilluar. Masat kundër korrupsionit vazhdojnë të kenë një ndikim të kufizuar në arsim, i cili mbetet një sektor veçanërisht i cënueshëm në këtë aspekt.

3.11 Kapitulli 27: Mjedisit dhe ndryshimi i klimës

“Shqipëria ka treguar një nivel përgatitjeje në këtë fushë. Është bërë përparim i kufizuar në përafrimin e mëtejshëm të politikave dhe legjislacionit me acquis të BE-së, në fusha të tilla si menaxhimi i ujit, kimikatet dhe krimi mjedisor. Shqipëria ka bërë progres në fushën e mbrojtjes civile dhe është e gatshme të anëtarësohet në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian. Megjithatë, Shqipëria duhet të vazhdojë të punojë për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të saj të mbrojtjes civile. Nevojiten përpjekje të konsiderueshme për zbatimin e ligjeve veçanërisht në menaxhimin e mbetjeve, cilësinë e ujit dhe ajrit dhe ndryshimet klimatike¹³³”.

Gjatë vitit 2022 në Këshillin Konsultativ të Qeverisë qendrore me atë vendore janë diskutuar projekt aktet e mëposhtme:

Në fushën e Mjedisit dhe Pyjeve:

- Projekt-ligji për miratimin e Planit të Veprimit Kundër Helmimit të Llojeve të Kërcënuara dhe Endemike të Faunës së Egër në Shqipëri, 2022-2030”. Projekt ligji i përgatitur nga Grupi Kombëtar Kundër-Helmimit në kuadër të projektit Ballkanik Kundër-Helmimit (BAPP) synon të shërbejë si pjesë e strategjisë kombëtare që do të ndihmojë në parandalimin, luftimin dhe reduktimin e helmimit të faunës së egër në Shqipëri.
- Projektvendimi “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve spitalore”. Ofrimi shërbi-meve te kujdesit shëndetësorë gjeneron mbetje dhe kërkon menaxhimin e tyre brenda institucionit spitalor qofshin ato të rrezikshme apo të parrezikshme. Akti ka për qëllim të ofrojë kërkesa për prodhuesit e mbetjeve spitalore për ti ndihmuar të veprojnë brenda kërkesave ligjore për një mjedis të sigurtë pune.
- Projektvendimi “Për një shtesë në VKM nr. 559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe prodhimet drusore dhe jo drusore”. Projektvendimi përcakton çmimet dhe tarifatat për prodhimet drusore dhe synon të arrijë një përdorim dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të fondit pyjor i cili del si domosdoshmëri për rregullimin financiar për përdorimin e pyjeve dhe administrim sa më të mirë të këtij sektori.
- Projekt Vendimi “Kriteret për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda dhe sanksionet financiare në Fondin Pyjor Kombëtar” dhe Projekt Vendimi “Për përcaktimin e rasteve për dhënie në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacionin përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”.

Objektivi specifik: Rritja e ndërgjegjësimit dhe ngritja e kapaciteteve të qeverive vendore për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe menaxhimin e pyjeve

Përgjegjësitë e NJQV në fushën e mbrojtjes së mjedisit lidhen më sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja, sigurimin e masave për mbrojtjen nga ndotja akustike, si dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese mbi mbrojtjen e mjedisit.


¹³³ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022)

- Në vitin 2022, janë **trajnuar gjithsej 201 nëpunës vendorë** mbi legjislacionin dhe zbatimin e masave të politikave qendrore në fushën e mjedisit, ose mesatarisht 3.53 nëpunës të trajnuar për bashki (N=57). Treguesi ka rritje nga viti 2021 ku janë raportuar 142 nëpunës të trajnuar. Numrin më të madh e ka Bashkia Tiranë me 46 dhe Vlorë me 30 nëpunës të trajnuar. Bashkitë Cërrik, Malësi e Madhe, Maliq, Poliçan, nuk kanë dhënë informacion.
- Bashkitë kanë **organizuar 385 fushata ndërgjegjësimi në vitin 2022 në mbrojtje të mjedisit dhe minimizimin e ndotjes** në bashkëveprim me aktorë të tjerë vendorë dhe OSHC. Treguesi ka rritje krahasuar me 364 fushata në vitin 2021. Numrin më të madh e ka Bashkia Tiranë me 27 fushata si dhe Bashkitë Gjirokastrër dhe Selenicë me 25 fushata.

Objektivi specifik: Edukimi i gjeneratave të reja për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes

- Në vitin 2022 janë **organizuar 436 fushata ndërgjegjësimi në shkolla të mesme dhe 9-vjeçare** për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes ose mesatarisht 7.27 për bashki (N=60). Numrin më të madh e ka bashkia Kamëz me 40 dhe Selenicë me 36 fushata të organizuara. Bashkia Poliçan nuk ka raportuar. Treguesi ka rritje nga viti 2021 me 288 fushata dhe 2020 me 167 fushata ndërgjegjësimi të organizuara.

Grafiku 70: Fushata ndërgjegjësimi për ruajtjen e mjedisit në shkolla, 2022



Objektivi specifik: Hartimi i planit të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit mjedisor në nivel lokal

- Bashkitë kanë detyrim ligjor të hartojnë planet vendore të veprimit në zbatim të politikave qendrore për përmirësimin e cilësisë së ajrit. **Në vitin 2022 janë 14 Bashki që raportojnë që kanë hartuar Planet e Veprimit me një rritje prej 2 bashki më shumë se në 2021.** 78 % e bashkive sërish nuk kanë një plan vendor veprimi për përmirësimin e cilësisë së ajrit.
- Në vitin 2022 janë raportuar në total 23 masa të planifikuara nga Bashkitë në PBA për përmirësimin e cilësisë së ajrit** ose mesatarisht 0.79 masa për bashki (N=29). Vetëm 7 Bashki nga 29 raportuese kanë parashikuar masa për cilësinë e ajrit në PBA. Treguesi është në ulje nga 27 masa në 2021 si dhe ka mungesë të theksuar raportimi nga shumë Bashki.

Probleme dhe sfida


- Numri i punonjësve dhe kualifikimi i tyre është në nivele të ulëta për sfidat e sektorit.
- Bashkitë përballen sërish me kapacitete të ulëta të administratës vendore për të siguruar zbatimin e legjislacionit në fushën e mjedisit.

- Mungesa e planeve të veprimit dhe masave konkrete për zbatim apo veprimet për përmirësimin e cilësisë së ajrit nga disa bashki.
- Burimet financiare mbeten të pamjaftueshme dhe mungon planifikimi i politikave mjedisore në PBA.
- Numri i ulët i projekteve me fokus përmirësimin e cilësisë së ajrit të zbatuara në disa bashki, kryesisht ato të vogla.
- Mungesa e veprimtarisë së qëndrueshme e OJF-ve që veprojnë në fushën e mjedisit si dhe e organizatave ndërkombëtare të specializuara për çështjet mjedisore.

Rekomandime

- Miratimi sa më shpejt i Planeve Vendore të Veprimit për përmirësimin e cilësinë e ajrit nga Bashkitë që nuk e kanë miratuar, si dhe integrimi i masave në programet buxhetore.
- Shtimi i numrit të nëpunësve vendorë që kanë si funksion mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e ajrit dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, në disa bashki.
- Bashkëpunimi më i mirë me projektet e financuara nga BE dhe donatorë të tjerë në fushën e mjedisit dhe siguri i trajnimeve për nëpunësit në fushën e mjedisit dhe standardeve evropiane.
- Vazhdimi i programeve për edukimin qytetar, edukimi i të rinjve në shkolla dhe rritja e bashkëveprimit me aktorë të tjerë në nivel vendor dhe organizatat e shoqërisë civile.
- Bashkitë duhet të bëjnë një analizë të detajuar të nevojave për investime dhe sigurojnë një planifikim progresiv të fondeve në buxhetin lokal për çështjet e mjedisit.


Harta 13: PV për përmirësimin e cilësisë së ajrit



Objektivi specifik: Përmirësimi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve


- Në vitin 2022 hartimi i Planit Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (MIM) është bërë nga 24 Bashki me 5 Bashki më shumë se viti 2021. Ky tregues ka mungesë raportimi nga 22 bashki të cilat nuk japin asnjë informacion. Bashkitë që kanë hartuar Planin Vendor për MIM në 2022 janë: Lushnjë, Divjakë, Përmet, Gjirokastrë, Himarë, Bulqizë dhe Krujë.
- Në vitin 2022, kanë raportuar se janë 19 Bashki ose 31% që realizojnë depozitimin e mbetjeve të riciklueshme sipas objektivave të planit vendor për menaxhimin e mbetjeve. Treguesi ka rritje nga vetëm 19.7 % e bashkive në vitin 2021.

Grafiku 71: Vend-depozitime të mbetjeve të paautorizuara sipas NJQV, 2022




- 64 vend-depozitime të autorizuara janë përdorur nga bashkitë për depozitim të mbetjeve në 2022 (N=58) ose mesatarisht 1 vend-depozitim për bashki. Totali mbetet i njëjtë me vitin 2021 dhe numrin më të madh e kanë Bashkia Libohovë me 10. Bashkitë Cërrik, Librazhd dhe Poliçan nuk kanë raportuar për këtë tregues.

Grafiku 72: Vend-depozitime të autorizuara, 2022



- **Largësia mesatare e qendrës së Bashkisë nga vend-depozitimi i miratuar është 58.77 km. Treguesi ka shënuar progress në largimin e venddepozitimeve nga qendra me vitin 2021 ka qënë 31.32 km, në 2020 me 21.41km dhe në 7.97 km në vitin 2019 dhe 2018.**

Grafiku 73: Largësia maksimale e qendrës së bashkisë nga vend-depozitimi më i afërt, 2022



Objektivi specifik: Zbatimi i masave për riciklimin e mbetjeve

Ky objektivi specifik është vendosur në vitin 2022 dhe vlerësohet me progresin në katër indikatorë:


- mesatarisht në 11.1% e pikave të grumbullimit të mbetjeve janë vendosur kontenerë që i ndajnë mbetjet në burim (N=55).

- 529 është numri i mjeteve për grumbullimin e mbetjeve në total ose mesatarisht 9.12 mjete për bashki (N=58). Numrin më të madh e ka Bashkia Finiq me 150 mjete dhe Tiranë me 80 mjete.

- 54 është numri i mjeteve të specializuara për grumbullimin e mbetjeve sipas sistemit të ndarjes në burim ose mesatarisht 0.95 mjete për bashki (N=57). Numrin më të madh e kanë Bashkitë Tiranë e Durrës me 12 mjete të specializuara.

- 13 është numri i kontratave të lidhura me bizneset për riciklimin e mbetjeve (N=56). Vetëm 6 Bashki kanë raportuar që kanë lidhur kontrata nga 1 në 4 maksimumi që ka raportuar Bashkia Skrapar.

Grafiku 74: Numri i kontratave të lidhura me bizneset për riciklimin e mbetjeve, 2022



Probleme dhe sfida

- Sfidë mbetet fuqizimi i kapaciteteve të bashkive në përpunje dhe me metodologjitë e reja të menaxhimit të mbetjeve.
- Gjithashtu një sfidë permanente mbetet pamundësia e bashkive për të realizuar ndarjen në burim të mbetjeve për shkak të kostos së lartë dhe mungesës së pajisjeve të duhura.
- Problematikë e vazhdueshme mbetet mosfunksionimi i sistemit të monitorimit nga ana e bashkive dhe cilësia e ulët e ofrimit të shërbimeve nga operatorët privatë për menaxhimin e mbetjeve.
- Numri i madh vend-depozitimeve të papërshtatshme dhe të pautorizuara mbetet sfidë.
- Niveli i ulët i ndërgjegjësimit dhe edukimit qytetar, përfshirë dhe të rinjtë, është një sfidë e vazhdueshme për rëndësinë e ndarjes së mbetjeve në burime.

Rekomandime

- Hartimi i planit vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve nga të gjitha bashkitë dhe integrimi i masave të tij në Programin Buxhetor Afatmesëm.
- Sigurimi i financimit dhe monitorimi i zbatimit të Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve me efektivitet dhe efikasitet të lartë financiarë.
- Monitorimi i vazhdueshëm nga Bashkitë të shërbimeve të operatorëve private dhe konçesionare të kontraktuar për ofrimin e shërbimit të grumbullimit, depozitimit dhe riciklimit të mbetjeve.
- Shtimi i numrit të projekteve të investimit për riciklimin e mbetjeve në bashki apo qarqe dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore për realizimin në kohë të tyre.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit qytetar nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit në bashkëveprim me organizata të shoqërisë civile.

Objektivi specifik: Integrimi i rreziqeve të ndryshimeve klimatike në planet vendore në përputhje me përparësitë dhe objektivat kombëtare


Plani vendor i masave për zbutjen e rreziqeve të ndryshimit të klimës është hartuar nga 12 Bashki me një më shumë nga viti 2021. Bashkitë Tepelenë, Maliq, Elbasan, Divjakë, nuk kanë dhënë informacion për treguesin.

Objektivi specifik: Rritja e aftësisë për t'u përshtatur me efektet sfiduese të ndryshimit të klimës në nivelin lokal

Në vitin 2022, numri i specialistëve të punësuar dhe trajnuar në nivel vendor për ndryshimet klimatike, eficiencën e energjisë dhe energjitë e rinovueshme është në total 41 nëpunës ose mesatarisht 7.09 nëpunës në Bashki (N=58). Treguesi ka rritje të theksuar me rreth 8 herë më shumë nga viti 2021 ku janë raportuar vetëm 48 punonjës. Numrin më të madh gati 60% të totalit e ka Bashkia Elbasan me 254 specialistë për mjedisin.


Objektivi specifik: Pyllëzimi i zonave të degraduara përmes riciklimit të destinacionit të burimeve pyjore dhe eliminimin e borxheve të subjekteve që veprojnë në fondin pyjor

Harta 14 : Plani vendor i masave për zbutjen e rreziqeve, 2022



- Në vitin 2022 kanë hartuar planin për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor, 62% e Bashkive. 20 Bashki raportojnë që nuk kanë hartuar planin për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullor ndërsa tre Bashki nuk japin asnjë informacion¹³⁴.
- Numri i përgjithshëm i specialistëve vendorë për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave në 2022 është 495 ose mesatarisht 8.39 punonjës (N=59). Treguesi ka rritje të lehtë nga viti 2021 me 31 specialistë më shumë. Bashkitë me numrin më të madh të specialistëve të punësuar janë Kolonjë me 31, Maliq dhe Tiranë me nga 28.
- Krijimi i databazës mbi subjektet që ushtrojnë veprimtari dhe krijimi i kadastrës së fondit pyjor dhe kullor është një nga detyrat e qeverisjes vendore.

Grafiku 75: Shkalla e punësimit të specialistëve të fondit pyjor sipas legjislacionit, 2022



134 Polican, Peqin, Bulqizë nuk raportojnë për treguesin

Probleme dhe sfida

- Numri i punonjësve vendorë për administrimin dhe inspektimin e duhur të Fondit Pyjor dhe Kullosur është ende në nivele të ulëta për sfidat që kanë bashkitë.
- Planet vendore për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullor dhe mbarështimit të pyjeve nuk janë hartuar në një pjesë të bashkive.
- Lidhja e masave të planit vendor në dokumentin e planifikimit të buxhetit afat-mesëm (PBA) nuk është bërë nga një pjesë e madhe e bashkive.
- Mungesa e trajnimeve për punonjësit vendorë për të rritur nivelin e profesionalizmit dhe zbatimin efektiv të kompetencave vendore, është e evidente.

Rekomandime


- Miratimi i planeve vendore për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike nga të gjitha bashkitë dhe sigurimi i fondeve për zbatimin e masave të tyre.
- Hartimi i Planeve Vendore për Pyjet dhe Planet e Mbarështimit si dhe lidhja në programin buxhetor për financimin në përputhje me prioritetet e bashkive.
- Bashkëpunimi midis bashkisë dhe qytetarëve në aksione për mbrojtjen e mjedisit, si dhe në monitorimin e ndotjes së mjedisit nga operatorët ekonomikë, si dhe ushtrimi i presionit mbi ta për të ndërmarrë masa për të shmangur ndotjen.
- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe komunikuese mbi rreziqet e ndryshimeve klimatike dhe masat zbutëse.

Objektivi specifik: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimet

Gjatë vitit 2022 në Këshillin Konsultativ të Qeverisë qendrore me atë vendore janë diskutuar projekt aktet e mëposhtme:

- Draft “Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023-2030”. Strategjia synon hartimin e politikave të përshtatshme dhe angazhimin e fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.
- Dokumenti mbi “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022.
- Projekt-ligji “Për miratimin paraprak të zonës, distancës dhe gjërësisë së brigjeve të burimeve ujore”. Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 748, datë 1.12.2022.


Harta 15 : Databaza për subjektet që ushtrojnë aktivitetet mbi fondin pyjor dhe kullosur, 2022




Në vitin 2022 raportohet se:

- Mesatarisht 81% e familjeve janë të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë në zonat urbane në 2022 (N=60)¹³⁵. Situata mbetet e njëjtë me vitin 2021 ku 33% e Bashkive raportojnë 100% lidhjen e familjeve me rrjetin e furnizimit me ujë dhe bashkitë Dropull, Finiq dhe Pustec raportojnë 0% lidhjen e rrjetit të furnizimit me ujë në zonat urbane.
- Mesatarisht 59.87 % e familjeve janë të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë në zonat rurale në vitin 2022 (N=60). Treguesi ka ardhur në ulje me -2.3p.p. nga viti me 62.17 % në 2021 dhe me -11.33p.p. nga 2020 ku është raportuar 71.2%.
- Mesatarisht 82.77% e familjeve janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza në zonat urbane (N=58). Bashkitë Poliçan, Prrenjas, Kolonjë, Devoll, Memaliaj, Lezhë, dhe Gramsh raportojnë 100 % lidhjen me rrjetin e kanalizimeve në territorin e tyre. Bashkitë Divjakë, Peqin dhe Shijak nuk raportojnë për treguesin.
- Mesatarisht 20.49% e familjeve janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza në zonat rurale në vitin 2021 (N=57). Bashkitë Shijak, Skrapar, Divjakë dhe Dibër nuk kanë raportuar të dhëna. Treguesi ka pësuar ulje nga viti 2021 me 22.36 % dhe nga viti 2020 ku është raportuar 23.42%


Grafiku 76: % e familjeve të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë në zonat urbane, 2022



Grafiku 77: % e familjeve të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë në zonat rurale, 2022




Grafiku 78: % e familjeve të lidhura me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza në zonat urbane, 2022




¹³⁵ Bashkia Shijak nuk raporton për të katër treguesit ashtu si dhe në 2021

Grafiku 79: % e familjeve të lidhura me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza në zonat rurale, 2022



- Rreth 20% e bashkive (ose 12 Bashki) raportojnë se Impianti i pastrimit të përpunimit të ujërave të zeza është i ngritur dhe funksional në vitin 2021 (N=58). Treguesi ka ulje me dy bashki nga viti 2021. Bashkitë Shijak dhe Cërrrik nuk japin informacion për treguesin.
- Në vitin 2022 raportohet se mesatarisht 48% e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut është i rehabilituar dhe funksional në Bashki (N=52)¹³⁶. Treguesi ka ulje me -4.p.p. nga viti 2021 me 51.86 % të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut i rehabilituar.

Grafiku 80: % e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut i rehabilituar dhe funksional, 2022



Objektivi specifik: Rritja e kapaciteteve për përballimin e emergjencave natyrore


Gjatë vitit 2022 në Këshillin Konsultativ të Qeverisë qendrore me atë vendore janë diskutuar projekt aktet e mëposhtme:

- Draft Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 është përgatitur nga Agjencia Kombetare e Mbrojtjes Civile. Vizioni i strategjisë: “Një Shqipëri më e sigurt, e qëndrueshme, e aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive natyrore dhe efektet e ndryshimeve klimatike, për të përgatitur, përballuar dhe për tu rimëkëmbur, integruar në të gjithë sektorët me kapacitete të zhvilluara për të siguruar parandalimin e risqeve të reja dhe menaxhimin e riskut të mbetur, që të gjitha sëbashku të ndihmojnë në forcimin e aftësisë ripërtëritëse dhe si rezultat në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë”.
- Projektvendimi “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe veprimtarive të tjera në fushën e mbrojtjes civile”. Ky projektvendim ka si qëllim përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përdorimit të fondeve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), të planifikuara për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile duke unifikuar procedurat dhe kriteret e përdorimit të fondeve të AKMC-së, për përmbushjen e misionit të saj për mbrojtjen civile.

Ecuria në realizimin e këtij objekti specifiku matet me treguesit e mëposhtëm:

- Në vitin 2022, janë 48 bashki nga 53 bashki nga 2021 që raportojnë se kanë hartuar **Planin Vendor për Përballimin e Emergjencave Civile** në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile. Treguesi ka ulje nga viti 2021 dhe 21% e bashkive nuk kanë hartuar një plan vendor për Emergjencat.
- 60 bashki ose 99% e tyre kanë ngritur shtabin e emergjencave civile dhe strukturën e emergjencave civile në 2022. Vetëm bashkia Himarë nuk e ka ngritur ende Shtabin dhe strukturën e Emergjencave Civile. Treguesi ka rritje me +2 p.p. nga viti 2021.

Harta 16: Hartimi i Planit Vendor për përballimin e emergjencave civile, 2022



Harta 17: Bashkia ka ngritur strukturën e emergjencave civile, 2022



- Mbulimi i buxhetit për emergjencat civile nga Qeveria Qëndrore për vitin 2022 është mesatarisht 10.88 % e buxhetit të emergjencave civile në nivel vendor (N=55). Ka një rritje prej 1 p.p. të buxhetit për emergjencat civile krahasuar me vitin 2021 ku është raportuar 9.71 %.
- 2.88% është mesatarja e fondeve shtesë për emergjencat civile të alokuar për vitin 2022 nga Bashkitë (N=55). Treguesi ka ulje nga viti 2021 me 5.41 % dhe 2020 ku janë alokuar mesatarisht 6.79% fonde shtesë.

Probleme dhe sfida

Sfidat e Bashkive në sektorin e furnizimit me ujë vazhdojnë të jenë:

- Ndërhyrjet e paligjshme në rrjetin e ujësjellësit nga banorët, familjet dhe bizneset private kanë shtuar problematikat e bashkive.
- Kapacitetet administrative, infrastruktura dhe sistemet për paralajmërim të hershëm, parandalim, gatishmëria dhe reagimi, që janë ende të pamjaftueshme.
- Mungesa e rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve është ende prezente në disa Bashki të cilat raportojnë 0 % lidhje të rrjetit me familjet.
- Pamundësia e bashkive për të ndërhyrë me fondet e tyre me investime në rrjetet e ujësjellësave dhe kanalizimeve për shkak të financimit të lartë që kërkojnë këto projekte.

Rekomandime

- Realizimi i projekteve të investimit nga qeveria qendrore kryesisht për bashkitë që kanë problematikat më të mëdha në rrjet dhe buxhete të limituara.
- Bashkëpunimi me Komunitetin dhe Policinë për të ndaluar ndërhyrjet e paligjshme në rrjetin e furnizimit me ujë.
- Hartimi dhe miratimi i Planit Vendor për përballimin e emergjencave civile në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile nga të gjitha Bashkitë.
- Shtimi i fondeve nga ana e Qeverisë Qendrore sipas detyrimit për mbështetjen e bashkive me fonde buxhetore për parandalimin dhe menaxhimin e emergjencave civile.

PËRFUNDIME MBI MJEDISIN DHE NDRYSHIMIN E KLIMËS

Mjedisi dhe ndryshimet klimatike janë sektorë me impakt të madh në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të harmonizuar me acquis të BE-së e standartet evropiane për mbrojtjen e mjedisit.

Progres i moderuar është bërë në hartimin e planeve vendore të veprimit në zbatim të politikave qendrore. Po ashtu hartimi i planit vendor për zbatimin e rrezeve të ndryshimit të klimës mbetet në nivele të ulta. **Progres është bërë në drejtim të hartimit të planeve për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor nga 62% e Bashkive.**

Ka vazhduar me ritme të kënaqëshme trajnimi i nëpunësve vendorë mbi legjislacionin dhe zbatimin e masave të politikave qendrore në fushën e mjedisit. Gjithashtu, numri i specialistëve të punësuar dhe trajnuar në nivel vendor për ndryshimet klimatike, eficiencën e energjisë dhe energjitë e rinovueshme është 8 herë më i lartë nga viti 2021. Në lidhje me **emergjencat civile progresi është i madh** në ngritjen e shtabeve dhe strukturën e emergjencave civile në gjithë territorin e vendit.

Spektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve ende përballlet me problematikat e shtrirjes së shërbimit në gjithë territorin e vendit kryesisht në zonat rurale si dhe reduktimin e humbjeve nga ndërhyrjet e paligjshme në rrjet. **Raporti i BE thekson se performanca e sektorit të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve mbetet e ulët dhe Shqipëria duhet të përforcojë dhe përshpejtojë më tej masat e reformës së ujit**¹³⁷. Në lidhje me hapat e mëtejshme në fushën e Mjedisit raporti i BE në vitin 2022 thekson se duhet të merren masa të menjëhershme për të rishikuar dhe përmirësuar ndikimin mjedisor dhe strategjik në vlerësimet për projektet, planet dhe programet ekzistuese dhe të planifikuara, veçanërisht në sektorët e hidroenergjisë, ndërtimit, turizmit, transportit dhe minierave"¹³⁸.

¹³⁷ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022)

¹³⁸ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022)


3.12 Kapitulli 32: Kontrolli financiar

“Bashkimi Evropian promovon reformën e sistemeve të qeverisjes kombëtare për të përmirësuar përgjegjshmërinë menaxheriale, menaxhimin e shëndoshë financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe kontrollin e jashtëm të fondeve publike. Gjithashtu, rregullat e kontrollit financiar mbrojnë më tej interesat financiare të BE-së, kundër mashtrimit në menaxhimin e fondeve të BE-së dhe, euros kundër falsifikimit.

“Shqipëria ka një nivel përgatitje në fushën e provizioneve financiare dhe buxhetore. Të rriten kapacitetet administrative dhe mekanizmat e koordinimit ndërmjet aktorëve kryesorë në sistemin e burimeve të veta¹³⁹”.

Për infrastrukturën administrative, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përgjegjësinë e përgjithshme për çështjet financiare dhe buxhetore. Vendi do të duhet të vazhdojë të punojë për ngritjen e institucioneve përkatëse të përfshira në sistemin e administrimit të burimeve të veta, një organ koordinues të burimeve të veta dhe rregullat zbatuese. Këto janë të nevojshme për të siguruar që, pas anëtarësimit, Shqipëria do të jetë në gjendje të parashikojë, të llogarisë, të mbledhë, të paguajë, të kontrollojë dhe t'i raportojë BE-së, mbi burimet e veta në përputhje me acquis të BE-së¹⁴⁰. Ndryshimet ligjore do të sjellin mirëpërcaktimin dhe forcimin e masave sanksionuese për të rritur nivelin e përgjegjshmërisë menaxheriale dhe përmirësimin e zbatimit të mëtejshëm të ligjit përmes qartësimin të detyrave dhe funksioneve të strukturës përgjegjëse për menaxhimin financiar, kontrollin dhe kontabilitetin si dhe rishikimit të rolit të aktorëve të përfshirë në zbatimin e sistemit¹⁴¹.

Grafiku 81: Të ardhurat totale vendore sipas burimeve të financimit, 2022¹⁴²



¹³⁹ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

¹⁴⁰ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

¹⁴¹ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, <https://financa.gov.al/>


¹⁴² Burim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Drejtoria e Financave Vendore

Të ardhurat totale (në nivel kombëtar) për vitin 2022 u realizuan në masën 572.7 miliardë Lekë ose 98% të planit të 12 mujorit. Krahasuar me një vit më parë të ardhurat janë rritur me 62 miliard lekë ose 12% më shumë¹⁴³. Të ardhurat e veta të pushtetit vendor janë realizuar në vlerën 30.96 miliard lekë duke përbërë 5.1% të totalit të të ardhurave publike¹⁴⁴. Krahasuar me vitin 2021, të ardhurat vendore janë rritur me 4.99%. Të ardhurat e veta përbëjnë rreth 34.4% ndaj totalit të të ardhurave për NJVV për vitin 2022.

Të ardhurat totale (në nivel kombëtar) për vitin 2022 u realizuan në masën 572.7 miliardë Lekë ose 98% të planit të 12 mujorit. Krahasuar me një vit më parë të ardhurat janë rritur me 62 miliard lekë ose 12% më shumë¹⁴⁵. Të ardhurat e veta të pushtetit vendor janë realizuar në vlerën 30.96 miliard lekë duke përbërë 5.1% të totalit të të ardhurave publike¹⁴⁶. Krahasuar me vitin 2021, të ardhurat vendore janë rritur me 4.99%. Të ardhurat e veta përbëjnë rreth 34.4% ndaj totalit të të ardhurave për NJVV për vitin 2022.

Në 2022, norma mesatare e realizimit të të ardhurave të planifikuara vjetore nga NJVV vlerësohet në masën 78.4% (N=58) ose 1.36 p.p. më e lartë krahasuar me normën mesatare për vitin e mëparshëm të raportimit. Rreth 31 bashki (51%) kanë patur një normë realizimi të të ardhurave mbi normën mesatare (N=58)¹⁴⁷.

Grafiku 82: Norma e realizimit të të ardhurave të planifikuara vjetore, viti 2022



Shpenzimet e përgjithshme publike, për vitin 2022, arritën në rreth 651 miliard lekë me një realizim në masën 102.1% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 97.6% të planit vjetor të ndryshuar¹⁴⁸. Shpenzimet korrente dhe ato kapitale kanë shënuar një realizim 98.5% dhe 93.9% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar, po ashtu 100.3% dhe 93.4% të planit vjetor sipas aktit normativ nr.19 (datë 29.12.2022). Shpenzimet korrente për vitin 2022 rezultuan 8.4% më shumë krahasuar me vitin 2021, ndërsa shpenzimet kapitale ishin në masën 112.1 miliard lek (ose 12.2% më ulët se një vit më parë). Niveli i defiçitit për vitin 2022 rezultoi në rreth 78.2 miliard lek (ose 8.4% më poshtë krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit)¹⁴⁹.

¹⁴³ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Përmbledhje performancës paraprake 12 mujore të të ardhurave dhe shpenzimeve; <https://financa.gov.al/permbledhje-e-performances-paraprake-12-mujore-te-te-ardhurave-dhe-shpenzimeve-2/>

¹⁴⁴ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, <https://financa.gov.al/statistika-fiskale-vjetore/>

¹⁴⁵ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Përmbledhje performancës paraprake 12 mujore të të ardhurave dhe shpenzimeve; <https://financa.gov.al/permbledhje-e-performances-paraprake-12-mujore-te-te-ardhurave-dhe-shpenzimeve-2/>

¹⁴⁶ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, <https://financa.gov.al/statistika-fiskale-vjetore/>


¹⁴⁷ Raportim i NJVV mbi treguesit e performancës për vitin 2022

¹⁴⁸ Ministria e Financave dhe Ekonomisë; <https://financa.gov.al/>; Referuar Aktit Normativ nr.19, datë 29.12.2022 (AN nr.19)

¹⁴⁹ Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023), <https://financa.gov.al/permbledhje-e-performances-paraprake-12-mujore-te-te-ardhurave-dhe-shpenzimeve-2/>


Shpenzimet e pushtetit vendor në vitin 2022 kanë qenë 59.018 miliard lekë¹⁵⁰ ose 97.5% të shpenzimeve të planifikuara prej 60.2 miliard lekë. Krahasuar me një vit më parë (2022 / 2021), shpenzimet e pushtetit vendor janë rritur me 12.2 % (në nivelin 59 018 milion lekë nga 52 583 milion lekë në 2021). Rreth 31% të totalit të shpenzimeve të vendorit i ka mbuluar transferta e pakushtëzuar dhe 52% nga të ardhurat e veta. Rreth 20% të totalit të shpenzimeve vendore kanë shkuar për investime, 43% për paga dhe sigurime shoqërore dhe 32% për shpenzime operative¹⁵¹.

Grafiku 83: Përbërja e shpenzimeve vendore sipas natyrës ekonomike të NJVV, viti 2022



Norma mesatare e realizimit të shpenzimeve të planifikuara vjetore nga NJVV ka qenë rreth 79.6% pothuajse në një nivel të ngjashëm me vitin 2021 (N=57). Tridhjetë e katër (34) NJVV kanë patur një normë realizimi të shpenzimeve mbi normën mesatare.


Grafiku 84: Norma e realizimit të shpenzimeve të planifikuara vjetore, 2022



¹⁵⁰ Sqarim: Shpenzimet e pushtetit vendor pa përfshirë fondet e rindërtimit (2023)

¹⁵¹ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Financave Vendore (2023)

Grafiku 85: Niveli aktual i shpenzimeve vendore të NJVV, 2022¹⁵², në mijë lek
(niveli mesatar i shpenzimeve 677,196,000 lek pa Bashkinë Tiranë)




17 NJVV kanë patur një nivel më të lartë të shpenzimeve se niveli mesatar i të gjithë bashkive pa përfshirë Bashkinë Tiranë, si Bashkia Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë, Pogradec, Kamëz, Lezhë, Berat, Kukës, Lushnjë, Gjirokastër, Sarandë dhe Dibër.

NJVV organizuan rreth 292 dëgjesa publike (N=58) mbi realizimin faktik të buxhetit 2022, ose mesatarisht 5 dëgjesa (104 dëgjesa më shumë krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit).

¹⁵² Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);
Të dhënat për shpenzimet vendore nuk përfshijnë fondin e rindërtimit

Grafiku 86: Numri i dëgjësive publike të organizuara nga NJVV për realizimin faktik të buxhetit, 2022



Në vitin 2022, Sektori i Auditimit të NJVV të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) ka realizuar 72 auditime për pushtetin vendor, nga të cilat 25 auditime financiare, 35 auditime financiare dhe përputhshmërie. Për përmirësimin e gjendjes së subjekteve të audituara janë dhënë 1298 masa organizative, 190 masa për shpërbllim dëmi (në vlerën 285,122 mijë lekë), 458 masa për efekte negative në menaxhimin me efikasitet dhe efektivitet të shpenzimeve (në vlerën 6,694, 426 mijë lekë), si dhe janë evidentuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkive në vlerën 22,236,132 mijë lekë.

Kutia 8: Sfidat e bashkive për zbatimin e politikave të kontrollit financiar

Bashkia Devoll, Korçë, Roskovec: Rritja e realizimit të shpenzimeve; Korrektësi dhe efikasitet në shpenzimet e kryera.

Bashkia Mirditë: Rritja e performancës në realizimin e të ardhurave me qëllim realizimin e shpenzimeve të planifikuara për të rritur shërbimet ndaj qytetarëve.

Bashkia Përmet: Rritja e realizimit të shpenzimeve duke kryer në kohë prokurimet publike.

Bashkia Shkodër: Realizimi i shpenzimeve të planifikuara vjetore brenda afateve kohore të përcaktuara në regjistrin e parashikimeve; Të organizohen dëgjësia që në tremujorin e parë nëpërmjet platformave online dhe me fokus grupe specifike.

Bashkia Selenicë: Rritja e të ardhurave për vitin 2023 dhe menaxhimi i borxhit.

Bashkia Tropojë: Moskrijimi i defiçitit midis të ardhurave të planifikuara dhe ardhurave faktike.

Bashkia Vorë: Gjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2023, është parashikuar që borxhi ndaj palëve të treta të ulët në 35%.

Bashkia Lezhë: Përmirësim i treguesve të performancës në administrimin e të ardhurave dhe rritje të efektivitetit në përdorimin e fondeve.

Bashkia Prrerjas, Kamëz: Realizimi i dëgjësive publike për realizimin faktik të buxhetit; Rritja e numrit të dëgjësive.

Bashkia Patos: Pjesëmarrje më e lartë nga ana e qytetarëve.

¹⁵² Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023); Të dhënat për shpenzimet vendore nuk përfshijnë fondin e rindërtimit

Në vijim të përpjekjeve për të ndryshuar klimën e mos ndëshkueshmërisë, janë rekomanduar 76 masa administrative dhe 223 masa disiplinore. Gjithashtu, gjatë vitit 2022 janë realizuar 17 auditime, prej të cilave 10 i përkasin auditimeve të llojit të përputhshmërisë në fushën e kadastrës, 5 auditime të kombinuara në fushën e mjedisit dhe 2 auditime kanë qenë për zbatim rekomandimesh. Në përfundim të auditimeve janë lënë 2 masa për përmirësime ligjore, 231 masa organizative dhe 31 masa për efekte negative në menaxhimin me efektivitet dhe efikasitet në administrimin e pronës publike (në vlerën prej 48,201 mijë lekë)¹⁵³.

Disa nga sfidat dhe rekomandimet të raportimit të mëparshëm mbeten relevante:

Probleme dhe sfida

- Financimi i nevojshëm i funksioneve në nivel vendor për shërbime publike me standarte.
- Shlyerja e detyrimeve të prapambetura, shmangia e krijimit të borxheve të reja nga NJVV.
- Praktika jo të mira me pasojë dëm ekonomik lidhur me menaxhimin e fondeve publike nga NJVV të evidentuara gjatë aktiviteteve të kontrollit të jashtëm dhe auditimit nga KLSH.
- Kapacitete të kufizuara profesionale në disa NJVV në hartimin e raporteve të performancës së ekzekutimit të buxhetit dhe sigurimin e transparencës mbi arritjen e objektivave dhe të rezultateve të parashikuara.

Rekomandime

- Të punohet për ngritjen dhe forcimin e institucioneve përkatëse të përfshira në sistemin e administrimit të burimeve të veta, një organ koordinues të burimeve të veta dhe rregullat zbatuese¹⁵⁴.
- Rritja e efektivitetit të zbatueshmërisë të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.
- Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe rritja e transfertës së pakushtëzuar mbi 1% të PPB, me qëllim që qeverisja vendore të ketë më shumë buxhet për të realizuar reformën e decentralizimit në disa sektorë në të cilat shërbimi është nën standardet minimale; Përmirësimi i formulës së transfertës së pakushtëzuar¹⁵⁵.
- Të sigurohet zbatueshmëria e metodologjisë së miratuar për buxhetimin e përgjigjshëm për pakicat rome dhe egjiptiane nga ana e NJVV.
- Rritja e kapaciteteve dhe efektivitetit të NJVV në prokurimin publik që ndikon në realizimin e shpenzimeve të planifikuara.

¹⁵³ Buletini i Kontrollit të Lartë të Shtetit Janar- Shtator 2022; <https://panel.klsh.org.al/storage/phpXs7Mx>

¹⁵⁴ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2022)

¹⁵⁵ Minutat e Këshillit Konsultativ (Vendim nr.6 datë 28/10/2022)

PËRFUNDIME MBI KONTROLLIN FINANCIAR

Të ardhurat e veta të pushtetit vendor janë realizuar në vlerën 30.96 miliard lekë (ato përbëjnë 5.1% të totalit të të ardhurave publike). Krahasuar me vitin 2021 të ardhurat vendore janë rritur me 4.99% në vitin 2022. Është rritur lehtë norma mesatare e realizimit të të ardhurave vendore në vitin 2022 krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit. Shpenzimet e pushtetit vendor në vitin 2022, kanë qenë 59.018 miliard lekë ose 97.5% të shpenzimeve të planifikuara prej 60.2 miliard lekë. Krahasuar me një vit më parë (2022 / 2021), shpenzimet e pushtetit vendor janë rritur me 12.2%. Rreth 20% të totalit të shpenzimeve vendore kanë mbuluar investimet, 43% për paga dhe sigurime shoqërore dhe 32% për shpenzime operative. Rreth 31% të totalit të shpenzimeve të vendorit i ka mbuluar transfertat e pakushtëzuar dhe 52% nga të ardhurat e veta¹⁵⁶. Më shumë dëgjesa publike mbi ekzekutimin e buxhetit janë organizuar nga NjVV krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit.

Për përmirësimin e gjendjes së subjekteve të audituara (NJVV) nga KLSH për efekte negative në menaxhimin me efikasitet dhe efektivitet të shpenzimeve gjatë vitit 2022 janë dhënë një numër masash organizative, masa për shpërblym dëmi, masa administrative/dhe masa disiplinore.

Sfida për bashkitë mbetet rritja e zbatueshmërisë të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, përmirësimi i performancës në administrimin e të ardhurave, rritja e efektivitetit në realizimin e shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve me cilësi dhe standarte dhe ulja e borxheve.

Përparësi për qeverinë është sigurimi i qëndrueshmërisë dhe rritja e transfertës së pakushtëzuar mbi 1% të PPB që qeverisja vendore të ketë më shumë buxhet, për të realizuar reformën e decentralizimit në disa sektorë, në të cilat shërbimet janë nën standardet minimale dhe përmirësimi i formulës së transfertës së pakushtëzuar¹⁵⁷.

¹⁵⁶ Burim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Drejtoria e Financave Vendore (2023)

¹⁵⁷ Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Minutat e Këshillit Konsultativ (Vendim nr.6 datë 28/10/2022)

SHTOJCA 1:
*Vlerësimi i progresit të arritur
sipas treguesve të vlerësimit*

	Objektivi Strategjik	Tregues të zbatimit të veprimtarive	Dashboard
Legjenda Nuk ka progress ● Treguesit në nivele të njëjta me vitin 2021 ● Ecuri e mirë gjatë vitit 2022 ●			
Pjesa 1: Kriteri politik			
1	Qeverisja		
1.2	Ngritja e zyrave me një ndalesë për shërbime publike	Zyra me një Ndalesë (OSSH)	●
		Numri i shërbimeve të ofruara nga ZNJN	●
		Numri total i qytetareve që kanë aplikuar për shërbime on-line nga zyra me një Ndalesë	●
1.3	Rritja e transparencës së financave vendore	Buxheti vjetor vendor i bashkive i publikuar në faqen e internetit të bashkisë dhe në www.financatvendore.al	●
		Numri i dëgjësive publike me qytetarët të organizuar nga bashkia gjatë periudhës së përgatitjes së buxhetit për vitin e 2021.	●
1.4	Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimarrjen buxhetore	Numri i dëgjësive publike të organizuara nga bashkia mbi realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara për vitin 2020 (mbi ekzekutimin e buxhetit)	●
		Numri i rekomandimeve të qytetarëve, OSHC dhe grupeve të interesit të referuara në dokumentin e PBA/buxhetin kundrejt numrit të përgjithshëm të rekomandimeve (%)	●
		Numri dëgjësat publike mbi buxhetin me të rinjtë / pakicat kombetare dhe PAK	●
2	Administrata publike		
2.1	Forcimi i kapaciteteve të administratës së qeverisë vendore	Numri i punonjës me status të nëpunësit civil	●
		norma mesatare e nëpunësve civilë femra	●
		Punësimi i femrave në pozicione drejtuese	●
		Numri i nëpunësve vendorë (gjithsej) që kanë marrë pjesë në trajnimet nga ASPA (sipas të dhenave të burimeve njerezore)	●
		Numri i nëpunësve vendorë (gjithsej) që kanë marrë pjesë në trajnimet nga ofrues të tjere (përveç atyre të trajnuar nga ASPA- sipas të dhenave nga Burimet Njerezore)	●
		Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerezore (HRMIS) është funksional dhe përdoret nga bashkia për menaxhimin e burimeve njerezore	●
		Raporti (në %) i buxhetit vendor për trajnime për nëpunësit vendore kundrejt totalit të buxhetit në vitin e raportimit	●
2.3	Komisioneri për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhenave Personale (IDP)		
2.3	Përmirësimi i llogaridhënies së administratës vendore	Numri i përgjigjeve të dhëna për kërkesat e qytetarëve ndaj numrit të përgjithshëm të dorëzuar pranë bashkisë në %	●
		Numri i akteve të vendimmarrësve vendor të publikuar në regjistrin elektronik të bashkisë, mbi numrin total të akteve të miratuar nga bashkia gjatë vitit të raportimit	●
		Numri i raporteve mbi konstatimet/ rekomandimet nga Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit të cilat bashkia i ka refuzuar kundrejt numrit të përgjithshëm të raporteve të dorëzuara në bashki nga KMDDHP	●
3	Avokati i Popullit		
3.1	Përmirësimi i shqyrtimit nga bashkia i raporteve të konstatimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit	Numri i rekomandimeve nga Avokati i Popullit të paraqitura pranë Bashkisë Gjatë vitit të fundit.	●
		Numri i rekomandimeve të zbatuara nga Avokati i Popullit të cilat Bashkia i ka pranuar dhe ka marrë masa për adresimin e tyre.	●
4	Shoqëria civile		
4	Bashkepunimi me shoqerine civile	Numri i përgjithshëm i rekomandimeve/kërkesave të dhëna nga OSHC gjatë procesit të vendimarrjes vendore dhe çështje të tjera mbi mirë qeverisjen vendore	●
		Numri i përgjithshëm i rekomandimeve nga OSHC të marra në shqyrtim nga Bashkia gjatë procesit të vendimarrjes vendore	●
		Numri i përgjithshëm i rekomandimeve nga OSHC të pranuar nga bashkia gjatë procesit të vendimarrjes vendore	●
		Numri i granteve të dhëna nga bashkia për projekte të përbashkëta në partneritet me OSHC sipas vlerës së granteve	●
5	Lufta kundër korrupsionit		
5.1	Përmirësimi i efciencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit	Numri i rasteve (ankimeve) për shkelje të procedurave administrative dhe korrupsioni (përfshirë prokurimin publik)	●
		Numri i nëpunësve të administratës vendore që kanë deklaruar pasurinë, sipas mënyrës së kërkuar me ligj (Raportuar nga Burimet Njerezore)	●
		Numri i deklarimeve të konflikteve të interesit nga nëpunësit vendorë dhe Këshilli Bashkiak gjatë marrjes së vendimeve	●

		Ngritja e një rrjeti të koordinatorëve vendorë anti-korrupsion në bashki - Emerimi i pikes se kontaktit	
5.2	Forcimi i kapaciteteve të administratës së qeverisë vendore në luftën kundër korrupsionit	Ngritja e regjistrimit elektronik të bashkisë të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve	
		Shkalla e zgjidhjes së kërkesave dhe ankesave të qytetarëve sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin me %	
5.3	Adoptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e QV	Bashkia ka të aprovuar Planin e Integritetit me qëllim ndalimin e korrupsionit në shërbimet e ofrurara prej tyre sipas udhëzimit të Ministrisë Së Drejtësisë - proof te ngarkohet ne sistem	
6	Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave kombetare		
6.1	Forcimi i kapacitetit të pushtetit vendor për të zbatuar standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut	Numri i trajnimeve nga autoritetet qendrore / OSHC-të mbi standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut	
		Numri i nëpunësve të administratës vendore të trajnuar mbi standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut	
		Numri i rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut të referuara te cilat janë trajtuar nga grupet ndërinstitucionale/Bashkia	
Pjesa II: Kriteri Ekonomik			
1	Ekzistenca e nje ekonomie tregu funksionale		
1.1	Përmirësimi i mjedisit për biznesin	Bashkia ka hartuar dhe miratuar Planin e Zhvillimit Vendor në Këshillin Bashkiak	
		Numri i incentivave stimuluese për nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla të organizuara nga Bashkia gjatë vitit të raportimit	
		Numri i Shërbimeve që mbështesin zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të organizuara nga Bashkia gjatë vitit të raportimit (te sqarohet lista e shërbimeve)	
Pjesa 3: Aftësia për të marrë përsipër Detyrimet e Anëtarësimit			
11	Bujqësia dhe zhvillimi rural		
11.1	Forcimi i kapaciteteve të administratës së qeverisë vendore në sistemin e informacionit dhe keshillimit bujqësor e rural	Drejtoria e Bujqësisë ka ngritur Sistemin e Informacionit dhe keshillimit Bujqësor dhe Rural	
		Numri i perfituesve që kanë marrë informacion dhe keshillime nga Drejtoria e Bujqësisë në Bashki	
		Fondi lokal për zhvillimin rural / bujqësor në raport me buxhetin e Bashkisë në vitin e raportimit (në %)	
11.2	Përmirësimi i produktivitetit dhe konkurrencës në sektorin e bujqësisë: përmirësimi i infrastrukturës rurale, zhvillimi i balancuar territorial dhe ekonomik i zonave rurale	% e inventarit kullues dhe ujtes që është marrë në dorezim nga bashkia	
		Sistemi ujtes funksional kundrejt totalit të rrjetit ujtes të Bashkisë të marrë në dorezim (në %)	
		% e sipërfaqes bujqësore e ujitur kundrejt totalit	
		% e rrjetit të kullimit funksional kundrejt totalit të rrjetit kullues në vitin e raportimit (në %)	
11.3	Zbatimi i qasjes LEADER	Sipërfaqja e tokës bujqësore që ujitet në raport me totalin e sipërfaqeve në %	
12	Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare		
12.1		Raporti i numrit të tregjeve të kafshëve të gjalla të licensura kundrejt numrit total të tregjeve të kafshëve të gjalla (në %)	
		Raporti i numrit të tregjeve publike të shitjes me pakice konform standardeve të higjienës kundrejt numrit total të tregjeve në territorin e bashkisë Në vitin e raportimit (në %)	
		Ngritja e qendrave për mbrojtjen e kafshëve	
12.2.	Funksionimi eficient i sistemit të mbrojtjes së konsumatoreve	Zyra e konsumatorit e ngritur dhe funksionale në bashki	
		Numri i ankesave të paraqitura nga qytetarët mbi sigurinë ushqimore pranë Zyres së Konsumatorit/Kordinatorit	
14	Politika e transportit		
14.1	Rritja e sigurisë rrugore në nivel vendor	% e rrjetit rrugor ekzistues <u>urban</u> në territorin e bashkisë në përputhje me standardet ligjore të ndërtimit	
		% e rrjetit rrugor ekzistues <u>rural</u> në territorin e bashkisë në përputhje me standardet ligjore të ndërtimit	
		% e rrjetit rrugor ekzistues të territorit të bashkisë i cili është brenda standardeve ligjore të sinjalistikës (vetëm pjesa e rrjetit rrugor që administrohet nga bashkia)	
		Numri i fshatrave që nuk kanë infrastrukturën rrugore të nevojshme për t'u lidhur me qendrën e Bashkisë gjatë 365 diteve të vitit/ kundrejt numrit total të fshatrave të Bashkisë (në %)	
		Numri i fshatrave të lidhura me NJA nëpërmjet rrjetit rrugor ekzistues në raport me numrin total të fshatrave (në %)	
		Fondi i buxhetit vendor për mirëmbajtjen e rrugëve (në % të Buxhetit të Bashkisë) në vitin e raportimit	
		Fondi i buxhetit vendor për ndërtimin/rehabilitimin e rrugëve në raport me buxhetin Bashkisë në vitin e raportimit (në %)	

		Fond për sigurinë rrugore në raport me fondin vendor për sektorin e transportit (në %)	●
14.3	Promovimi i ecjes në këmbë dhe me biçikleta	Km rrugë të dedikuara për biçikleta në zonat urbane të Bashkisë në raport me km rrugë totale në zonat urbane (në %) - treguesi të jete kumulativ për të matur progresin nga viti në vit	●
		% e rrjetit rrugor të brendshëm të zonave urbane të bashkisë i pajisur me trotuarë	●
		Fushata promovimi të ecjes në këmbë dhe me biçikleta të ndërmarra nga Bashkia - numer	●
15	Energjia		
15.1	Rritja e eficiencës së përdorimit të energjisë	Caktimi (rekrutimi) i menaxherit të eficiencës së energjisë në Bashki	●
		Trajnimi dhe certifikimi i menaxherit të energjisë nga strukturat përkatëse	●
		Numri i l projekteve të zbatuara sipas kërkesave të eficiencës së energjisë	●
15.2	Rritja e eficiencës së përdorimit të energjisë: përmirësimi i zbatimit të kërkesave minimale për ndërtesat dhe shërbimet publike dhe private	Numri i kontrolleve mbi kërkesave të eficiencës së energjisë në ndërtesa për shërbime publike dhe private të ndërmarra nga Bashkia nën përgjegjësinë e menaxherit të Energjisë dhe gjetjet përkatëse.	●
		Numri i rasteve të konstatuara me shkelje për mosbatimin e rregullave të eficiencës së energjisë	●
15.3	Krijimi dhe përaorimi i burimeve të rinovueshme dhe politikave promovuese për	Numri i projekteve të zbatuara nga bashkia që bazohet në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë	●
16	Tatimet		
16.1	Përmirësimi i administrimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore në drejtim të rritjes së bazës së tatueshme	Politika tatimore të planifikuara/zbatuara të bashkisë që kanë për qëllim nxitjen e formalizimit të ekonomisë në territorin e saj, gjatë vitit të raportimit	●
		Numri i inspektimeve në terren të ndërmarrë nga bashkia me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale në territorin e saj gjatë vitit të raportimit	●
		Numri i dëgjësive publike me grupet e biznesit të organizuara nga bashkia me qëllim informimin dhe përfshirjen në diskutimin e politikave tatimore të bashkisë në vitin e raportimit	●
		Ndërtimi i një baze të dhënash (program) të debitorëve të bashkisë (programi i ngritur/dhe efektiv)	●
		Rritja e të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore në vitin e raportimit	●
19	Politikat sociale dhe punësimi		
19.1	Mbrojtja sociale në nivel vendor	Numri i nëpunësve të administratës vendore përgjegjës për përfshirjen sociale në bashki, sipas kategorive	
		- Njesia për mbrojtjen e fëmijëve	●
		- Nepunësi për barazim gjinor	●
		- Nepunësi për dhunën në familja (akti-ligjor)	●
		Numri i nëpunësve të administratës vendore përgjegjës për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së Ndihmës Ekonomike	●
		Sektori i Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit i ngritur në bashki	●
		Fondi vendor i planifikuar për shpenzime të kujdesit social kundrejt buxhetit të Bashkisë në vitin e raportimit (në %)	●
Numri i përfituesve PAK krahasuar me vitin e kaluar	●		
Përqindja (%) e rasteve të strehimit social të ofruar për viktimat e trafikimit ndaj numrit gjithësej të përfituesve të strehimit social në bashki gjatë vitit të raportimit	●		
19.2	Përfshirja sociale në nivel vendor	Plan vendor veprimi për përfshirjen sociale i miratuar në KB	●
		Përqindja (%) e rasteve të strehimit social kundrejt nevojave të paraqitura në bashki	●
		Bazë të dhënash statistikore për përfshirjen sociale (e ngritur)	●
		Numri i nxënësve, që ndjekin arsimin profesional, të cilët përfitojnë bursa nëpërmjet bashkisë.	●
19.3	Mbështetja për programet aktive të punës	Numri i të papunëve që marrin ndihmë ekonomike të cilët janë mbështetur financiarisht nga Bashkia për arsim dhe trajnim profesional që përputhen me nevojat e tregut të punës dhe në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Punësimit	●
		Numri i PAK që janë përkrahur nga Bashkia për arsim dhe trajnim profesional/kundrejt numrit total të PAK që mund të punësohen në tregun e punës (akti-ligjor)	●
		Numri i të rinjve që përfundojnë arsimin universitar dhe aftësimin profesional, të cilët janë mbështetur financiarisht nga Bashkia për fillimin e një biznesi privat në fushën e tyre profesionale	●
22	Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturorë		
22.1	Forcimi i bashkëpunimit në zhvillimin rajonal dhe lokal në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe të zvogëlojnë pabarazitë rajonale.	Numri i bashkëpunimeve me bashki të tjera Brenda territorit të Shqipërisë	●
		Pjesëmarrja në iniciativat e perbashkëta rajonale dhe Europiane të ndërmarra me synim reduktimin e diferencave rajonale - Projektet e bashkëpunimit transnacional dhe të bashkëpunimit ndërkufitar	●
23	Gjyqësori dhe të drejtat themelore		
		Bashkia ka Njesisë për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve	●

23.1	Forcimi i sistemit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve	Numri i stafit l punësuar në Njësinë për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve	
		Numri i rasteve të identifikuar nga grupi ndërdisiplinor të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve gjatë Vitit të raportimit	
		Numri i urdhrave për mbrojtje te referuara prane koordinatorit ne bashki ndaj numrit të rasteve të identifikuar në vitin e raportimit (në %)	
		Numri i rasteve te trajtuara për mbrojtjen e fëmijëve të ofruara nga Bashkia në raport me numrin gjithsej të rastve të identifikuar	
		% e buxhetit të dedikuar për mbrojtjen e fëmijëve mbi buxhetin e përgjithshëm për shërbimet sociale në vitin e raportimit	
		Numri i aktiviteteve të organizuara nga Bashkia për promovimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve (EU-UNICEF Të dhëna për të Drejtat e Fëmijës)	
23.3	Zbatimi efektiv i Ligjit 2016 "Për mbrojtjen e pakicave në Republikën e Shqipërisë"	Krijimi i një sistemi të monitorimit të rasteve për diskriminim të ndodhur brenda territorit të Bashkisë: për regjistrimin, menaxhimin, adresimin tek autoritetet më të larta	
		Niveli i bashkëpunimit të Bashkisë me Komisionerin për mbrojtjen nga diskriminimi:(i) numri i aktiviteteve të ndërmarrja në bashkëpunim; (ii) raportimi i rregullt i përbashkët mbi rastet e diskriminimit identifikuar	
		Fushata ndërgjegjësuere të organizuara nga Bashkia në shkolla apo komuniteti për mbrojtjen nga diskriminimi i personave të grupit të LGBTI	
23.4	Përmirësimi i koordinimit të punës ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale për zbatimin dhe monitorimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptasve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020	Krijimi i një sistemi për monitorimin e rasteve për shkelje të së drejtës së pakicave kombetare te ndodhura në territorin e Bashki: për regjistrimin, menaxhimin, adresimin tek autoritetet më të larta	
		Aktivitete socio-kulturore të organizuara rregullisht nga Bashkia, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe respektit reciprok midis shumicës dhe pakicës së popullsisë	
		Nëpunësi civil i administratës lokale i trajnuar për angazhimet e Bashki për Planin Kombëtar per Romet dhe Egjiptianet	
		Plani Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëve I miratuar	
23.5	Forcimi i sistemit për sigurimin e barazisë gjinore	Numri i trajnimeve të kryera për administratën lokale në sistemin elektronik të grumbullimit të të dhënave ROMALB	
		Frekuenca e rifreskimit te te dhenave ne sistemin elektronik ROMALB e ndare (mujore; tremujore; vjetore)	
		Numri i përfituesve R/E nga programet e strehimit social n1 Bashki në raport me numrin gjithsej të aplikimeve për vitin e raportimit	
		Numri i projekteve në zbatim në mbështetje të komunitetit Romë / Egjiptian	
		Numri i të punësuarve R/E në total ne bashki, perfshire dhe sherbimet/ kundrejt numrit total te punonjesve (%)	
23.6	Mbrojtja e të drejtave të PAK: Zbatimi efektiv i Ligjit 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesin e personave me aftësi të kufizuara"	Numri i të punësuarve R/E në institucionet e Bashkisë gjatë vitit të raportimit	
		Sektori i Barazisë Gjinore në Bashki / Koordinator lokal për çështjet gjinore në Bashki	
		Numri i rasteve te referuara ne takimet e MKRse (punonjësi gjinor dhe takime)	
		Numri i trajnimeve të nëpunësve civil të administratës lokale me ekspertë të barazisë Gjinore	
		Numri i shërbimeve të specializuara të ofruara nga Bashkia për gratë viktime të dhunës në familje/strehëza, të ndara sipas njëshive administrative (NJA)	
		Numri i raportimeve ne sistemin REV-ALB per periudhen e raportimit	
		Hartimi i buxhetimi gjinor (gender) i PBA të Bashkisë	
		Numri i aktiviteteve të ndërmarrja në bashkëpunim me OSHC per diskriminimin gjinor	
		Numri i shërbimeve sipas menaxhimit të rasteve	
		Numri i çerdheve dhe kopshteve për femijë të ndërtuara/mirëmbajtura nga Bashkia në zonat rurale në vitin e raportimit	
		Fondi vendor për gratë, viktime të dhunës në familje: strehimi social, shërbimet e kujdesit social, ndihma ekonomike në raport me buxhetin e Bashkisë për sektorin social në vitin e raportimit	
		Numri i aktiviteteve të organizuara nga Bashkia për promovimin e barazisë gjinore (Karta Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Lokale)	
23.6	Mbrojtja e të drejtave të PAK: Zbatimi efektiv i Ligjit 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesin e personave me aftësi të kufizuara"	Themelimi i Njësisë për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin në Bashki	
		Përgatitja e Planit Lokal të Veprimit për Përfshirjen Sociale të PAK / planifikuar në PBA	
		Numri i raporteve gjashtë mujore të Bashkisë në MSHPS për çështjet e PAK	
		% e rritjes së fondit të buxhetit lokal për heqjen e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore të PAK në territorin e Bashkisë gjatë vitit të raportimit	
		Numri i shkollave në Bashki të pajisura me infrastrukturë që sigurojnë akses në PAK në raport me numrin gjithsej të shkollave në Bashki (në %)	
		Numri i institucioneve publike në territorin e Bashkisë të pajisura me infrastrukturë që sigurojnë akses në PAK në raport me numrin gjithsej të institucioneve publike (në %)	
		Nëpunësit civil të administratës vendore për çështjet e PAK	

		Infrastruktura rrugore brenda Bashkisë që siguron aksesueshmëri të PAK (% km të zonës urbane)	
		Qendrat historike dhe kulturore (muzete, kinema, qendrat arkeologjike) ne territorin e bashkisë te pajisura me infrastrukturen e duhur per personat me aftesi ndryshe (rampa, pajisjet e shpjeguese per personat me aftesi te kufizuar ne degjim dhe shikim)	
24	Drejtesia, liria dhe siguria		
24.1	Zhvillimi i luftës kundër kimit të organizuar	Grupi i punës në Bashki për zbatimin e Planit të Veprimit për Luftën kundër Kimit të Organizuar i ngritur	
		Hartimi i Strategjive të Sigurisë Publike në Nivel Vendor	
		Ngritja e Këshillave të Sigurisë Vendore	
		Ngritja e Zyres së Policimit në komunitet e ngritur në secilin njësi administrative	
		Numri i raseve të referuara pranë Zyres së Policimit në komunitet nga qytetarët	
26	Arsimi dhe kultura		
26.1	Rritja e pjesëmarrjes në klasat përgatitore të arsimit parashkollor: mundësia e pjesëmarrjes dhe përfshirje masive e fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor	Numri i kopshteve në Bashki	
		% e kopshteve me numrin e fëmijëve nën kapacitetin e shërbimit	
		Raporti mesatar fëmijë/edukatore në zonën urbane	
		Raporti mesatar nxenes/mesues në zonat urbane	
		Raporti mesatar nxenes/mesues në qytetin – qender të bashkisë	
		Raporti mesatar numri nxenesve/klase në zonën urbane	
		Fushata ndërgjegjësimi ndaj prindërve për përfshirjen e fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor të ndërmarrë nga bashkia	
		Fondi i investimit i miratuar në buxhet për ndërtim të kopshteve të reja/ dhe rindërtim të kopshteve ekzistuese në raport me buxhetin vendor për vitin e raportimit (në %)	
26.3	Përmirësimi i infrastrukturës shkollore të arsimit parauniversitar	Numri i projektet për rindërtimin/ndërtimin e shkollave në bashki që përfshijnë parashikimet për infrastrukturën e PAK (tendahet me (1) ashensore dhe (2) rampa)	
		Fondi i investimit vendor për ndërtimin e shkollave të reja / dhe rikonstruksionin e shkollave ekzistuese në raport me buxhetin vendor të miratuar në vitin e raportimit (në %).	
26.4	Përmirësimi i procesit të vendimmarrjes duke krijuar një komunikim shkollë-prindër-qeveri	Përfaqësues i bashkisë në vendimmarrjen e shkollave	
		Nisma të bashkisë për të mbështetur ngritjen e komunikimit shkollë-prindër-qeveri	
26.5	Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale - pasuri kombëtare e popullit shqiptar në breza	Numri i masave të ndërmarrë ndaj këtyre shkeljeve dhe ndërtimeve të jashtëligjshme nga bashkia në vitin e fundit	
26.6	Mbështetja e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve	Numri i aktiviteteve kulturore të organizuara nga bashkia për promovimin e kulturës së zonës dhe kulturës kombëtare në vitin e raportimit.	
		Fondi vendor i miratuar për aktivitetet kulturore të bashkisë në raport me buxhetin e bashkisë për trashëgiminë kulturore në vitin e raportimit (në %).	
27	Mjedisi dhe ndryshimi i klimës		
27.1	Ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve të qeverive vendore për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe administrimit të pyjeve	Numri i nëpunësve të administratës vendore të trajnuar për legjisllacionin mjedisor dhe zbatimin e tij si dhe përparësitë e fushës së mjedisit në lidhje me integrimin në BE	
		Fushata ndërgjegjësimi për publikun e gjerë për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes organizuar nga Bashkia, institucione qendrore dhe aktorë të tjerë (OSHC/projekte)	
27.2	Edukimi i brezave të rinj për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes	Fushata ndërgjegjësimi në shkolla të mesme dhe 9-vjeçare për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes organizuar	
27.3	Hartimi i planeve të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit në nivel vendor	Plan vendor i veprimit (PV) për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit në zbatim të Planit Kombëtar për përmirësimin e cilësisë së ajrit.	
		Numri i masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit të përfshira në PBA	
27.4	Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbejtjeve	Plan vendor i MIM i hartuar, planifikuar në PBA	
		Mbetjet e riciklueshme të territorit të bashkisë riciklohen sipas objektivave të Planit MIM vendor (nga shoqëritë e riciklimit / ose ndërmarrjet publike)	
		Numri i vend-depozitimeve të mbyllura në territorin e bashkisë në raport me numrin total të vend-depozitimeve	
		Numri i vend-depozitimeve të paautorizuara në territorin e bashkisë	
		Numri i vend-depozitimeve të autorizuara / landfill ose incinerator në territorin e bashkisë	
27,6.1	Integrimi i rreziqeve të ndryshimeve të klimës në planet vendore në harmoni me prioritetet dhe objektivat kombëtarë	Largësia e qendrës së bashkisë nga landfilli më i afërt	
		Plan vendor (PV) i hartuar/ përditësuar nga Bashkitë më vulnerabël ndaj ndryshimeve klimatike që kanë integruar rreziqet e ndryshimeve të klimës dhe masat për zbutjen dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike.	
		% e familjeve të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë në zonat urbane	
		% e familjeve të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë në zonat rurale	

27,6.2	Permiresimi i cilesise se sherbimeve te furnizimit me uje e kanalizimet	% e familjeve te lidhur ne rrjetin e kanalizimeve te ujrave te zeza ne zonat urbane	
		% e familjeve te lidhur ne rrjetin e kanalizimeve te ujrave te zeza ne zonat rurale	
		Impanti i pastrimit te perpunimit te ujrave te zeza I ngritur funksional	
		% e rrjetit te kanalizimeve te ujrave te shiut i rehabilituar dhe funksional (te verifikohet nese treguesi eshte formuluar sakte)	
27,6.3	Rritja e aftësisë për t'u përshtatur ndaj efekteve të dëmshme të ndryshimeve klimatike, në nivel vendor	Plani Lokal I Zhvillimit Vendor perfshin masat qe adresojne përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe uljen e shkarkimeve të CO2 (proof)	
		Numri i specialistëve të punësuar dhe trajnuar në nivel vendor për ndryshimet klimatike dhe energjitë e rinovueshme	
27,6.4	Rritja e kapaciteteve per perballimin e emergjencave natyrore	Hartimi I planit vendor per perballimin e emergjencave civile ne perputhje me Planin Kombetar te Emergjencave Civile	
		Ngritja e shtabit te emergjencave civile	
		Ngritja e struktures se emergjencave civile	
		% e buxhetit te emergjencave civile te mbuluar nga Qeveria Qendrore	
		% e fondeve shtese per emergjencat civile	
27.8	Pyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara nëpërmjet riciklimit në destinacion të të ardhurave nga fondi pyjor dhe detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor	Plan Veprimi (PV) vendor për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kulloror I hartuar dhe miratuar (që integron dhe masat e mbarështimit për pyjet dhe kullotat, bimët mjekesore, etj)	
		Siperfaqja e fondit pyjor ne administrim te bashkise	
		Numri i specialistëve të administrimit të fondit pyjor në bashki	
		Krijimi i database mbi subjektet që ushtrojnë aktivitet mbi fondin pyjor dhe kulloror të Bashkisë	
32	Kontrolli Financiar		
32.1	Forcimi i kapaciteteve të pushtetit lokal në efektivitetin dhe transparencën e menaxhimit financiar lokal	Përqindja (%) e realizimit të shpenzimeve dhe të ardhurave të planifikuara vjetore	
		% e ndryshimit të borxheve të prapambetura të Bashkisë ndaj palëve të treta gjatë dy viteve të fundit / planifikuar në PBA	

BASHKITË NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Raporti i Vlerësimit për Vitin 2022



BASHKITË PËR NË EVROPË
Një projekt i financuar nga BE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE
TË BRENDSHME

